Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (167) / MAJ 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA

FOTOLAJM



Ura e fshatit Fshat në ndërtim, një nga gjashtë urat e Rrugës së Arbrit, e dyta për nga rëndësia, pas Urës së Vashës.
Ura është e gjatë 174 metra dhe e lartë 157 metra. Konstruksionet metalike të saj janë realizuar me elemente çeliku me karbon të saldueshëm. Përfundimi i saj do të shënojë simbolikisht edhe lidhjen e plotë të të gjitha segmenteve në ndërtim të rrugës, përjashtuar tunelin e Murrizit, 3.8 km të gjatë, që pritet të përfundojë pas fillimit të qarkullimit në pranverën e vitit 2021. Foto e datës 25 maj 2020.

Skavica dhe Katundi i Ri, dy hidrocentralet e reja në Dibër?!

Kryeministri: Ndërtojmë Skavicën me 100% financim shtetëror

Drejtori i KESH: "Alternativa më e madhe përmbyt një sipërfaqe të madhe, por një proces konsultimi, shpronësimi dhe bashkëpunimi mund ti japë një opurtinitet më të madh zonës"



PROPOZIMI I WBIF: Hidrocentrali i Skavicës parashikohet të kushtojë 247 milionë e 500 mijë euro.
Nga të cilat 40 milionë euro do të jetë financimi i qeverisë shqiptare dhe 206 milionë euro do të sigurohen përmes një kredie të BERZH. Ndërsa 1.5 milionë është grant nga WBIF - Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor, e cila po përdoret për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe Vlerësimit të Ndikimit Social-Mjedisor

Një sondë e kompanisë "Altea & Geostudio 2000" duke kryer shpime në territorin ku do të ndërtohet diga e Skavicës.

Një historik i premtimeve qeveritare për Skavicën. Qëndrimet "Pro" dhe "Kundër"

KOMENT nga Abdurahim Ashiku

Edi Rama, për Skavicën pyet dibranët, jo partiakët e sharlatanët...

SPECIALE / Lexoni në faqen 2,3,4

INTERVISTË


Haki Kola:
Katastrofa ekologjike është ulur këmbëkryq në malet tona

Ike Haki Kola, ike mik i gjelbërimit dhe i luleve...

FAQE 18-19



Qerim Sula, një mal që mbolli e rriti lisa



"Pa folklor nuk ka komb"

AMANETI I QERIM SULËS:
Të gjurmojnë artin, ta gjurmojnë thesarin e popullit, të nxjerrin në pah të bukurën, të merren me këngën popullore se është e bukura e kombit, pa art e pa kulturë nuk ka komb.

Sot arti ka më tepër liri, por është harruar ajo që buron nga populli, folklori, arti po bëhet biznes. Kënga burimore e veriut ka ngelur pak në harresë, por jo vetëm ajo e veriut po edhe e Shqipërisë. Sot nuk po punohet më me talentet e rinj, madje edhe folklori i popullit po manipulohet, keqpërdoret. Më ven keq që nuk shfrytëzohen aq sa duhet ato burime se populli është thesar i pashtershëm

FAQE 16-17

NË BRENDËSI: ■ **Serveti i Cerjanit**, një hero i heshtur ■ **Orteku** i punëve të mira ■ **Xhevdet Krrashi** që më mori fluturim maleve të Çidhnës ■ **Kur Dritëro Agolli** vinte në parkun "Dine Doda" ■ **Katër këngë** që frymëzojnë me dashuri dhe atdhedashuri ■ **Fluturon shqipja** mbi Korab ■ **Hazis Ndreu**, mjeshtri i alegorisë ■ **Heroi** i kujt ka lindur më 6 maj? ■ Epoka e **Gjergj Kastriotit**, bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare ■ Nga Veriu në Jug, Gjenerale **Manushaqe Shehu** e angazhuar në shpërndarjen e ndihmave humanitare ■ Libri **"Matja në gur e në dru"** një thesar i etnologjisë së brezave ■ **Geri Shatku** - një portë dhe shumë zemra bosh... ■ **Luan Shatku**, modeli i basketbollistit shqiptar ■ **Kujtim Hoxha**, ikja e parakohshme e mësuesit ■ **Fisnik Hyka**, një njeri plot energji pozitive

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 5 (167). Maj 2020
Gazeta doli nga shtypi, 4 qershor 2020.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Qershor 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Arben KALLAMATA
Muharrem Gjoka
Halil RAMA
Xhafer MARTINI
Defrim METHASANI
Enver HALILI
Bashkim KOÇI
Mevlud BUCI
Arsi KOLARI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Skavica dhe **Katundi i Ri**, dy hidrocentralet e reja në Dibër?!

Qeveria prezanton dy verisone të hidrocentralit të Skavicës, por nëse ajo do të vendosë për "Variantin A", atëherë mbetet në fuqi edhe ndërtimi i hidrocentralit tjetër mbi Drin, në Katund të Ri me fuqi 50 MW

Nga **BUJAR KAROSHI**

Premtimet për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës rikthehen sërish si premtime qeveritare dhe debati politik e shoqëror.

"Ta ndërtojmë me forcat tona dhe do ta ndërtojmë Skavicën me 100% shtetin", deklaroi Kryeministri Edi Rama më 27 maj 2020, gjatë ceremonisë së prezantimit të Parkut Fotovoltaik të Karavastasë.

Kjo deklaratë e Kryeministrit ka ngjallur reagime të dyanshme në rrjetet sociale, një pjesë e të cilave, e kundërshtojnë ashpër ndërtimin e saj. Premtimet për ndërtimin e Skavicës nga qeveria shqiptare dalin në publik periodikisht në fundet e mandatit qeverisës, pa u detajuar me informacione të sakta për publikun. Transparenca për këto premtime ose ka qenë e pakët ose ka munguar fare.

Por, gjatë fjalës së tij në Divjakë, Kryeministri Edi Rama nuk lëshoi vetëm një deklaratë, por i kushtoi Skavicës një pjesë të rëndësishme në fjalën e tij.


Duke e quajtur të suksesshëm procesin e tenderimit dhe realizimit të Parkut Fotovoltaik të Karavastasë, ai tha se "shpejt do të dalim në një proces tjetër që është një proces i menduar dhe i vonuar me më shumë dekada sesa vetë kjo periudhë e 30 viteve, projektimi dhe ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës".

"Skavica ka qenë një objektiv historik i të gjitha qeverive shqiptare dhe të atyre të para viteve '90. Është një objekt strategjikisht absolutisht i domosdoshëm, i vështirë, i komplikuar dhe për këtë arsye gjithmonë qeveritë e kanë pasur në plan, por asnjëherë nuk e kanë shtyrë procesin deri në fund, ne jemi përpjekur në këto vite të gjejmë aktorët e duhur që të mund të investoheshin për këtë projekt, por tanimë kemi vendosur që, siç thoshin njëherë e një kohë, ta ndërtojmë me forcat tona dhe do ta ndërtojmë Skavicën me 100% shtetin. Do të jetë një vepër e vështirë, por do jetë patjetër një vepër që do transformojë rrënjësisht sistemin, duke garantuar optimizimin e gjithë kaskadës, sepse dihet që Skavica është një element i munguar i projektit origjinal të kaskadës së Drinit dhe do jetë edhe fundi i derdhjes së ujit kur ka me tepri dhe i përmbytjeve që pastaj pasojnë si rezultat i derdhjes, pra i derdhjes së parave në formë uji në atë moment, duke shkaktuar dëme dhe duke i kushtuar pastaj buxhetit të shtetit gjithmonë shtrenjtë për të rikompensuar dhe për të ndihmuar njerëzit që të ringrihen."

Që nga marrja e drejtimit të qeverisë në vitin 2013, Kryeministri Edi Rama është hera e parë që flet për ndërtimin e Skavicës. Ndërsa qeveria e tij flet për herë të tretë.

Në mes të vitit 2014 u bë shkak një takim përfaqësuesve të konsorciumit Power China Corporation me ministrin e energjisë dhe Industrisë, Damian Gjiknuri, që Skavica të rikthehej për herë të parë në vëmendje. Por ndërkohë që pritej zhvillimi i negociatave me kompaninë kineze, qeveria shqiptare nisi procedurat për dhënien me koncension të HEC i Katundit të Ri, i cili dështoi.

Më 12 korrik 2017 qeveria shqiptare e paraqiti projektin e Skavicës në Samitin e Triestes, nga ku u premtua financimi nga Bashkimi Europian i këtij projekti. Në atë kohë, Majlinda Dhuka, Drejtore e Departamentit të Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri, gjatë një konference shtypi mbajtur me 14 korrik, tha se morëm "mbështetje për zhvillimin e hidrocentralit të Skavicës, një nga veprat më të mëdha energjetike të vendit dhe të Ballkanit Perëndimor".



Në atë konferencë shtypi mori pjesë edhe Kryeministrin Edi Rama, i cili si për të ulur diskutimet mbi çështjen e Skavicës, aq të debatuar në publik, nuk e përmendi fare Skavicën, por iu referua investimit mbi Rrugën e Arbrit, "si fillimi i realizimit të Programit "1 Miliardë për Rindërtim" të qeverisë shqiptare".

HEC MBI DRIN: NJË, DY APO TRI DIGA?!

Në mungesën e informacioneve të hapura për publikun, nuk dihet se si do të shkojë më tej procesi dhe nuk janë të qartë synimet e qeverisë në këtë drejtim. Nëse bëhet fjalë për ndërtimin e një, dy apo tre hidrocentraleve në rrjedhën e sipërme të Drinit të Zi.

WBIF, një institucion i ngritur nga Komisioni Europian në bashkëpunim me disa institucione financiare ndërkombëtare, që ka në fokus Investimet në Ballkanin Perëndimor, ka bërë publike të dhëna mbi Hidrocentralin e Skavicës.

Në përshkrimin e projektit WBIF rekomandon ndërtimin e dy HEC-eve mbi Dri, Skavica dhe Katundi i ri.

"Për të rritur sigurinë e energjisë dhe për të zvogëluar rrezikun e përmbytjeve në rrjedhën e sipërme të kaskadës ekzistuese të hidrocentraleve në lumin Drin i Zi, janë rekomanduar dy HEC-e të rinj: HEC-e me 50 MW në Katundi i Ri dhe 120 MW HEC në Skavicë", shkruhet në dokumentin e publikuar nga WBIF.

"Në vitin 2017, WBIF ka aprovuar një grant prej 1.5 milion Euro për zhvillimin e studimit të fizibilitetit dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social për ndërtimin e HEC Skavica, një digë shtesë, dhe një hidrocentral prej 132 MW, në rrjedhën e sipërme nga HEC-i ekzistues Fierza. Aktivitetet e ndërtimit planifikohen të fillojnë në vitin 2020", shkruhet në dokumentin e publikuar.

Televizioni SCAN can, në një kronikë të transmetuar para disa ditësh citonte burime nga Koorporata Energjitike Shqiptare, të cilat theksonin se studimi për Skavicën po kryhet nga "grupi i konsulentëve të Konsorciumit IPF6 (Infrastructure Project Facility)".

Sipas TV SCAN, "hartimi i studimit të fizibilitetit dhe Vlerësimit të Ndikimit Social-Mjedisor nisi në janar të vitit 2019".

Sipas WBIF, ky investim do të sigurojë 132 MW energji të rinovueshme, do të rrisë sigurinë e furnizimit me energji elektrike me G 450 GWh / vit dhe do të zvogëlojë rrezikun e përmbytjeve në 10,000 ha. Projekti pritet të krijojë 300 vende të reja pune gjatë ndërtimit dhe 45 vende të tjera pune në fazën e funksionimit.

WBIF parashikon një financim prej 247 milionë e 500 mijë euro për ndërtimin e Skavicës. Nga të cilat 40 milionë euro do të jetë financimi i qeverisë shqiptare dhe 206 milionë euro do të sigurohen përmes një kredie të BERZH. Ndërsa 1.5 milionë është grant nga vetë WBIF.

Sipas dokumentit të publikuar nga WBIF, nga ndërtimi i Skavicës do të sigurohet 119 MW të kapacitetit shtesë nga burimet e rinovueshme të energjisë, 470 GWh / vit prodhim shtesë energjie nga Skavica dhe Fierza, do të përfitojnë 70,000 familje nga prodhimi i energjisë elektrike. Rreth 1 milionë banorë do të përfitojnë nga masat e mbrojtjes nga përmbytja, 10,000 ha tokë rurale e bujqësore do të shpëtojnë nga përmbytjet e parashikuar në projektet fillestare. Numri i përgjithshëm i përfituesve llogaritet në 2.1 milionë banorë.

CILA ËSHTË WBIF?

WBIF (Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor) është një strukturë financimi që ka nisur në dhjetor 2009 nga Komisioni Evropian, së bashku me Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim (CEB), Banka Evropiane për Rindërtimi dhe Zhvillimi (EBRD), Banka Evropiane e Investimeve (EIB), Donatorë dypalësh dhe përfitues të Ballkanit Perëndimor me qëllim ofrimin e financimeve për projektet strategjike të investimeve.

WBIF bashkon grante, kredi dhe kontribute përfituese për infrastrukturën zhvillimi në sektorin e energjisë, mjedisit, social, transportit zhvillimin e sektorit privat.

WBIF deri më tani ka mbështetur 33 projekte në Shqipëri me një vlerë të vlerësuar prej 2.3 miliardë Euro

Përmes ndihmës së WBIF Shqipëria ka përfituar 46 grante për asistencë teknike dhe investime me një vlerë të përgjithshme prej 143.8 milion euro, nga të cilat 128.8 milion euro nga BE dhe 15.0 milion euro nga donatorët e tjerë.


Roli i këtij institucioni, përsa i përket hidrocentraleve mbi Drin, duket se do të jetë i rëndësishëm në gjetjen e financimeve.

PROPOZIMI I WBIF: Hidrocentrali i Skavicës parashikohet të kushtojë 247 milionë e 500 mijë euro. Nga të cilat 40 milionë euro do të jetë financimi i qeverisë shqiptare dhe 206 milionë euro do të sigurohen përmes një kredie të BERZH. Ndërsa 1.5 milionë është grant nga WBIF - Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor, e cila po përdoret për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe Vlerësimit të Ndikimit Social-Mjedisor


Kryeministri: Ndërtojmë Skavicën me 100% financim shtetëror

- **RAMA: "Është e padyshimtë që kjo vepër do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm për atë zonë, me Rrugën e Arbrit dhe me Skavicën, verilindja e vendit hyn në një fazë tërësisht të re në aspektin ekonomik dhe social".**

- **BECI: "Ne jemi të ndërgjegjshëm se alternativa më e madhe përmbyt një sipërfaqe të madhe, por një proces konsultimi, shpronësimi dhe bashkëpunimi mund ti japë një opurtinitet më të madh zonës"**



VARIANTI A: Kuota e hidrocentralit është 388 metra mbi nivelin e detit, 92 metra lartësia e digës, 17.6 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 326 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 120 MW dhe prodhim vjetor 479 GHh. Kosto e ndërtimit 308 milionë Euro, nga të cilat 250 milionë për ndërtimin dhe 58 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë.



VARIANTI B: Kuota e hidrocentralit është 443 metra mbi nivelin e detit, 147 metra lartësia e digës, 54 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 2319 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 210 MW dhe prodhim vjetor 915 GHh. Kosto e ndërtimit 510 milionë Euro, nga të cilat 350 milionë për ndërtimin dhe 160 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë prezantoi të mërkurën, 3 qershor 2020, studimin e fizibilitetit të kryer nga një kompani franceze në lidhje më ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës.

Ministrja Belinda Balluku pranoi në fjalën e saj se projekti ishte financuar nga WBIF dhe është financuar nga Samiti i Triestes. Ky detaj, megjithëse është bërë publik, nuk ka pasur informacione shtesë se ku konsiston (më shumë për këtë shih në kronikën e përgatitur).

BALLUKU: SKAVICA E KTHEN VENDIN NË "FUQI EKSPORTUESE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME".

"Ky është hapin i parë për nisjen e procedurave për ndërtimin e HEC Skavicës, si një ëndërr shumëvjeçare e hedhur si ide që në vitet '60-të, e risjellë në vëmendje herë pas here, por pa arritur asnjëherë finalizimin e projektit të saj", tha Balluku. "Qeveria Shqiptare ka në duar një studim konkret të këtij projekti, i cili ofron disa skenarë për ndërtimin e kësaj vepre".

Ajo u ndal në avantazhet e ndërtimit të Skavicës, duke optimizuar rritjen e prodhimit të energjisë në kaskadën e Drinit si dhe i jep një zgjidhje përmbytjeve të shumta për zonën e Fushë Shkodrës dhe Fushë-Lezhës. Sipas saj, nga ky projekt fitojnë 10 mijë banesa në këtë rajon. "70 mijë familje do të përfitojnë nga energjia e prodhuar nga Skavica dhe optimizimi i kaskadës", tha Balluku.

Avantazhe të tjera, sipas ministres do të jetë ulja e importeve të energjisë, si dhe rritjen e potencialeve energjitike të vendit, që ajo e quajti si "Fuqi eksportuese të energjisë së rinovueshme".

"Është e rëndësishme të theksohet, që sot nis ky proces me synimin, që brenda këtij viti ne të realizojmë një garë të hapur, transparente dhe ndërkombëtare, ashtu siç qeveria shqiptare bën, brenda muajit tetor, për të arritur në një instrument të rëndësishëm të kësaj gare, përmes dizenjimit të projektit të detajuar dhe të ndërtimit të veprës. Kjo është një vepër, e cila do të ndërtohet me fonde të Qeverisë Shqiptare, duke u mbështetur tek partnerët tanë financiarë, po përmend BERZH-in, i cili është ofruar për t'a financuar këtë projekt, duke qenë se dhe bashkëpunimi me WBIF, financuese e studimit të fizibilitetit, është një paketë, që ata zakonisht operojnë së bashku", theksoi ministrja Balluku.

Megjithatë, sipas ministres, ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës nuk do të jetë vetëm një lajm i mirë për sistemin energjetik shqiptar, por do të jetë një lajm i mrekullueshëm për të gjithë ekonominë shqiptare.

DREJTORI I KESH: DY VARIANTET PËR SKAVICËN, AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET

Pas Ministres Balluku, drejtori i KESH Benet Beci foli për të dhëna teknike rreth varianteve të propozuara, për të cilat do ti mbetet qeverisë shqiptare të vendosë.

Balluku dhe Beci, në fjalën e tyre përpiqen të mos e theksojnë përmbytjet që hidrocentrali do të bëjë në Dibër. Madje, si qëllimisht, ata flasin për një hidrocentral që do të ndërtohet në Kukës, duke iu referuar vendit ku do të ngrihet diga. Beci gjatë fjalës së tij e vendosi hidrocentralin "diku mes Peshkopisë dhe Dibrës", por më pas sqaroi se diga do të ndërtohet "21 km në jug të Kukësit dhe 26 km në veri të Peshkopisë".

Beci tha se studimi është kryer nga kompania franceze Tractebel në bashkëpunim me specialistët që ka në dispozicion KESH aktualisht si dhe me përvojën e inxhinierëve më të vjetër. Nga studimet e deritanishme me specialistë, KESH ka arritur në përfundimin se dy janë alternativat më të përshtatshme:

Varianti A: Digë më e ulët, liqen më i vogël.

Kuota e hidrocentralit është 388 metra mbi nivelin e detit, 92 metra lartësia e digës, 17.6 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 326 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 120 MW dhe prodhim vjetor 479 GHh. Kosto e ndërtimit 308 milionë Euro, nga të cilat 250 milionë për ndërtimin dhe 58 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë.

Varianti B: Digë më e madhe, përmbytet lugina e Drinit të Zi deri në kufirin me Maqedoninë e Veriut.

Sipas Becit, në variantin B, kuota e hidrocentralit është 443 metra mbi nivelin e detit, 147 metra lartësia e digës, 54 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 2319 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 210 MW dhe prodhim vjetor 915 GHh. Kosto e ndërtimit 510 milionë Euro, nga të cilat 350 milionë për ndërtimin dhe 160 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë.

Beci tha se "kriterët mbi të cilat është realizuar studimi kanë qenë: prodhimi, eficena në kaskadë, ndikimi në përmbytjet e Shkodrës - si një nga kushtet kryesore të studimit të projektit - dhe ndikimi social ekonomik në zonën e Dibrës dhe të Kukësi.

Sipas tij, "alternativa A nuk pritet të ketë ndikim të dukshëm në prodhimin e kaskadës, ndërsa alternativa B do të kishte ndikim pozitiv dhe vetëm nga eficensa e kaskadës do të ketë në prodhim shtesë prej 80 GWh në vit, me një fitim prej 4.5 milionë Euro në vit".

Ashtu si edhe ministrja Balluku, Drejtori i KESH, Benet Beci, kur flet për ndikimin mjedisor e social, fillon me efektet që do të kenë në punësim. Ai flet për një rritje të punësimit gjatë dhe pas ndërtimit, si dhe rritjen e punësimit përmes aktiviteteve të tjera ekonomike si peshkimi, turizmi etj. Por, sado që përpiqet që të mos e vendosë theksin të problematikat sociale, ai detyrohet t'i kujtojë qeverisë se duhet të bëjë një punë kolosale për të bindur publikun.

"Ky proces është i vështirë, ndaj kërkon një angazhim të madh të qevrisë për të bërë të mundur adresimin e problematikave që del por edhe adresimin e mundësive që shfaqen", tha Beci.

"Liqeni i krijuar nga Skavica e vogël shkon deri në Peshkopi, ndërsa liqeni i krijuar nga Skavica e madhe shkon deri në kufirin me Maqedoninë dhe efekti është jashtëzakonisht i madh në të gjitha anët", tha drejtori i KESH.

"Ne jemi të ndërgjegjshëm se alternativa më e madhe në fakt përmbyt një sipërfaqe të madhe, por sigurisht është një proces konsultimi, shpronësimi dhe bashkëpunimi mund ti japë një opurtinitet më të madh zonës", e mbylli prezantimin e tij Benet Beci, drejtor i KESH.

KRYEMINISTRI: NDËRTOJMË SKAVICËN ME 100% FINANCIM SHTETËROR

Kryeministri Edi Rama e nis me historinë fjalën e tij. "Bëhet fjalë për një ëndërr në sirtar të shumë qeverive të Shqipërisë, qysh në fundvitet '60, pasi e dimë të gjithë që projekti është ende i pafinalizuar, si rezultat pikërisht i mungesës së këtij komponenti të katërt, komponentit të Skavicës, që del në pah qysh në shkrimet e Dhimitër Frangut, Mesjetë, si pronë e Skënderbeut dhe një bastion i rëndësishëm i qëndresës, ku Gryka e Drinit rrethuar nga male shumë të lartë u shndërrua në një kështjellë natyrore të Arbërve".

Pasi bëri një historik të dështimeve të Skavicës, Rama tha se "ne e kthyem Skavicën në tavolinë dhe në vitin 2017 në Samitin e Triestes HEC-i i Skavicës u miratua si një ndër projektet prioritare të Procesit të Berlinit, ku, qysh në strukturimin e Procesit, në 2014-ën, ne u pozicionuam për të ndjekur me përparësi këtë rrugë, duke garantuar në radhë të parë, jo thjesht financimin e një studimi, por cilësinë e tij. Faktikisht, në 2017-ën projekti u pranua dhe sot ne kemi një pamje të detajuar nga një kompani me një biografi të njohur botërisht, kompania franceze, ku na jepet qartësisht pamja, por dhe rruga për tu ndjekur".

Kryeministri në fjalën e tij nuk iu adresua problematikave që do të dalin me përmbytjet, lëvizjet e popullatës, shpronësimet dhe problemet sociale që do të sjellë ndërtimi i Skavicës. Por ai foli për avantazhet që do të sjellë.

"Është e padyshimtë që kjo vepër do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm për atë zonë, me Rrugën e Arbrit dhe me Skavicën, verilindja e vendit hyn në një fazë tërësisht të re në aspektin ekonomik dhe social"...

"Të kombinuara bashkë avantazhet që sjell në ekonomi për të gjithë verilindjen Rruga e Arbrit me Skavicën japin përfundimin e thjeshtë, që, rilindja e vendit hyn në një epokë të re, ku, dua ta risjell këtu edhe aeroportin e Kukësit, si një komponent plus, pasi ajo që vjen me krijimin e gjithë zonës së re liqenore dhe me funksionimin e gjithë kaskadës edhe si një rrugë, apo si një "shteg" turistik, bën që të thuhet me plot gojën që edhe turizmi do të impaktohet në mënyrë të rëndësishme".

Më pas Kryeministri foli edhe për zhvillimin e agroturizmit e infrastrukturës por nuk ceku problematikat dhe rrugët që do të ndiqen më tej, që janë proceset e konsultimeve me publikun, shpronësimeve apo problematikave të tjera.

Gjithashtu, në fjalën e tij Kryeministri Rama nuk foli as për kundërshtarët e këtij projekti, të cilët e konsiderojnë përmbytjen e luginës së Drinit të Zi si një ndarje më dysh për së dyti, pas ndarjes së kufijve më 1912-tën.

BUJAR KAROSHI

DISA ARGUMENTA KUNDËR:
Skavica fundos 10 600 ha ose 55% të fondit të tokës në total. Ky rezervuar fundos nën ujë 8000 ha tokë nën kulturë, ose 64% të saj për tërë Dibrën. Ata që do të mbeten mbi kuotën e sipërfaqes të ujit, 443 m ku do të vështirësohet infrastruktura rrugore, shkollat, qendrat shëndetësore dhe mundësi të tjera që lidhen me përballimin e jetesës

debat

Skavica, projektet në vite

Ideja për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës fillon që në vitet 1960. Pas studimesh për rreth dy dekada, rreth viteve 1980 filloi të flitej publikisht për të. Sipas projektit të asaj kohe, hidrocentrali do të ndërtohej në grykën e Skavicës, ku shtrati i Drinit të Zi ngushtohet deri në 40 metra në një gjatësi 5-6 kilometra. Që në atë kohë studimi kishte paraparë dy zgjidhje te cilat në vetvete përbënin dy projekte të ndryshme.

Zgjidhja e parë parashikonte ndërtimin e një dige 163 metra të lartë, që krijonte një liqen artificial me nivel normal të tij në kuotën 445 metra mbi nivelin e detit. Vëllimi i digës do të ishte 11 milionë metër kub. Ky variant përmbyste luginën e Drinit të Zi deri në kufi me ish-republikën Jugosllave të Maqedonisë. Vëllimi i liqenit do të ishte 2.7 miliardë metër kub, sipërfaqja 60 km katror, fuqia e instaluar 350 megavat, si dhe energjia e prodhuar në vit do të ishte 1 miliardë kvh. Kosto e ndërtimin në këtë variant ishte parashikuar 600 milionë USD.

Zgjidhja e dytë parashikonte një digë shumë më të lartë, 210 metra, po në Skavicë, që e shfrytëzonte luginën e Drinit tërësisht. Vëllimi i digës do të ishte 16.5 milionë metër kub. Kjo digë krijonte një liqen me nivel normal në 485 metra mbi nivelin e detit dhe që kishte shtrirje e përmbyste deri në brendësi të territorit maqedonas. Diga ishte e parashikuar në të dy zgjidhjet të vendosej në kuotën 305 m mbi nivelin e detit në ceketinën e luginës, të krijuar nga lumi Drin i Zi (Gryka e Skavicës). Vëllimi i liqenit do të ishte 6.5 miliardë metër kub, më shumë se dyfishi i Liqenit të Fierzës. Sipërfaqja 95.5 km katror, fuqia e instaluar 350 megavat, si dhe energjia e prodhuar në vit do të ishte 1.3 miliardë kvh. Kosto e ndërtimin në këtë variant ishte parashikuar 950 milionë USD. Ky variant do të krijonte një kaskadë të në Drin me rregullim disavjeçar.

Me rënien e regjimit komunist, qeveritë në vend nuk patën kapacitete financiare për ta vazhduar projektin, kështu që gjithçka u la në mes.

Në Maj 2005, qeveria shqiptare miratoi në vendim "Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës sipas propozimit të pa kërkuar". Sipas këtij vendimi, Skavica do ti jepej me koncension grupit TGK (Tasara-Geo Tecna -Kinglor).

Por, më shumë se tre vite më vonë, më 17 dhjetor 2008, qeveria shqiptare hapi një tender për ndërtimet e HEC të Skavicës, në të cilën morën pjesë gjashtë kompani të huaja, mes të cilave, përveç TGK, ishin edhe Korporata Energjetike e Koresë së Jugut, shoqëria norvegjeze STATKRAFT, dy kompani austriake VERBUND dhe KELAG GRUP, si dhe konsorciumi gjerman "R.W.E" AG.

Më datë 5 janar 2009, komisioni i vlerësimit të ofertave duhej të shpallte fituesit për vazhdimin në fazën tjetër, por kjo nuk ndodhi kurrë. Qeveria shqiptare e asaj kohe pranoi dështimin vetëm një vit më vonë, duke ia vendosur për këtë fajin krizës ekonomike që kishte filluar të godiste eurozonën.

Por, kryeministri i asaj kohe, Sali Berisha, duke mos pranuar gjendjen e keqe financiare në vend, theksonte se "situata është më premtuese që qeveria të konsiderojë vetë ndërtimin e kësaj vepre gjigante. Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës, KESH-i dhe agjenci të tjera duhet ta shqyrtojnë me hollësi, duhet të hapë tenderin për projektin, nga studimet fillestare deri tek projekti i zbatimit, ose të përcaktojë parimet dhe ta tenderoi me çelësa në dorë".

Që nga viti 2009 deri në mes të vitit 2014, Skavica u harrua. U bë shkak një takim përfaqësuesve të konsorciumit Poëer China Corporation me ministrin e energjisë dhe Industrisë, Damian Gjiknuri, që Skavica të rikthehej në vëmendje.



Një sondë e kompanisë "Altea & Geostudio 2000" duke kryer shpime në territorin ku do të ndërtohet diga e Skavicës.

Por ndërkohë që kompani kineze kishin dhënë oferta për Skavicën, qeveria shqiptare i dha një kompanie turke bonus për ndërtimin e një hidrocentralit tjetër mbi Drin, atë të Katundit të ri, i cili hapi një debat të madh në vend në lidhje investimet energjetike mbi Drin.

Përveç kundërshtarëve, kryesisht banorëve të zonës, për mosndërtimin e asnjë HEC, ka edhe qëndrime që ndahen në mënyrën nëse duhet të ketë një HEC të madh në Skavicë, dy HEC më të vegjël në Skavicë dhe Katund të Ri, apo ndërtimin e tre HEC: Skavicë, Arras dhe Katundi i Ri.

Tenderi i HEC i Katundit të ri dështoi, megjithëse kompania turke kishte marrë 8 pikë bonus.

HEC i Katundit të Ri do të ndërtohet në një kuotë 445 metra. Parashikohej të kishte një kapacitet ujëmbledhës prej 12.4 milionë metër kub, me një fuqi të instaluar prej 49 MW dhe prodhim vjetor prej 206 GWh. Ky hidrocentral do të përmbytë vetëm 87 hektarë tokë dhe do të zhvendosë nga banesat e tyre 150 persona. Vlera e Investimit e HEC të Katundit të Ri do të ishte 99.5 milionë euro, por shoqëritë turke "Suzer Group" dhe "Nurol Holding" u tërhoqën nga gara.

Përgatiti:
BUJAR KAROSHI

OFERTAT E KOMPANIVE ENERGJETIKE NGA KINA

Qeveria shqiptare ka marrë propozime, madje ka firmosur edhe Letra Mirëkuptimi për ndërtimin e Skavicës së Madhe si pronë e KESH nga tre kompanitë më të mëdha në Kinë dhe në botë (PoëerChina, GeZhouBa dhe Norinco), që i propozuan qeverisë shqiptare (KESH-it) financimin 100 për qind të Skavicës së Madhe (1 miliardë euro), me një kredi të butë 35 vjeçare, 7 vjet periudhë mospagimi dhe në vazhdim 2 përqind në vit interes. Por qeveria nuk u ktheu kurrë përgjigje kompanive të mësipërme.

Power China, kompania më e madhe e hidroenergjisë në botë, me 53% të tregut botëror ka dorëzuar një ofertë pranë qeverisë shqiptare më datë 30 tetor 2014. Ajo parashikon një financim 1 miliard euro dhe do ta ndërtonte Skavicën me një "Leasing Contract" 15 vjeçare. Pasi me çmim mesatar të energjisë 5 €c/Mwh dhe me prodhim 2 milionë MWh në vit, Skavica do të gjeneronte 100 milionë euro në vit. Pra do të vetëshlyhej nga 12 deri në 15 vite.

Një ofertë të dytë të ngjashme qeveria ka marrë edhe nga kompania e dytë energjetike në Kinë, Ge Zhou Ba

Ndërsa oferta e tretë që qeveria ka marrë gjatë vitit 2014 është sërish nga një kompani kineze, NORINCO, një grup i fuqishëm industrial kinez, i cili ka propozuar një financimin 100%, 1 miliard euro, me një kredi të butë 35 vjeçare, 7 vjet periudhë pa pagesë dhe në vazhdim 2% në vit interes.

Në lojë është edhe një kompani gjermane, "Becker Büttner Held", e cila ka dhënë detaje mbi modelin e financimit të hidrocentralit të Skavicës.

REAGIME: NJË PËRMBLEDHJE E ARGUMENTEVE "PRO" NDËRTIMIT TË SKAVICËS

Përveç specialistëve të energjisë, zyrtarëve të KESH, firmave që duan ta ndërtojnë, edhe një pjesë e banorëve janë për ndërtimin e hidrocentralit. Por shumë prej tyre nuk janë në gjendje të argumentojnë idetë e tyre.

Agim Kasa, ish përgjegjës i statistikës në Dibër në vitet 1985-1992, në një shkrim në "Rruga e Arbërit", mars 2010, rreshton argumentet ekonomikë që bëjnë të domosdoshme ndërtimin e hidrocentralit.

"Pozicioni natyror – gryka e ngushtë ku rrjedh lumi dhe shpatullat e forta shkëmbore, e bëjnë atë një vend të përshtatshëm dhe të sigurt për ndërtimin e hidrocentralit. E jo vetëm për këtë arsye, por Skavica krijon rezerva ujore për gjithë hidrocentralet e vendosur pas saj: Fierza, Komani e Vau i Dejës duke optimizuar tërë funksionimin e kaskadës së Drinit".

Një tjetër zë, Ing. Emin Mysliu, jeta e të cilit është e lidhur ngushtë me hidrocentralet, e quan Skavicën punën e pambaruar të të gjithë linjës së shfrytëzimit të rrjedhës së lumit Drini i Zi për prodhimin e energjisë elektrike. Dhe për shkak të rëndësisë dhe kapacitetit të madh ujëmbledhës të rezervuarit, Skavica cilësohet si investim gjigant, i cili duke shtuar prodhimin e energjisë elektrike me 350 – 400 megavat, rrit jo pak por 15 % prodhimin e energjisë elektrike në vend.

Duke mbështetur këtë mendim të Mysliut, Kaca në shkrimin e tij thekson se "hidrocentrali i Skavicës është një vepër e madhe dhe se ndërtimi i veprave të mëdha kërkon edhe sakrifica të mëdha".

"Jam për ndërtimin e Skavicës, sepse mes dy alternativave zhvillimi ekonomik, me dobiprurëse për vetë ekonominë është prodhimi i energjisë elektrike se sa zhvillimi agrar i zonës orientuar nga bujqësia, blegtoria apo pemëtaria. Një histori shumëvjeçare, me gjithë format e ndryshme të pronësisë mbi tokën nuk flet tjetër veçse për zonë me zhvillim të varfër ekonomik. Baseni ujëmbledhës i Skavicës përmbyt tokën më pjellore të Dibrës, siç është Lugina e Drinit të Zi, që së bashku me Maqellarën na ka pëlqyer ta quajmë "hambari i Dibrës", por nuk ka qene krejt kështu. Skavica duhet të ndërtohet, sepse nga ndërtimi i saj sigurohen më shumë të ardhura nga prodhimi dhe shitja e energjisë, prandaj duhet menduar si të jemi zgjidhje e problemit të ndërtimit dhe jo te kthehemi në problem për ndërtimin e Skavicës", – shkruan Kaca.

"Pavarësisht argumenteve, ai bie dakord se qeveria duhet ta rishikojë politikën e kompensimeve dhe shpërnguljes së banorëve, në mënyrë që ata të mos kthehen në të braktisurit nga shoqëria apo të grabiturit nga qeveria. Skavica është ajo që duhet do t'i japë më shumë dritë Luginës së Drinit të Zi", thekson ai.

Skavica krijon rezerva ujore për gjithë hidrocentralet e vendosur pas saj: Fierza, Komani e Vau i Dejës duke optimizuar tërë funksionimin e kaskadës së Drinit.



Pamje nga Skavica

NJË PËRMBLEDHJE TË OPINIONEVE **KUNDËR** LEXONI NË FAQEN 5.

Dibranët nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës, dhe hidrocentralit të Shpilesë nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet pas humbjes së rreth 5000 hektarë të tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane. Sot të mirat nga prodhimi i rrymës përfitohen vetëm nga qeveria maqedone që nuk do të ja dijë nëse këto familje u detyruan të largohen në Turqi ose ShBA për të siguruar ekzistencën".

Edi Rama, për Skavicën pyet dibranët, jo partiakët e sharlatanët...



Pamje nga lugina e Drinit të Zi, Fushë-Çidhën. Foto: Hajredin Toca

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Edi Rama e mprehu shpatën edhe një herë për batakun...

Batakun që mbyt Dibrën, që zhduk një qytetërim, që e zhyt në mjerim.

Batak që bie erë të qelbur, erë korrupsioni, erë vjedhjesh të përmasave të papara e të padëgjuara...

Aferim kryeministri im që di shumë mirë vizatim por je elifi matrak në mendim.

Po si more vendose të mbytësh Dibrën duke ndërtuar Skavicën?

Ke tetë vjet që llap e llap pa pushim për Rrugën e Arbrit sa na plase veshët e na nxore trutë nga vendi dhe nuk po shohim një makinë të kalojë edhe gurë mbi gurë nëpër të.

I ndërron variantet si sulltani gratë e haremit...

Po e ndërton me para të pista të korrupsionit, të PPP-ve e të DDD-ve.

Kaq shumë të është rritur mendja sa del në pikë të mëngjesit si gjelat e Surrelit dhe këndon "Kikiriku do të ndërtoj Skavicën"!!!

Dhe si do ta ndërtosh?

"Me forcat e veta" !!!

Si, si?

"Me forcat tona".

Të kujt?

Të babës tënd ideologjik?

Enverit?

Ai edhe mund ta ndërtonte. Kishte në njërën dorë teskën e në tjetrën kakrrukun.

Bënte një Dibër të re...

Siç bëri një Kukës të ri, një Ulzë të re, një Darëzezë të re njëqind metra larg detit në vila dykatëshe mes pishave...

Nuk e ndërtoi.

Arsyet ti i di sepse ishe në prehrin e tij.

Po ti a je i zoti ta ndërtosh?

Madje me forcat tuaja?

A je i zoti të ndërtosh një Dibër të Re?

Të strehosh dyzetmijë banorë që u mbyten tokat, varret e të parëve, historia e betejave që Skënderbeu griu turqit osmanlinjme majë shpate në 18 nga 24 betejat e tij fitimtare në Dibër, të betejave kundër pashallarëve më të mëdhenj të perandorisë Osmane që në fushë të Gjoricës lanë "jo ma pak por dymbëdhjetëmijë" koka të prera, të betejave 1913-1922 kundër serbëve që synonin jo luginën e bukur të Drinit të Zi por edhe Durrësin, të betejave të Luftës së madhe antifashiste Nacionalçlirimtare...?

Të paguash dëmshpërblim për 65 kilometra katrorë tokë arë, pemëtore,

pyje, kullota...?

Jo me çmimin 500 lekë për metra katrorë por 100 euro për metra katrorë, pak, shumë pak sa sjell fitimi i energjisë elektrike që manjatët tuaj të dashur do të vjelin nga Skavica?

Ti përcolle në efirin mediatik se "HEC-i i Skavicës do të ndërtohet nga shteti. Qeveria po sheh mundësinë për një investim të madh të huaj në energjinë me erë. Përveç Skavicës, ka edhe projekte të tjera. Shumë shpejt do të materializojmë këtë investim.

Projekti do jetë shumë shpejt në realitet. Faleminderit atyre që bënë të mundur këtë projekt. Falënderoj ministren dhe ndihmëset e saj, falënderoj edhe sipërmarrësit e huaj për ndihmën e pakursyer",

Cili shtet z. Rama? Shteti që po jep shpirt?

Po për cilin projekt flet z. Rama?

Për atë të Enverit që i kishte kopsitur të gjitha deri tek mbytja e disa tokave në pjesën e Maqedonisë?

Apo për atë të Berishës që e uli digën që të mos hynte në telashe e të paguante tokat e Maqedonisë?

Apo për atë me tri diga që shkatërronte tërë sistemin ekologjik në hapësirën e gjolit të Skavicës?

Apo për atë të Gjiknurit që hapi fjalë se do të çojë buldozerët e do të ndërtojë hidrocentralin në Katund të Ri?

Berisha deklaroi për Skavicën: "Unë di të ndërtoj vepra botërore..."

Dhe asnjë kazmë nuk hodhi.

Ti thua se "HEC-i i Skavicës do të ndërtohet me forcat tona".

Aferim z. Kryeministër, aferim...!

Një gjë nuk the dhe e di se nuk do ta thuash.

Nuk the se a janë pyetur dibranët?

Ata që u mbytet toka dhe mbeten pa plëng e shtëpi, pa nder e histori.

Atyre që pas kësaj do tu duhet të marrin arratinë e si çifuti në shkretëtirë nuk do ta gjejnë kurrë "tokën e humbur".

Çoji emisarët tuaj matanë kufirit shqiptaro-shqiptar, në Dibër të Madhe dhe pyet se çfarë shkaktoi ndërtimi i HEC të Shpilesë për ta?

Po takuan Argëtim Fidën, ish kryetar i komunës së Dibrësdo të marrin këtë përgjigje:

"Dibranët nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës, dhe hidrocentralit të Shpilesë nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet pas humbjes së rreth 5000 hektarë të tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane.

Sot të mirat nga prodhimi i rrymës përfitohen vetëm nga qeveria maqedone që nuk do të ja dijë nëse këto familje u detyruan të largohen në Turqi ose ShBA për të siguruar ekzistencën".

Mësoj se Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka zbritur për të mbledhë firma për rindërtimin e teatrit edhe në Peshkopi.

Bëhet fjalë për njëmijë metra katrorë truall e një godinë e vjetër...

Mirë bëjnë, janë në të drejtën e tyre demokratike...

Por nuk e di në se po të njëjtën thirrje dhe mbledhje firmash do të bëjnë tash kur kryeministri ynë shkatërrues do të mbysë e zhbijë nga faqja e dheut Luginën e Drinit të Zi...

Nuk e di a ka dibranë në Dibër e kudo që janë, që do ti thonë ndal këtij seriali shkatërrimesh.

Dyshoj...

De këtë e mbështes në përvojën time kur bëhej thirrja "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!"

Dhe një këshillë: pyeti Dibranët, jo partiakët e sharlatanët...

Athinë, 27 maj 2020

REAGIME: NJË PËRMBLEDHJE E ARGUMENTEVE KUNDËR NDËRTIMIT TË HEC-it TË SKAVICËS

Ali Hoxha është President Nderi i Shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi". Ai thekson tre argumentet kundër ndërtimit të Skavicës.

Së pari, thotë ai, në aspektin ekonomik, Dibra është "Myzeqeja", hambari i zonës verilindore të Shqipërisë. Ky pellg i Dibrës ka mbajtur me bukë jo vetëm gjithë Dibrën, por edhe Lumën, Mirditën e Matin, bile dhe Tiranën. Por dëmi ekonomik, për ne, qëndron në plan të dytë në krahasim me dëmin që shkaktohet në aspektin gjeopolitik dhe etnokulturor.

Në aspektin gjeopolitik Dibra e Poshtme do të shpërbëhej, sepse pjesa lindore e Dibrës do t'i bashkëngjitej pjesës tjetër që ka mbetur nën pushtimin serbosllav qysh prej vitit 1913, kurse pjesa tjetër e Dibrës, në anën perëndimore të Drinit të Zi, do të copëtohej dhe do t'u bashkëngjitej rretheve të Kukësit, të Mirditës dhe të Matit. Pra, praktikisht nuk do të ketë më Dibër

Në aspektin etnokulturor dëmi është i pallogaritshëm, sepse nga përmbytja e këtij territori, asgjësohet një qytetërim i tërë, një etni e tërë, do të zhdukej e gjithë Dibra me gjithë historinë e saj, gjithë ato gjurmë të qytetërimit të lashtë iliro-pellazge, si dhe Principata e Kastriotëve dhe terreni ku u zhvilluan 19 betejat fitimtare të Skënderbeut, kundër superfuqisë më të madhe të botës në atë kohë, nga 24 beteja gjithsej që ai bëri kundër Perandorisë Osmane. Po kështu do të zhdukeshin edhe të gjitha varret e mijëra dëshmorëve të rënë për mbrojtjen e atdheut nga pushtuesit e të gjitha kohërave, duke u përmbytur përgjithmonë nga uji i atij "deti" artificial.

Ai më tej bëhet më i ashpër, duke i quajtur "tradhtarë të kombit " të gjithë ata qeveritarë që bëjnë përpjekje për ta ndërtuar hidrocentralin e Skavicës. "Të gjitha përpjekjet dhe projektet për shitjen, përmbytjen dhe asgjësimin e Dibrës dhe të historisë së saj janë tradhti kombëtare. Kjo sepse energjia e prodhuar nga HEC-i i Skavicës është projektuar jo për nevojat kombëtare, por për eksport dhe së dyti, për faktin se aq energji që parashikohet të prodhojë HEC-i i Skavicës, Dibra i ka të gjitha resurset, që nga ujëvarat e saj mund të ndërtohen rreth 10 (dhjetë) HEC-e të vegjël, të cilët do të jepnin po aq energjia elektrike sa ç'parashikon HEC-i i Skavicës, pa u dëmtuar asnjë pëllëmbë tokë. Në këtë aspekt, tradhti kombëtare do të bënim edhe ata dibranë që do të braktisnin trojet e veta, "vetëm për një euro", pasi do të humbasin identitetin e vet."

Një shembull të ngjashëm u vjen nga matanë kufirit. "Dibranët nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës dhe hidrocentralit të Spiles nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet pos humbjes të rreth 5000 ha tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane", i shkruante Argëtim Fida, në atë kohë kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe, gazetarit Abdurahim Ashiku, i cili është bërë një "zëdhënës" i përpjekjeve të kundërshtarëve të Skavicës.

Ashiku është kundër ndërtimi të çdo varianti të tij. "Si me një digë, si me tri diga, Dibra në rrënjë të saj shuhet", – thotë ai. Gjithë mendimet dhe opinionet kundër ai i ka përmbledhur në një libër publicistikë dhe vazhdimisht i kujton opinionit qëndrimin e tij kundër. "Midis 70 specialistëve të angazhuar 50 vjet më parë për studimin e kaskadës së Drinit – topologë, gjeologë, hidrologë, ing, hidroteknikë, mekanikë, elektrikë etj., nuk përmendet asnjë specialist mjedisi: agronom, zooteknik, inxhinier pyjesh, biolog, historian, arkeolog etj. Nuk merret mundimi dhe sot të pyeten askush prej tyre, a thua se jeta ekziston vetëm në saj të energjisë elektrike. Ashiku, ashtu si dhe Ali Hoxha, mbështesin mendimin se Dibra ka fuqi energjetike të fshehura, sidomos në hidrocentralet e vegjël. "Unë mendoj se në vend të Skavicës të ndërtohen një sërë hidrocentralesh të mesëm mbi degët e Drinit në Mallë, Veleshicë, Setë, Gramë, Gjalagjosht, Murrë, Okshtun... dhe qindra hidrocentrale të vegjël mbi degëzime më të vogla e mbi kanale ujitës. Kam përmendur një studim të viteve '80-të ku vetëm nga ngritja e hidrocentraleve mbi kanalet ujitëse dhe ujësjellësin e Peshkopisë prodhimi i energjisë elektrike rritej nga 15 milionë kilovatorë në 220 milionë që, siç thuhej atëherë, "Dibra ngrohej dhe gatuante me energji elektrike".

Gazetari Ashiku ka hartuar edhe një platformë me 9 pika për t'i bërë ballë përpjekjeve për ta ndaluar ndërtimin e hidrocentralit, mes të cilave spikat krijimi i një "Fondacioni për Mbrojtjen e Dibrës", që do të marrë përsipër gjithë procesin për kundërshtimin e ndërtimit të hidrocentralit.

Murat Koltraka, një ndër aktivistët e shoqatës "Për mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi", në një sërë shkrimesh me argumentet kundër Skavicës thekson se "40 vite ndërtimi i kësaj vepre ka frenuar e mban të ndrydhura energjitë e komunitetit të 30 fshatrave të këtij rajoni, projekte për zhvillim e mirëqenie, ecjen përpara të tyre në raport me mundësitë që ata kanë. Ata nuk janë e fajtorë para askujt, pse janë banorë të këtij vendi. Sipërfaqja e tokës bujqësore në Dibër është rreth 19 000 ha, kurse toka nën kulturë është 12 500 ha. Skavica fundos 10 600 ha ose 55% të fondit të tokës në total. Ky rezervuar fundos nën ujë 8000 ha tokë nën kulturë, ose 64% të saj për tërë Dibrën. T'i heqësh Dibrës 64% të tokës nën kulturë në rajonin më pjellor që përbën bazën e ekonomisë bujqësore për të, do të thotë të zbrazësh Dibrën nga dibranët"

"Nuk është rastësi as ai vendim fatal i vitit më 1913, kur Dibra një etni, një gjak, një gjuhe, me një kulturë, me një histori të përbashkët dhe në kufijtë e vet natyror ndahet në: Dibra e Epërme që u kaloi sllavëve dhe në Dibra e Poshtme që i mbeti Shqipërisë. Nuk është normale, që pas një shekulli Dibra e Poshtme të rindahet në dysh nga veriu në jug. Një projekt i tillë prish unitetin ekonomik dhe etnokulturor të Dibrës së Poshtme duke sjellë pasoja të rënda për të. Kjo vepër shkëput komunikimin e fshatrave kodrinor e malorë në perëndim me ata që mbetën në lindje", thekson studiuesi i historisë dhe kulturës, Murat Koltraka.

Të njëjtën ide me Koltrakën ndan edhe ish deputeti i Dibrës, Idriz Xhomara. Në një shkrim të tijin në gazetën "Rruga e Arbërit" në prill 2011, ai shkruan se "Ideja e ndërtimit të këtij hidrocentrali si rregullator i gjithë kaskadës të Drinit ka fillimin që në vitin 1984. Pa vazhduar më tej gjithë zhvillimi i pellgut të Drinit është mbajtur peng i kësaj ideje. Në një zonë me tradita shumë punëtore pothuajse ka munguar ose është ndërprerë fare krijimi i pemtorëve, vreshtave, ndërtimi apo riparimi i shtëpive apo çfarëdo investim tjetër. Dhe tani pas më shumë se një çerek shekulli, kjo mund të konsiderohet pa mëdyshje si një nga efektet me negative si në aspektin ekonomik që e përmendëm më lartë si dhe në atë social duke akseleruar shumë shpërnguljen e banorëve të kësaj treve".

"Banorët e zonës së përmbytur do të marrin një shpërblim dhe sigurisht që do të zgjedhin dhe vendin ku do të vendosen. Por problemi është për ato që do të mbeten mbi kuotën e sipërfaqes të ujit, 485 m ku do të vështirësohet infrastruktura rrugore, shkollat, qendrat shëndetësore dhe mundësi të tjera që lidhen me përballimin e jetesës të cilët sipas meje do të kenë dhe detyrimin për të mbartur, transmetuar dhe zhvilluar atë traditë, kulturë dhe histori që përmendëm më lart", mbyll shkrimin e tij Xhomara.

Rruga e Arbërit nr. 167

reportazh

Shpresojmë fshati të kthehet në një atraksion turistik, me kalldrëme e shtëpi të gurta, me urën të ndërtuar bukur, me buzëqeshje e respekte për njerëzit që do vijnë të vizitojnë fshatin e tyre.

Serveti i Cerjanit, një hero i heshtur

Nga **OSMAN XHILI**

Nuk di, nëse atë ditë fundmaji shkova të shoh fshatin e Cerjanit, Servetin, fermerin e talentuar të këtij fshati, apo të dyja njëherësh. Normalisht, që ata janë të pandashëm, një binom me dy gjymtyrë. Nuk isha vetëm në këtë udhëtim të mrekullueshëm. Ishte një ide e hershme, bashkë me profesorin e nderuar, po nga ky fshat, Hajredin Paci. Ai ka vite që banon në qytetin e Peshkopisë, por shpirtin, mendjen, zemrën, por pse jo dhe fizikisht është çdo ditë atje. Qershitë, dardhat, mollët, luleshtrydhet, mjedrat, patatet dhe shumë të tjera e presin çdo mëngjez dhe e përcjellin pasdite njeriun që udha jetë e shpirt, që i vadit e i plehëron. Por tjetër herë do të flasim më gjerë për profesorin e nderuar, tashmë në pension. Tojota e Avni Pacit deperton në rrugën, që dhe furgoni e ka të vështirë ta përshkojë. Si për ta bërë akoma më të plotë grupin tonë të vogël, është bashkuar dhe Islami, komshiu dhe miku i profesorit. Ai ka qenë gjithë jetën elektriçist, ndaj dhe tani në moshë 80 vjeçare lëviz si një djalë i ri në rrugët akoma të bukura të fshatit. Një lëndinë e bukur në hyrje, para se të shfaqen shtëpitë e para. Por makina nuk shkon dot më tej. Një përrua i frikshëm shfaqet përpara e aty kalojnë vetëm kuajt, mushkat e njerëzit. Profesori më tregon se dikur u bë një urë, por nuk jetoi gjatë, vetëm pak javë. E humbi betejën në përballjen e parë me ujin dhe u tret në të, si të mos kishte ekzistuar fare. Ikën 80 milionë lekë, iku shpresa se do të kalonin mjetet mbi të. Sërish do të zvarriteshin si skllevër, duke bërë në këmbë një kilometër rrugë, me trasta, me thasë e ngarkesa të tjera, që kishin blerë në qytet.

Sa pak ka ngelur nga krenaria e dikurshme! Atëherë kur kishte 160 familje e sot ka vetëm dhjetë të tilla, kur kishte katër klasë me 87 nxënës e sot janë vetëm tre nxënës në një dhomë të lëshuar me qira. Dyzet mijë kuintalë patate prodhonte dikur ky fshat e tashmë vetëm 1000 kuintalë. Sa e sa shifra kontrastohen e ndeshen frikshëm me njëra tjetrën, duke fituar bindshëm ato të para nëntëdhjetës. Shumë e shumë intelektualë të shquar dolën nga këto troje të lartsive të mëdha. Qazim Xhelili e Zeqir Prapa janë nga më të hershmit e më pas vjen brezi i





profesorëve si Hajredin Paci e Besnik Lami, Halim Lami, ekonomisti Ali Kaza, njerëz me shumë vlera e kontribute. Më pas një brez i tretë, po kaq i lavdishëm, si pedagogu dhe doktori i shkencave Hakik Paci, Selami Xhelili, Xhelil Paci e shumë të tjerë, që dhe pse larg mendojnë të bëjnë diçka për fshatin e tyre.

Ecim nëpër rrugët e rrugicat e fshatit. Shtëpi të braktisura, por që e ruajnë akoma rininë e dikurshme. Fare pak punë duhet për t'u kthyer në atraksion turistik, ashtu si vëllai i tij, Rabdishti. Tuba të zeza uji gjithandej, në tokë, në ajër e kudo. Nisen nga përrenjtë sipër fshatit e përfundojnë në parcelat e mbjella me patate. Mund të vihej një tubacion i madh e i vetëm në vend të tyre, duke kursyer më shumë e duke e bërë vaditjen më efikase.

Sa pak ka ngelur nga krenaria e dikurshme! Atëherë kur kishte 160 familje, sot ka vetëm dhjetë të tilla; kur kishte katër klasë me 87 nxënës e sot janë vetëm tre nxënës në një dhomë të lëshuar me qira.
Dyzet mijë kuintalë patate prodhonte dikur ky fshat e tashmë vetëm 1000 kuintalë.
Shumë e shumë intelektualë të shquar dolën nga këto troje të lartësive të mëdha. Qazim Xhelili e Zeqir Prapa janë nga më të hershmit e më pas vjen brezi i profesorëve si Hajredin Paci e Besnik Lami, Halim Lami, ekonomisti Ali Kaza, njerëz me shumë vlera e kontribute.

SERVETI, NJË HERO I HESHTUR

Kalojmë shtëpitë e para, të tjera akoma e ja tek po kalojmë në skajin tjetër. Atje ndodhet Serveti, me stallën e tij, me tufën e tij të dhenve e dhive. I vetmi fermer, që të kujton se këtu ka pasur disa tufë, që i jepnin hijeshi e bukuri fshatit, me këmborë e blegërima. Ka tre vite që e ka ndërtuar stallën e re, gati 180 metër katrorë dhe që i ka kushtuar 18 milionë lekë. Sa mund e sakrifica ! Të gjitha materialet me krahë e me kalë, në dykilometër distancë, që atje ku duhej të ishte ura. Asnjë ndihmë nga shteti. Ai është me të vërtetë një hero, një hero që e ka zgjedhur këtë profesion që fëmijë, gati 30 vite më parë. Para dy vitesh dëbora kishte mbuluar çdo gjë si me një jorgan të trashë. Tek përroi ajo kishte krijuar një shtresë akoma më të trashë nga erërat, gati tre metra të lartë. Nuk mund të futej me këmbë, se do të fundosej. Ai lëshohet me not mbi dëborë dhe ashtu si një luan e kalon pjesën e vështirë për të shkuar te tufa që e priste me padurim.

STANI I FERMERIT

Dhe aty mbi fshat, ku i ka delet sot, mund ta quash stan e bjeshkë, por vetëm pas pak ditësh, Serveti do ti ngjisë delet akoma më lart. Ai vend quhet "Livadh i Madh". Të gjitha punët ai bënvetë. Vetë imjel, vet i kullot dhentë, e po vetë e merr qumështin me kalë apo me motor dhe e dërgon poshtë për ta kthyer në djathë. Mezi pres për ta parë atë vend, që Serveti ma përshkruan si të bukur, të rrafshët, me gurgullima uji e lule shumëngjyrëshe. Atij i hanë duart për punë. E ka pastruar bjeshkën nga ferrat, ka bërë një lug llamarine, ku pijnë ujë delet. Ka ndërtuar një stallë tjetër atje te stani dhe e ka rrethuar vendin për ta mbrojtur nga egërsirat, Ka bërë dhe një dhomë të vogël, për vetë, por dhe për ndonjë mik, që mund të ngjitet atyre anëve.

Kur e pyet për të ardhmen, ai nuk vonon gjatë në përgjigje. Serveti nuk mendon alternativë tjetër, përveç blektorisë.Nuk mund ti bënte vetë të gjitha punët, po të mos ishte Nertila, bashkëshortja e tij e palodhur. Ata kanë shtëpi pritëse në Llixha dhe ajo menaxhon klientat jo të paktë në numër. Bën pazarin në qytet, apo nget makinën për të sjellë lart ndonjë furnzim e për të ulur poshtë qumështin, apo të marrë ndonjë qingj të therrur, që e gatuan poshtë, në qytet.

Këtë vit Serveti do të ngjisë lart rreth 400 kokë, kurse dy vite më parë kishte 700 krerë. Ai sërish do të ndërtojë një stallë të re. Është shumë e nevojshme për të, pasi në ditë të ftohta tufa mund të qëndrojë brenda për disa orë. Vetëm para një jave ra kaq shumë breshër, sa nuk u shkri deri të nesërmen.

Duke vizituar Servetin nuk na kishte shkuar mundi kot. Kisha njohur një njeri, që aq shumë e donte tufën e dhenve, aq shumë e dontë punën, aq shumë e donte fshatin. Shpresojmë që bashkë me shokë të tjerë do ta kthejnë fshatin në një atraksion turistik, me kalldrëme e shtëpi të gurta, me urën të ndërtuar bukur, me buzëqeshje e respekte për njerëzit që do vijnë të vizitojnë fshatin e tyre.







aktualitet

Allajbegia është një nga 22 fshatrat e Maqellarës, por nga vlerat dhe historiku i kalon përmasat e një fshati të zakonshëm.

Orteku i punëve të mira







Nga **OSMAN XHILI**

Allajbegia është një nga 22 fshatrat e Maqëllarës, por nga vlerat dhe historiku i kalon përmasat e një fshati të zakonshëm. Nëse do ti referoheshim historisë, të paktën do të dallojmë tre kulme, që i japin pikërisht ato vlera dhe atë të veçantë.

Allajbegia është një vendbanim gjashtë mijë vjeçar, ndër më të vjetrit jo vetëm në Shqipëri, por dhe në Ballkan. Kjo nuk është një shprehje e hedhur në ajër, por e bazuar në kërkime të mirëfillta shkencore nga dy ekspedita arkeologjike. Herën e dytë, në vitin 2017, në krye të punimeve, në vendin e quajtur "Livadh i Madh", ishte profesori i shquar i Dibrës, Adem Bunguri. Dhe sot e kësaj dite, saherë që fermerët punojnë tokën me zetorët e tyre në këtë vend, del diçka, send, objekt, që i takon kësaj periudhe dhe e konfirmon atë që thamë.

Një tjetër kulm i këtij trekëndëshi vlerash është dhe xhamia, që të paktën është 500 vjeçare. Gurët kuadratikë në muret e saj, të bukur e vezullues, të gdhendur me kujdes, janë dëshmi e qartë e kësaj teze. Ndërtuesi i saj ka qenë sheh Murat begu, një feudal i fuqishëm i asaj kohe,normalisht dhe njeri besimtar. Për fat ajo nuk u prish as në kohën e komunizmit, duke u shpalluar monument kulture i kategorisë së parë, që mbrohej nga shteti. Dhjetra breza besimtarësh, janë falur në atë xhami e ky ritual vazhdon deri në ditët tona, duke hequr mungesën prej një çerek shekulli gjatë viteve të sundimit komunist.

Një tjetër kulm i këti trekëndëshi është hapja e shkollës së parë shqipe në fshatin tonë, 102 vite më parë. Parvjet organizuam një ceremoni të bukur në nder të këtij eventi të rëndësishëm. Erdhën miq nga Tirana, nga Peshkopia e Bulqiza në festën tonë. Kryetari i bashkisë, përfaqsues nga drejtoria arsimore, ish mësues e nxënës dhe plot miq e shokë të tjerë. Media dhe televizione i bënë jehonë kësaj ngjarje të bukur.

Ishin këto tre kulmet, tre vlerat e pakontestueshme të këtij venbanimi të lashtë, me njerëz të ditur e fisnikë, që përpiqen ti ruajnë këta vlera, ti shtojnë e ti përcjellin më tej në brezat e tjerë.

AKSIONI I RADHËS

Ajo nisi thjeshtë, si një lojë, si një puhizë e lehtë, që kthehet në erë të fortë, si një pupël bore, që përbën bërthamën e ortekut të mëvonshëm. Një grup i madh të rinjsh, të ulur në lëndinë, aty pranë dyqanit të fshatit, luanin me letra e diskutonin për problemet e tyre. Mund të kishte plot mënyra të tjera më të dobishme për të kaluar kohën. Ishin ulur përtokë, kur mund të viheshin stola e karrige, qëndronin në diell, kur mund të mbilleshin pemë e të pushonin nën hijet e tyre. Dëshiroja që fuqia e tyre të konvertohej në punë e vepra të bukura, ndaj u afrova për tu zgjuar dëshirat. Dikush tha se mund të mbillnim ca bredha e një tjetër propozoi një lulishte të vogël. Dani, një nga të rinjtë e fshatit, u ngrit në këmbë. – Na vendos një letër o xhaxhi Osman, aty te dyqani dhe të gjithë të japin sipas dëshirës. Unë, - vazhdoi ai, - po të jap këto 500 euro. Tek ti kemi besim të plotë. Të tjerët le të mendohen.

Urimi, një tjetër, nga grupi i të rinjve, u ngrit në këmbë. Shkoi në shtëpi dhe solli 500 euro, që mi la në dorë, si shoku para tij. Plot njëmijë euro në pak minuta. Ata mjaftonin për të blerë mbi 100 bredha, që do ti vendosnim anës rrugës.

Lajmi u përhap me shpejtësi.Të nesërmen nxorrëm një komision të vogël dhe e dërguam në të gjitha shtëpitë e fshatit. Le të jepnin, kush më shumë e kush më pak, sipas mundësisë e dëshirës. Të gjithë u përgjigjën. Kishte ndonjë familje që dha pesëmijë lekë të vjetra. Aq ishte mundësia e rrethanat. Ndoshta tek Zoti i

Mbi dyzet të rinj u bënë sërish bashkë në iftarin e organizuar në oborrin e shkollës. Sasia dhe cilësia e ushqimit, por dhe të qenurit sërish bashkë , u krijoi bindjen se duke qenë të bashkuar mund të bëjnë punë të mëdha. Nëse në fillim folëm për tre kulme lavdie, këta të rinj i shtuan dhe një kulm krenarie e dinjiteti këtij fshati,duke kapur kuota të reja.

Gjithësisë, ato pak para kishin shumë vlerë,se Zoti nuk obligon njeri më shumë se ai ka mundësi. Fjala shkoi deri në Itali, Gjermani, apo shtete të tjerë, kudo ku ishin djemtë e këtij fshati historik. Ata nuk nguruan të sjellin nga 100 euro, më pak apo më shumë, për të kontribuar sadopak në zbukurimin e fshatit. Në pak kohë u pastruan varrezat e fshatit, u hoq rrethimi i vjetër dhe u bë një tjetër, shumë më i bukur, me rrjeta të shtrenjta. U mbollën mbi 130 bredha në të gjithë gjatësinë e rrugës prej 400 metrash. Teksa po bëhej rrethimi, i them Hakiut, një specialist duarartë i fshatit. – E bëjmë, që e bëjmë gjithë gjithë këtë punë, përse nuk i fusim ca tela e llampa ndriçimi, ta prezantojmë veten si qytetarë europianë. Ai ishte pro kësaj ideje dhe po kështu të tjerët. I blemë 35 abazhurë të bukur, që Hakiu i përshtati dhe i modifikoi shumë bukur. Dy netë para Bajramit, kishte përfunduar çdo gjë. Sapo muzgu fillonte të pushtojë hapësirën, rrjeti i ndriçimit krijonte automatikisht një pamje të mrekullueshme, vezulluese, deri në agim.

Ndërkaq, dy sipërfaqe të lira, aty në qendër të fshatit, u konceptuan në formë lulishtesh. U rrethuan me bredha dhe u vunë në mes blina, për tu pasuar më tej me stola, lule dhe elemente të tjerëdekorativë. Nuk do të uleshim më përtokë e në diell, por në stola dhe në hije.

NDERSHMËRI DHE TRANSPARENCË

Që kur filloi grumbullimi i parave nga banorët e fshatit, u vu një listë në xhamin e dyqanit, në qendër të fshatit. Ishte hera e parë në tridhjetë vite demokracie, që bëhej një transparencë e tillë. Çdokush mund ti shihte listat, të gjente emrin e tij dhe shumën që kishte dhënë. Listat qëndrojnë akoma aty dhe askush nuk ka vërejtje për pasqyrimin e të dhënave. Ka dhe persona që nuk janë banorë të fshatit dhe kanë dhënë kontributet e tyre. Musa Riçku është nga Limjani dhe nuk ka asnjë lidhje me fshatin, por dha bujarisht 100 euro. Kjo është vetëm një pikëz nga ato kontribute të shumta, që ai dhe familja e tij dhurojnë çdo ditë, javë e vit, pa u trembur se i pakësohet pasuria. Vetëm në festat e Bajrameve, ai përgatit qindra pako me ushqime për njerëzit në nevojë, me dëshirën që tu kthejë buzëqeshjen dhe shpresat për jetën.

Një tjetër Musa, jo pak i njohur për Dibrën u bashkua me nismën tonë. Ai është ndërtuesi Musa Selami, që bashkë me Mirush Sulën, nipin e këtij fshati, dhuruan bujarisht një paletë me 20 kunjtalë çimento të cilësisë së lartë. Fatos Dani nga Potgorca sjell një zetor me zhavor, kurse Vini, vëllai ynë besimtar, na solli peshqesh pesëdhjetë llampa ndriçimi për abazhurët. Një tjetër emër i bashkohet nismës sonë. Ai është Petrit Besatari që banon në Elbasan. Rrënjët e hershme të tij lidhen me fshatin tonë, ndaj ai afron bujarisht një shumë simbolike ndihme, si dhe një komplet të bukur karrigesh, bashkë me tavolinën.Listës së personave që ndihmuan bujarisht u shtohen dhe disa vajza të këtij fshati, si Shqipe Xhili, Ferizate Sala, Kujtime Xhili apoDiana Sala, duke kujtuar se u lindën dhe u rritën në këtë fshat të bukur e me shumë histori. Krahas listës së kontributeve në dritaren e dyqanit, u vendos dhe një tjetër listë. Ajo kishte të shkruar të gjitha shpenzimet që ishin bërë deri tani, me detajet më të vogla. Sa bredha ishin mbjellë, sa hekur, çimento e zhavor ishte blerë? Sa abazhura ishin përdorur, sa metra tel e tuba, të gjitha këto të shoqëruara me faturat përkatëse. Një njeri me shkallë arsimimi minimale, mund të verifikonte, listën e parë, të dytën, të bëntë krahasimin e të qetësohej në shpirt, se asnjë lekë i ardhur nuk ishte prishur pa kriter. Listat ishin bërë në tre kopje, që të shiheshin nga të gjithë.

I theksuam të gjithë këto detaje për të dhënë një mesazh të madh, që na ka munguar shumë në këto vite demokracie, transparenca ndaj publikut. Është ky një mesazh që i bëhet klasës politike shqiptare, të majtë e të djathtë, që ka shpërdoruar pa kriter fondet publike. Është ky një mesazh se nuk mund të vazhdohet më tej me tendera e prokurime fantazmë që gëlltisin miliona euro, duke lënë në varfëri ekstreme mijra familje shqiptare. Duhet punuar me duar të pastra, siç bëmë ne në aksionin tonë, që të ndalet eksodi tragjik i shqiptarëve nëpër botë. Ka ardhur koha që ti kthejmë vetes dinjitetin dhe krenarinë e të qenit shqiptar.

TË RINJTË, KRENARIA E FSHATIT.

As mund të mendohej ky aksion i madh për zbukurimin e fshatit, pa ndihmesën dhe kontributin e tyre.

Nëse u shpenzuan mbi shtatë milionë lekë për materiale, po kaq është vlera e punës vullnetare që kanë bërë të rinjtë. Firma ndërtuese Hamja, nga fshati ynë, i bëri pa asnjë lekë të gjitha punimet teknike të rrethimit, që përkthehen të paktën në dy mijë euro. Ata janë tre breza ndërtuesish të talentuar, që nga gjyshi Kadri, babai i tyre Jonuzi dhe tani, ata dy vëllezërit, Flori dhe Miri.

Një tjetër hero i kësaj veprimtarie është dhe Haki Sala,mjeshtri i ndriçimit, bashkë me djalin e tij, Lumin. Që të dy, punuan pa u kursyer aspak, deri në ditën e fundit të punës. Po tavlerësoshnë lekë punën e tyre shkon sëpaku mbi 500 euro. Rifat Xhili e Lirim Piku punuan bashkë me të rinjtë nga momenti i parë, tek i fundit, duke u bërë shembull dhe frymëzim për ta. Lavdiu, Blerimi, Nesti, Klodi,Urimi, Redoni, Arseni, Joni, Eri, Tini, Vini, Armandi, Konti, Xeni, Genci e plot të tjerë, ishin pjesë e atij grupi të hekurt, që duan ta lartësojnë emrin e fshatit të tyre.

E di që ka dhe shumë për ti përmendur, por ata nuk e bënë këtë për të shkruar emrin diku, por për një qëllim akoma më të lartë, ndaj vetëm Zoti mund t'ua japë shpërblimin. Dy tre ditë ditë para festës, organizuam një iftar si shpërblim moral i asaj pune titanike që ata bënë.

Mbi dyzet të rinj u bënë sërish bashkë në iftarin e organizuar në oborrin e shkollës. Sasia dhe cilësia e ushqimit, por dhe të qenurit sërish bashkë , u krijoi bindjen se duke qenë të bashkuar mund të bëjnë punë të mëdha. Nëse në fillim folëm për tre kulme lavdie, këta të rinj i shtuan dhe një kulm krenarie e dinjiteti këtij fshati,duke kapur kuota të reja.

Thuhet që oreksi vjen duke ngrënë, ndaj ne nuk ndalemi në rrugëtimin tonë për të zbukuruar fshatin. Para se të ndryshojmëambjentin, duhet të ndryshojmë mentalitetin tonë, që shpesh le për të dëshiruar. Sistemimi i rrugëve, mbjellja e pemëve të tjera në sezonin e vjeshtës, krijimi i parqeve të reja për fëmijë e për të rritur, janë vetëm disa prej prioriteteve tona.

Në mendje na vjen krijimi i një fondacioni me emrin e fshatit, "Allajbegia".

Le të jetë ai një dritë shprese, bujarie, për njerëz në nevojë, një burim i pashtershëm për zhvillime pozitive.

Rruga e Arbërit nr. 167

emigracion

Xhevdet Krrashi që më mori fluturim maleve të Çidhnës

Dhe më uli qetë-qetë brigjeve të jetës së tij në mërgim.

Në vitin 1993 isha në Rodos. Më kapi policia dhe kam ardhur 18 orë me pranga në duar nga Rodosi në Pire me një traget që quhej Milena...



Po, po, më mori siç merret zogu nga foleja e më hodhi fluturim atyre maleve ku bukuria shkrihet në heroiken.

Më mori nga ngujimi i çuditshëm përmes hapësirave të hekurta, të ngushta deri në ekstrem, të dhunshme deri në përçudnim,

Unë jam Xhevdet Krrashi, më tha.

Si, si, - i them, për ta fiksuar mirë në celuloid, Servet...

Jo, jo. Xhevdet. Xhevdet Krrashi, djali i Xhem Krrashit nga Arrasi,lindur në vitin 1968.

E kam shtëpinë tek Ura e Setës...

Prit, prit pak, ta kaloj urën ku herë - herë takohesha me një mikun tim elektricist në profesion por i dashuruar pas gazetës, Halil Krrashin, prit të marr majtas Rrugës së Rinisë që kështu e patën quajtur në vitin 1946 e që e harruar mbeti sa u plak. Prit të marr një kthesë të vogël e të ndalem të pi një kafe në atë ballkon të bukur që sheh rrjedhën e fundme të Setës tek bashkohet me Drinin, fushën e bukur të Çidhnës për tu ngjitur në Gramë e flladitur me ujin e bjeshkës së Zonjave. Kafen dua ta pi me Mersin Krrashin. Është mik me ne, ka dhënë gjakun e vet për një nip, gjak të Ashikëve të Brezhdanit...

Bash aty i kam trojet e mija...

Bash, bash aty? – them për ta nga vrapin atyre vendeve që nuk e di, megjithëse nuk kam pas gjak shtëpie të udhëtoj viteve të fëmijërisë e ta njoh duke ecur këmbëzbathur, tërë plagë mi gurë rruge mushkash e ferrash porendesh.

Me origjinë jam nga Çidhna...

Nga Gryka e Nokës?- e çoj fluturimin tim në ngjitje atij katundi që nis nga një burim uji nën një lis shekullor ku "kanuni ndahej mbi kalë", kalon në një pyll thanash rreth kanalit të Setës për tu ngjitur e ndalur tek Ruset ku në një kullë në dy pode kam kaluar natën e kam pi nga ajo lloj kafeje që ka aromën e një mikpritje që nuk gjej fjalë ta kap e ta ve në radhë.

Në Grykë Nokë jam nip...

E ke fjalën për Çidhnën ku ka një kullë në tre pode, nga shalishini i të cilës një rrjedhë uji valë të nxehtë zbriste e ia priste hovin hasmit që desh të thyente derën me dërrasë pishe pesëshe...

Po, po, atje i kemi pas shtëpitë tona...

E kujt ka qenë ajo kullë?

E Idris Krrashit Baba iSelmanit dha Arifit. Sot banon Petriti.

Rrënjët tona vijnë nga Ibrahim Krrashi e Fer Krrashi. Fera ka pas pesë gra. Me të parën nuk ka pas fëmijë. Me katër tjerat një "lagje" të tërë. Ti tregoj një ditë tjetër emër për emër...

- Mirë, i thashë, do udhëtojmë përsëri bashkë ti gjejmë e ti takojmë...

- Në vitin 1936 zbritëm poshtë. Jemi 30 shtëpi Krrashe dhe dy Ruse...

Aty lindi Xhevdeti, në atë tarracë natyrore rrethuar me gjelbërimin e dushkut e me këngën pambarim të rrjedhës së Setës që lan këmbët e krrashe.

Në Arras, nja 2-3 kilometra larg shtëpisë nisi shkollën fillore. Mban mend mësuese Suzana Bajraktarin, të shoqen e Sul Bajraktarit nga Shkodra. "Zonjë fare" thotë për të...

Shkollën tetëvjeçare do ta fillonte në Sinë, dy vjet në një rrugëtim të përpjetë dy orësh vajtje e po kaq ardhje. Aty do t'i jepnin mësim Avni Hakorja, Bexhet Ashiku, Gëzim Kaba, Naim Berisha. Për Naimin, i cili tash është në Angli, ka fiksuar në kujtesë një fejton në gazetën "Ushtima e maleve" me titull "Çanta alle alle, arrna fut e zezë dhe cicmic". Fliste për autorin që kishte çuar për të rregulluar çantën tek këpucari i çantave. Kishte shkuar katër herë e çanta nuk ishte kapur me dorë. I gjen duke luajtur cicmic...

Detaj i bukur për të qarë e për të qeshur!

Klasën e shtatë dhe të tetë i bëri në Grykë Nokë...

I vdiq e ëma. Mbeti jetim. Se nëna të le jetim kurse baba të varfër.

E pyes për një mësues, Rexhep Leshin që asokohe nuk pushonte së shkruari letra. Pata pi kafe në shtëpinë e tij. Kisha qenë edhe në një mbledhje të këshillit pedagogjik...

Më thotë që e ka pas mësues duke i vënë notën " I përkryer fare". Vëllain e tij e ka pas shokë të ngushtë, fatkeqësisht vdiq i ri.

Në Çidhën më thotë kisha drejtor Bardhul Cibakun, dhëndër i Krrashe, i Mersim Krrashit...

Një udhëtim nëpër shkolla, dy orë larg nga shtëpia, një gjeografi që edhe ta mendosh lodhesh e jo më të ecësh në këmbë, dimër e verë, në baltë, borë, shi, akull...

Për të kaluar më tej Drinin për tu ndalë në Kastriot e Fushë-Çidhën, jo në shkollë të mesme të rregullt por në shkollë nate...

E kishte një njollë mbi trupin fëmijëror, ishte arratis daja...

Kjo do ta pengonte për shkollë, kjo do ti priste rrugën për dëshirën e tij të madhe që të merrej me pikturë. Një burokrat partiak që e citon me emër e mbiemër ia kishte përmendë në konkurs dhe ia kishte pre rrugën...

Seta rridhte si gjithnjë nga Gurë Lura, midis atij peizazhi ku fjala "mrekulli" është e varfër, mbushur me burimet që dilnin nga shpella e Sopanikës së Gurë Lurës e ujëvarave të Sopanikës së Çidhnës. Rridhte e bashkohej me Drinin. Përziente ujërat, përziente kohët.

Pas shërbimit ushtarak ku në një kurs merr diplomë si infermier, shërbimit në spitalin ushtarak merr tjetër rrugë, të gjatë, të lodhshme, plot të panjohura, mbushur me sakrifica...

"Në kurbet erdha në vitin 1991. Erdha në këmbë dy herë. Rrugët e tjera i kam bërë me makinë, me para. Në vitin 1993 isha në Rodos. Më kapi policia dhe kam ardhur 18 orë me pranga në duar nga Rodosi në Pire me një traget që quhej Milena. Ishte koha kur i hoqën mjekrën priftit në Gjirokastër në vitin 1994. Më kishte kapur policia 11 herë atje. Isha me dokumente fallco.

U ktheva në Korfuz ku punova dy vjet. Pas Korfuzit u ktheva në Tiranë u martova, ndeja dy vjet në Tiranë. Nuk më pëlqeu se filloi lufta. Më lindi një fëmijë. Kisha një variant për të ik në Austri. Nuk ika.

Këtu kam mësuar një gjë: Njeriu kur lind tri gjëra duhet t'i mësojë: Më fal! Faleminderit! Të lutem! Këtë nuk e themi ne dhe ky është zhvillimi që na len mbrapa. Kjo është fatkeqësi për ne se Fadil Hasa ka thënë se populli shqiptar është 100 vjet prapa dhe 50 vjet anash. Ne akoma nuk kemi dalë në rrugë kryesore. Ne nuk na le mendjemadhësia. Sado talent e profesion të kesh, po pate mendjemadhësinë, i ke fshirë të gjitha.

Nxjerr një vizë njëvjeçare dhe vij në Athinë.

Në Athinë kam ndejë në një shtëpi të rrënuar një vit e gjysmë, vuajta.

Fati që rregulluam letrat. Pasi bëra letrat punova këtu fort. Punova 20 vjet në ndërtim, i pavarur dhe me dashje pa dashje kam luajt rolin e inxhinierit dhe kam bërë si më ka dashtë qejfi, por kam vuajtur aq sa nuk ka vuajt babai në luftë.

Këtu më lindi vajza e vogël. E madhja ishte dy vjeçe. E madhja mbaroi universitetin për turizëm, punon ke OTE-ja e madhe, e vogla është në Patra në vit të parë në të lartën për shkenca natyre, me një fjalë agronominë.

Vuajtjet janë të paharruara për shqiptarin. Është ajo që thonë se varri i kalit dhe i njeriut nuk dihen kurrë.

Sot për sot punoj në ndërtim. Të gjitha punët i bëj. Të gjitha punët i marr vetë. Jam i pajisur me të gjitha pajisjet që tek skelat e makineritë e ndryshme të ndërtimit. Paratë i kam bërë vegla sepse me ata lidhet jetesa.

Kam 20 vjet që paguaj shtëpi me qira për strehimin e veglave. Tre shtëpia me qira paguaj çdo muaj, shtëpinë ku rri, shtëpinë ku studion vajza dhe shtëpinë e veglave.

Kisha ndërmend të bëj shtëpim por e prisha se bleva shtëpi në Sarandë, bëra shtëpi në Tiranë, dy shtëpi private. Me djersë e me gjak.

Këtu jam me dokumente. Pasaportë greke kanë marrë fëmijët kurse unë jo.

Gruaja ka mbaruar shkollën dy vjeçare për permanent flokësh. Ka klientelën e vet.

Çfarë ke menduar për të ardhmen, ti je i ri 52 vjeç, 55 kam ardhur unë.

Greqia për ne është një atdhe i dytë...

Këtu çdo gjë që ta shikosh arrin ta prekësh kurse në Shqipëri e shikon dhe se prek dot.

Mosmirënjohja është gjëja më e keqe e njeriut.

Këtu kam mësuar një gjë: Njeriu kur lind tre gjëra duhet t'i mësojë: Më fal! Faleminderit!Të lutem! Këtë nuk e themi ne dhe ky është zhvillimi që na len mbrapa. Kjo është fatkeqësi për ne se Fadil Hasa ka thënë se populli shqiptar është 100 vjet prapa dhe 50 vjet anash. Ne akoma nuk kemi dalë në rrugë kryesore. Ne nuk na le mendjemadhësia. Sado talent e profesion të kesh po pate mendjemadhësinë i ke fshirë të gjitha.

Do plakesh në Greqi apo do të kthehesh?

Atë nuk e di. E di Zoti dhe ai është për të gjithë.

Ke Ura e Setës thua se ke 20 vite që s'ke qenë.

Vërtet, 20 vjet fiks që nuk kam qenë. Më vdiq xhaxhai dhe mora taksi nga këtu në Tiranë, nga Tirana në Arras. E varrosëm dhe u ktheva. Qëndrova njëzet minuta. Para një viti më vdiq xhaxhai tjetër. Tre makina kam e mora taksi direkt që mos vonohem...

Është turp dhe mund të thotë çdo njeri çfarë të dojë.

Te shtëpitë e Krrashe kë ke?

Atje kam shtëpinë time dy kate-she me gurë e me të gjitha.

A ke mësuar ndonjë gjë gjatë këtyre viteve nga greku?

Kam mësuar jashtëzakonisht.

Jo, jo. E kam fjalën se në vitin 1960 u boshatis Athina, ikën grekët jashtë. Erdhën në Athinë njerëz nga fshatrat, nuk i shkatërruan shtëpitë, i ngritën në kate, i bënë vila dhe të shtunave e të dielave udhëtojnë edhe qindra kilometra për të pushuar e kujtuar të kaluarën ...

Do arrihet edhe tek ne.

Ëndrra ime është...

Trimi i mirë me shokë shumë, por shok ke vetëm vetveten.

Njeriu nuk bëhet i pasur me pasuri por me mentalitet, me mend.

ABDURAHIM ASHIKU

Athinë, 1 qershor 2020

NJOFTIME

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

JU KUJTOJMË SE SHKRIMET DUHET TË JENË TË KORRIGJUARA/ REDAKTUARA.

Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**

ose në faqen tonë

www.rrugaearberit.com

aktualitet

Nr.2 i Forcave tona të Armatosura, si drejtuese e këtij projekti humanitar, synon që ndihmat humanitare të ndahen në gjithë vendin

Nga Veriu në Jug, **Gjenerale Manushaqe Shehu** e angazhuar në shpërndarjen e ndihmave humanitare

Në datat 11-12 maj ajo ka marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave në prefekturën e Dibrës, ku pushtetit lokal iu dorëzuan 1200 pako ushqimore për familjet në nevojë. Strukturat e Prefekturës dhe të bashkisë Dibër kanë shprehur mirënjohjen për këtë kontribut në ndihmë të familjeve dibrane në nevojë.

Nga **MUHARREM GJOKA**



Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, pothuajse gjatë gjithë muajit maj 2020 ishte e angazhuar në shpërndarjen e ndihmave humanitare për fatkeqësinë natyrore të shkaktuar nga COVID-19.

Në këtë aksion humanitar ajo është gjendur mes shtesave në nevojë, fillimisht në vendlindjen e saj, Dibër dhe më pas në Kukës, Dibër, Krujë, Durrës, Cërrik, Gramsh, Shijak, Pogradec, Pustec etj.

Kështu gjeneralja e vetme grua, e lindur dhe e rritur në Sohodoll e Peshkopi dhe që ndër vite kreu shkëlqyer te gjitha nivelet e shkollimit deri dhe atë akademik, është bërë e njohur në komunitetet e këtyre bashkive, si njeriu me shpirt human e fisnik, si njeriu i punëve të dobishme, ndoshta jo të mëdha, por që të jenë të mirëpritura nga njerëzit në nevojë. Pa zë e figure, pa bujë e kamera nga pas, po ndihmon pikërisht ata që po vuajnë pasojat e izolimi total prej situatës së rëndë nga koronavirusi, tashmë për afro tre muaj. Pikërisht këtu konsiston dhe angazhimi i të vetmes grua gjenerale shqiptare për të ndikuar që këto familje të çlirohen sadopak nga ankthi dhe pasiguria që është prezente në shtëpitë e të gjithëve. E kështu po bëhet gjithmonë e më e besueshme për shtresat në nevojë, duke ju gjendur pranë në çdo moment të vështirë.

E ndërgjegjshme se kjo situatë më tepër ka rënduar shtresat në nevojë, është përqendruar tek evidentimi dhe ndihma për këta të fundit të cilët janë duke vuajtur së tepërmi pasojat nga COVID-19. Ndaj, edhe vëmendja për këtë shtresë duhet të jetë shumë e madhe. Sëbashku me anëtarë të tjerë të shtabeve të emergjencave në këto bashki, gjenerale Shehu vazhdon misionin e saj për të qenë pranë më nevojtarëve, duke shkuar shtëpi më shtëpi dhe shpërndarë ndihma ushqimore. Kësisoj ajo po ndihmon persona në nevojë dhe të moshuar në këtë situatë të vështirë që po kalon vendi si pasojë e koronavirusit. Në një koordinim perfekt me strukturat vendore, por edhe me struktura tjera vullnetare, nr.2 i Forcave tona të Armatosura, si drejtuese e këtij projekti humanitar, synon që ndihmat humanitare të ndahen në gjithë vendin.

Në datat 11-12 maj ajo ka marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave në prefekturën e Dibrës, ku pushtetit lokal iu dorëzuan 1200 pako ushqimore për familjet në nevojë. Strukturat e Prefekturës dhe të bashkisë Dibër kanë shprehur mirënjohjen për këtë kontribut në ndihmë të familjeve dibrane në nevojë.

Më 13 maj ishte në Kukës ku u shpërndanë 603 pako ushqimore për familjet në nevojë.

Në datën 14 maj ka marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave në Gramsh, ku pushtetit lokal iu dorëzuan 603 pako dhe 5 iu shpërndanë direkt familjeve në nevojë, si dhe në Bashkinë e Belshit 44 pako dhe në Bashkinë e Cërrikut 33 pako.

Në datën 18 maj ishte fillimisht në Bashkinë e Krujës ku pushtetit lokal iu dorëzuan 79 pako në Fushë Krujë dhe 5 familjeve më në nevojë.

Gjithashtu po në datën 18 maj ishte në Bashkinë e Durrësit, ku dorëzoi 43 pako ndihmë ushqimore për familjet në nevojë dhe 5 direkt familjeve më në nevojë. 14 pako u dorëzuan në Bashkinë e Shijakut.

Më 19 Maj gjenerale Shehu ishte në shpërndarjen e ndihmave në Fushë Arrëz 68 pako, në Pukë 40 pako dhe në Vaun e Dejës 109 pako.

Sot gjenerale Shehu do të marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave në Bashkinë e Pogradecit 129 pako dhe Pustec 2 pako.


Gjenerale Shehu në takimin me këto familje, të cilat ishin dëmtuar edhe nga tërmeti dhe ishin në çadra, u shprehu atyre mbështetjen dhe i garantoi se nuk do jenë asnjëherë vetëm.


Në të gjitha bashkitë pakot u dorëzuan nga përfaqësuesit e Komandës Mbështetëse.


Qoftë edhe këto raste flasin për shpirtin e saj human e fisnik, duke bërë kështu diferencën për bujarinë e njerzillëkun, si tiparet më të bukura të karakterit të njeriut. Ajo është shembulli më i mirë i zbatimit të përvojës njerëzore që ka çimentuar dhe dhënë prova se punët e vogla janë më me vlerë se punët e mëdha.


Botime të reja

mbbotime@gmail.com









BOTIMET M&B

mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283

*Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia; rrjetit të librarive "*ADRION*"; librari "*Art's*" të Stacioni i Trenit në Tiranë;* FletaXXI *në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit ose online në* www.bukinist.al

profil

Gjithnjë në koherencë me realitetin, Dine Doda do të evidentohej si njeriu që: "I zinte vend fjala dhe i kishte duk puna".

Kur Dritëro Agolli vinte në parkun "Dine Doda"

Pas vizitës së Dritëro Agollit, parkut "Dine Doda" iu shtuan dukshëm vizitorët. Për tetë muajt e vitit, nga fillim prilli e gjer në fund të tetorit, vinin këtu për të drekuar e për të shijuar natyrën magjepsëse të Muhurrit dhe për të marrë rreze në plazhin e Drinit, qytetarë të shumtë nga Peshkopia.

Nga **Halil RAMA**

Patriarku i letrave shqipe, Dritëro Agolli, nxitjen për të shkruar romanin "Njeriu me top" (Tiranë 1975) e ka marrë nga një bisedë me miq të shquar dibranë, në ish - Parkun "Dine Doda", Muhurr.

Në një nga vizitat e tij të verës së nxehtë të vitit 1974, i madhi Dritëro, atëherë Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, erdhi në Dibër, i ftuar nga miku i tij Hazis Ndreu. Për t'ia bërë pritjen sa më të ngrohtë e miqësore ikonës së letërsisë sonë, Hazisi kishte ftuar në pritjen në Hotel "Korabi" (Turizmin e Peshkopisë) edhe burrin e urtë Dine Doda nga Muhurri. Ishte një darkë vërtet e paharruar (siç ma ka rrëfyer, ndjesë pastë daja Hazis) dhe Dritëroi ishte mahnitur me alegorinë therëse dibrane që përdorte gjatë muhabetit, i mençuri dhe i urti Dine Doda.

Dhe nisi ta thumbojë Hazisi Dinen: "Muhurri ka dy Dine me emër, or Ditëro: Dine Hoxhën që ka xhaminë në Rrugën e Kavajës në Tiranë dhe këtë Dine Dodën që kemi në këtë sofër. E, ky i dyti, në gjurmët e të parit, nuk ka ndërtuar xhami se nuk ia mban, por ama emër ka lënë. Ka ndërtuar një park të bukur në një luginë që të mahnit me bukurinë e hijeshinë e saj, vetëm një kilometër sipër, aty ku bashkohen Murra me Drinin. Dhe jo më kot, ata që e frekuentojnë bar-lulishten e këtij vendi, ia kanë ngjit 'Parku Dine Doda".

Aty për aty, Dritëroi ishte shprehur: "E po, u tha u bë….Nesër drekojmë tek ky parku 'Dine Doda". Unë kam qenë atëherë vetëm 14 vjeç, në klasë të shtatë, por e mbaj mend harenë e asaj dreke të paharruar. Meqë kisha interpretuar në skeçe në shfaqjet e shtëpisë së kulturës me Dinen, më mori që të recitoja në ndonjë moment pauze vargje nga poema e famshme "Nënë Shqipëri" e Dritëroit.

Në një tavolinë, veçmas të tjerave, pranë një shelgu ku dëgjohej gurgullima e ujit kaltërosh të Murrës, qenë ulur Dritëro Agolli si mysafir e bashkë me të burrat e mexhelisit dibran Hazis Ndreu, Xhemal Berisha e Dine Doda.

Ndërsa ia kishin shtruar për shtatë palë qejfe me raki "penestia", mish të pjekur qengji e sallatë me zarzavate bio të Muhurrit, Dinja tregon historinë e plakut Mera të Luznisë, i cili në kohën e luftës paska strehuar një italian të zënë rob pas kapitullimit të Italisë, si dhe për topin që kishte fshehur në stanin e bagëtive. Kaq iu desh Dritëroit që të fiksonte fabulën e romanit të tij "Njeriu me top", që pas disa vitesh do të bëhej edhe subjekt i një prej filmave më të arrirë e më të shikuar të Kinostudios "Shqipëria e Re", që i ka rezistuar kohës, pikërisht për ngjarjet interesante që trajton e përcjell. E kishte shoqëruar Dinja të nesërmen shkrimtarin e madh edhe në Luzni, nga ku do të mblidhnin fakte për romanin e saposkicuar.

Pas vizitës së Dritëro Agollit, parkut "Dine Doda" iu shtuan dukshëm vizitorët. Për tetë muajt e vitit, nga fillim prilli e gjer në fund të tetorit, vinin këtu për të drekuar e për të shijuar natyrën magjepsëse të Muhurrit dhe për të marrë rreze në plazhin e Drinit, qytetarë të shumtë nga Peshkopia.

Vizionar, largpamës e bashkëkohor siç ishte Dine Doda, përveç shërbimit me korrektesë ndaj popullit nga njësitë tregtare të zonës që drejtonte si përgjegjës i Degës së Tregtisë Muhurr (që mbulonte edhe zonat e Luznisë e Katër Grykët), me intuitë e fantazi të rrallë, kishte projektuar edhe ndërtimin e një bar lulishteje, pikërisht përtej urës pasarelë, përballë zyrës së tij, në luginën me plepat e mbjellë nga nxënësit e shkollës para shumë viteve, por që ishin rritur e bërë gjigandë dhe krijonin një luginë me freski e gjelbërim mahnitës. Vinin këtu edhe funksionarë të lartë të rrethit e të dërguar nga Tirana dhe largoheshin me mbresa të pashlyera. Gumëzhinte parku nga zërat



Dine Doda.

gazmorë të nxënësve, tek kalonin urën pasarelë për të blerë nga një akullore apo aranxhatë të freskët, që Evzi Lala ua servirte me delikatesë.

Erdhi sërish këtu, pas 15 vitesh i madhi Dritëro, një ditë gushti të vitit 1989, i shoqëruar nga ish Sekretari i parë Xhelil Gjoni. Dhe u takua sërish me Dine Dodën, Hazis Ndreun e Xhemal Berishën, por edhe me funksionarët e Muhurrit të asaj kohe, si Sami Balla e Besnik Këbej.

Një drekë gazmore, me gatimet tradicionale të kuzhinierëve me përvojë Xhavit Balla e Haxhi Xhani, por dhe shërbimi tejet i kulturuar i banakierëve Evzi Lala e Halit Xhani dhe i kamarierëve si flutura, Drita Kurti e Natasha Berisha, do ta linin pa mend Dritëroin. Në tavolinën ku shkëlqenin shishet me raki "Penestia"e "Shliva", patriarku i letrave shqipe do të shfaqte admirimin e tij, jo vetëm për peisazhin e gjelbëruar anash Murrës kaltëroshe, por edhe për bagazhin jetësor e zgjurasinë natyrale, si dhe për mprehtësinë e gjykimit të Dine Dodës për çështje të ditës. Ishte koha kur nomenklatura e sistemit monist, në rrënim e sipër po zbatonte të famshim projekt të tufëzave e arzave dhe kur Dritëroi pyeti të pranishmit se a ishin të kënaqur fshatarët me këtë projekt, aty për aty Dine Doda iu përgjigj me alegorinë therëse dibrane: "Po o Dritëro, me pulat mbyllur në kotec e të gjitha lopët në një stallë, na kanë shpëtuar gratë që po bëjnë sehir!". Ndërsa këtyre zyrtarëve tanë u shkon për shtat "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo". Dhe Dritëroi që e kuptoi gjendjen se ku ishte katandisur fshatari i mjerë, nuk nguroi t'ía bëjë atë prezent kupolës partiake e shtetërore të asaj kohe.

Qe një nga ato momente, kur Dine Doda shfaqi jo vetëm zgjuarsinë e talentin e tij në rrëfimin e ngjarjeve e situatave, por edhe formimin e tij kulturor nëpërmjet leximit të librave të shumtë (nuk kishte lënë asnjë libër të Dritëro Agollit pa lexuar), emri i tij u bë legjendë dhe i referohen edhe sot e kësaj dite. U bënë 14 vjet që ka ikur për në botën e përtejme, por në bisedat mes miqsh, shpesh thuhet "Siç ka thënë Dine Doda…"!



Dine Doda me ekipin e Deges se Tregtise Muhurr, shtator 1987

Dine Doda e ka shfaqur talentin, zgjuarsinë dhe fisnikërinë e tij edhe në jetën shoqërore. Ai ishte i pranishëm dhe i ftuar kudo në raste gëzimesh në fshat e në zonë, sepse i kishte lezet muhabeti, kënga dhe vallja. Ai dinte të përdorte me vend e me kulturë alegorinë dibrane.

PO KUSH ISHTE NË TË VËRTETË DINE ASLLAN DODA?

Njeriu legjendë i Muhurrit e gjithë Dibrës kishte lindur në Vajmdhej më 1933 dhe ishte rritur jetim. Kur ishte vetëm 11 vjeç do të shërbente si korrier i komandës partizane të vendit, pa përfillur rreziqet e vështirësitë e luftës së ashpër kundër pushtuesit nazifashist. Nga kontakti me organizatorët e asaj lufte, do të mësonte e do të burrërohej para kohe. Veçanërisht tregonte interes të jashtëzakonshëm për bisedat që bëheshin në odat e burrave, nga ku mësonte për ngjarje e bëma të trimave muhurrakë në luftërat me krajlët e Serbisë, të cilat më vonë i përjetësoi në këngët e tij, si rapsod popullor.

Menjëherë pas çlirimit, merr pjesë në aksionin e rinisë për ndërtimin e të parës hekurudhë në Shqipëri, Durrës-Peqin (1947), ku u miqësua me vullnetarë nga e gjithë Shqipëria. Ndërkohë, i etur për arsimin e dije, si edhe dhjetra të rinj të tjerë, krahas punës vullnetare, kryen kursin kundër analfabetizmit për të mësuar shkrim e këndim. Tashmë më i rritur e i pjekur, por edhe nga kontakti me intelektualë të kohës, e kishte kuptuar se pa u arsimuar nuk mund të çante në jetë. Ndaj dhe kur nevojat për kuadro në vitet e para pas çlirimit ishin të mëdha, zgjodhi për të ndjekur studimet në shkollën dy vjeçare tregtare ekonomike në Durrës, të cilën e mbaroi me rezultate të shkëlqyera. I përgatitur për të shërbyer në një nga sektorët më jetikë të asaj kohe, siç ishte sektori i tregtisë, e nis punën në bazën e këtij sektori si shitës fshati. Përballoi me dinjitet vështirësitë e kohës kur popullit i mungonin artikujt më të domosdoshëm ushqimorë e industrial dhe kur përveç tregtimit kryente njëherësh edhe detyrën e grumbulluesit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, si misër, grurë, fasule, vezë, mish etj, nga fshatarët. Ndonëse punoi për një kohë të shkurtër si shitës-grumbulles, kjo kohë i shërbeu si përvojë në funksionet e mëvonshme organizuese e drejtuese për zgjerimin e rrjetit të tregtisë në zonën e Dibrës. Me përgjegjësi maksimale, kompetecë e përkushtim qytetar, Dine Doda ia ka dalë të drejtojë e t'i ngjitë në pararojë degët e tregtisë Fushë-Alie, Maqellarë, Muhurr e Peshkopi (dega fshat). Falë aftësive organizative e komunikuese të tij, këto degë qenë shembull për realizimin e treguesve ekonomikë e financiarë. Ndaj dhe në vlerësim të punës së tij organizuese e drejtuese është dekoruar me Urdhrin "Për shërbim të mirë ndaj popullit", me Dekret Nr.7044, datë26.6.1986.

TALENTI, ZGJUARSIA DHE FISNIKËRIA E DINE DODËS

Talentin, zgjuarsinë dhe fisnikërinë e tij, Dine Doda i ka shfaqur edhe në jetën shoqërore. Në raste dasmash e gëzimesh të tjera familjare, por edhe në raste fatkeqësish të fisit e të miqve të shumtë, jo vetëm në Muhurr por në gjithë Dibrën, ku ai do të merrte rolin e drejtuesit e të organizuesit, sipas zakoneve të vendit. Gjithnjë në koherencë me realitetin e atyre ngjarjeve do të evidentohej si njeriu që i zinte vend fjala dhe i kishte dukë puna.

Dhe jo vetëm kaq. Dine Doda, ishte mjeshtër i interpretimit të rapsodive popullore e i kërcimit të valleve tradicionale në festivalet zonale, po i tillë do të shfaqej edhe në dasma e fejesa, duke ua shtuar atyre bukurinë e gjallërinë.

Siç shkruan Sami Doda në librin e tij: "Në kërkim të jetës" (faqe 90-91), Dine Doda ishte i pranishëm dhe i ftuar kudo në raste gëzimesh në fshat e në zonë, sepse i kishte lezet muhabeti, kënga dhe vallja. Ai dinte të përdorte me vend e me kulturë alegorinë dibrane. Pasi i kënaqte të pranishmit me shaka e muhabet, kapte çiftelinë dhe këndonte si një rapsod i vërtetë këngë tradicionale të folklorit të zonës. Pastaj linte çiftelinë e hynte në valle duke ia shtuar bukurinë gëzimit familjar…".

Këto veti të karakterit të tij, i trashëguan dhe i demonstrojnë mjeshtërisht edhe djemtë, jo vetëm i madhi Fadili (që fatkeqësisht u nda para kohe nga jeta) si mjeshtër i fjalës e punës e si rapsod, por edhe Petriti në fushën e biznesit që e ka ngritur me punë e përkushtim; Iljazi me djemtë me studion e tij audiovizive e si telekronist këtu në Tiranë, si dhe djemtë tjerë, ushtarakët e talentuar Hamdiu e Shpëtimi, Atliu si dhe më i vogli Myslimi.

DINE DODË, S'TË HARRON DIBRA!

Djemtë e Dine Dodës, krenarë për babain e tyre që e deshi dhe e respektonte gjithë Dibra, për fjalën e urtë e të mençur në kuvende, oda, dasma e mexhelise dhe për zërin e tij brilant kur këndonte në festivale e dasma, do ta përjetësonin atë edhe nëpërmjet një kënge. Veçanërisht Iljazi, që me djemtë e tij: Izmirin, Ilirjanin e Iglin ka krijuar edhe një studio të mirëfilltë diskografike – mjeshtër të kameras e montazhit por edhe me talent të rrallë në këtë fushë e me shpirt krijues, e kërkonin këngën sa më të arrirë artistikisht. Kontaktuan disa autorë të njohur dhe pas konsultimesh nisëm bashkëpunimin me Dr.Hajri Mandrin, i cili hulumtoi shumë për jetën dhe veprën e Dines, por frymëzimin (siç pohon ai vetë) e gjeti tek reportazhi i mësipërm me titullin "Dritëro Agolli në Parkun Dine Doda".

E kështu, poeti i këngës H.Mandri shkroi këngën kushtuar Dine Asllan Dodës, vargjet e së cilës përcjellin jehonën e valëve të Drinit të Zi që ishin frymëzim për zëbilbilin Dine Doda, kur ia thoshte bukur këngës në kullat me shumë poda.

Në vargjet e kësaj kënge ndjehet gurgullima e burimeve, një simfoni tingujsh të përcjella nëpërmjet zërit brilant të artistit popullor Dine Doda, i cili sa qe gjallë pati mahnitur spektatorët në festivalet folklorike dhe dasmorët në qindra e qindra dasma.

1.
Bashk' me val't e Drinit t'Zi
Vjen një këngë me çifteli;
Jehon kulla me shumë poda
Zëbilbili - Dine Doda…
Krushk i parë ndër dasmorë
Dine Doda - mal me bore;
Kur kërcente dhe këndonte
Valle burrash zbukuronte…

2.
Ku bashkohet Drini e Murra
Kuvendon Dinja me burra,
Vetë lezeti i kësaj ane,
Fjalë - alegori dibrane;
Fjalës moçme, fjalës vjetër,
Dinja i jepte kuptim tjetër;
Ku shkëlqen oratoria
Dinja ishte vetë mirësia..

REFRENI:
Dine Doda n'ligjërime
Për vatan e për këto troje;
Nepër dasma e gëzime
Fjala e tij qe mjaltë e hoje;
Dine Doda, Dine Doda
Gryka e Drinit ç'po jehon!
Je n'at' botë, na vjen ndër oda
Me ne flet, me ne këndon!

3.
Bukuritë që i fal natyra
Dine Doda i bën më t'mira;
N'at luginë me park-gjelbrime,
Vijnë murrakë n'dasma e gëzime;
Tregimtar-gojëtar i rrallë
Për vatan fliste me mall;
Kur shërbente në tregëti
Sjellja e tij qe fisnikëri…

4.
N"krye t'vendit me qeleshe
Në konak - dielli me rreze;
Historia shkruan n'libra
Dine Dodë s'të harron Dibra;
Ka mbetë shprehja nëpër oda:
"Ka thënë dikur Dine Doda!..".
Jeta e tij plot mençuri
Trashëgohet n'djemtë e tij…

Alegoria hapi rrugën pikërisht në truallin ku ajo ndodhet me shumicë, në Dibër, dhe promotori që e vuri në lëvizje gjithë këtë punë, ishte Haziz Ndreu.

Hazis Ndreu, mjeshtri i alegorisë

Nga **XHAFER MARTINI**

(vijon nga numri i kaluar)

Hazizi ishte nga ata që drekohej në shkollën bujqësore bashkë me personalitetet e tjera politike e shoqërore të asaj kohe. Mbasi kishte ngrënë drekë, vjen javash – javash, siç e do puna kur ke ngrënë mirë dhe do të tretësh ushqimin. Manen e shikon në shëtitoren kryesore në drejtim me shtëpinë e kulturës. I flet më zë të lartë:

- Gëzuar festën, or Mane.

Manja ia kthen:

- Po, o Haziza, po, o Haziza. Ishte ditë Bajrami dhe thkehet burri nga xhamaja ku kishte shkue me falë Bajramin. Xhen gruen ke kroj në rrugjë ene kjo grueja i thotë: "O burrë, të merremi grajkë se asht ditë Bajrami". Po burri i thotë:

- Hiqna mrena, Hane, oj grue!

se nuk bahet bjaramllajk në krue".

Hazizi, natyrisht, që e kapi domethënien e kësaj alegorie që për lexuesin e thjeshtë duhet zbërthyer kështu: Ti Haziz, dhe shokët e tu e bëtë festën siç duhet e jo unë që jam këtu në rrugë dhe nuk kam as një pikë ujë me pi.

Alegoria ishte e Manes, por merita ishte e Hazizit që ia pruri në shteg mundësinë e përdorimit të saj. Alegoria funksionon mirë kur në odë të burrave ose kudo tjetër janë dy bartës të talentuar që nxisin njëri–tjetrin, pikërisht në atë moment kur ndërhyrja me alegori është bërë e nevojshme, mbasi krijohen rrethanat. Alegoria është shumë nazelie dhe tekanjoze, atë duhet ta lutësh shumë, ta ndjellësh dhe ta përkëdhelësh që të të vijë. Nuk ka pikë kuptimi të thuash në një mexhelis: tani po tregojmë alegori. Hazizi, si askush tjetër, dinte t'ia hapte udhën alegorisë. Roli i tij ishte nxitës, kur donte të "vriste dikë me pushkën e Imer Agës", siç ndodhi më sipër. Ai vetë nuk mund ta kritikonte mënyrën se si festohej dita e çlirimit, Manja po.

Një rast tjetër nga praktika jetësore.

Në Peshkopi në kohë të dimrit të madh të vitit 1985 kishte ardhur një partiak i lartë për të ndihmuar rrethin në përballimin situatës së jashtëzakonshme. Binte shumë borë dhe rrugët ishin të zëna. Vetëm në shëtitoren kryesore të qytetit traktorët a buldozerët hapën një si punë xhadeje dhe borën e hidhnin në të dyja anët e kësaj traseje. Bora ngrinte natën dhe dukej sikur ajo ishte mur prej betoni. I deleguari i qendrës bashkë me sekretarin e parë dhe dy-tre pushtetarë të lartë vendorë, me të cilët ishte edhe Hazizi, po shëtisnin në trasenë e hapur.

- Si do hiqet kjo borë, or Haziz ?- e pyeti i ardhuri nga qendra.

- Kishte qenë një burrë shumë i shkurtë, or shoku X. Ky kishte pas një grue të gjatë dhe të shëndetshme. Dikush i kishte thanë: "Mor pash Zotin, mos ma merr për keq, se të pyes pa hile, si ja ban ti me e rrzue gjithë këtë mal të madh?"

Burri i ishte përgjigjur:

"Këtë veç kur e rrëzon e vetja, se për mue ngelet në kambë. Kur i vjen dekiku, bie si pula kur i pret kryet".

Qeshën me ha ha ha, se kishte edhe prej atyre që nuk e kapnin alegorinë, por banin sikur e kuptonin. Hazizi me këto alegori i tha pushtetarit se kjo dëborë vetëm kur të shkrihej vetë, nga pranvera.

Një tjetër rast. Kishte disa nga pushtetarët e rrethit që e donin në mënyrë të veçantë Hazizin dhe merrnin me vete kur shkonin me shërbim në ndonjë zonë. Njëri prej tyre ishte Gjon Deda, prej Lure, por që në komitetin ekzekutiv të rrethit Dibër bënte detyrën e shefit të organizimit.

Në një mëngjes të pranverës së hershme e merr Hazizin në veturë dhe të dy nisen për në Fushë Alie. Kur shkojnë tek ai sheshi i bleruar, sa një fushë futbolli, Hazizi shikon se nga ana e jugut, pështetur për murit të dyqanit të tregtisë, ngrohej në diell Mane Kacani. Ai i tha Gjonit që ta çonte veturën rrotull e rrotull dhe t'ia ndalte Manes mu te këmbët dhe ta ngacmonte. Gjoni, si luras, ishte gati për kso punësh dhe bëri si i tha Hazizi. Hapi derën e makinës dhe, pa dalë prej saj, iu drejtua Manes dhe i tha:

- O Mane, a unë a ti?

- Unë, or Xhon, unë, - tha Manja që e njihte Gjonin.

- Po pse ti, o Mane?! Ja, unë vij me veturë, kurse ti ke dalë e mezi ke gjetur një rreze dielli për t'u ngrohur.



HAZIZ NDREU, KRIJIMTARIA, PERSONALITETI
Xhafer Martini
Botimet M&B, 2019
ISBN 978-9928-307-09-5
Faqe 128 / Çmimi: 800 lekë

- Të kanë pru, or Xhon apo ke ardhë me tanden?- e pyeti Manja.

- Jo, më kanë pru, - tha Gjoni. – Jam me shërbim.

- Kurse unë, or Xhon, kam ardhë vetë. Rri sa të due e shkoj kur të due. Jam si ai zogu që këndon majë plepit.

Meselja, siç shikohet, trajtoi temën e lirisë. Në atë sistem nuk kishte njeri të lirë.

Këto mesele e bënin Hazizin të këndshëm dhe të preferuar. Hazizi rrallë lexonte libra letrarë. Por librat për kulturën popullore dhe për historinë i studionte. Hazizi punonte pa ngutje, me durim dhe vullnet të madh. Kuptonte hollë dhe thellë. Për çdo libër të tijin që kam punuar me të, ishte plotësisht dakord me heqjet, me krasitjet që i bëja, nganjëherë shumë të mëdha.

*
* *

Me Hazizin kam një përvojë shumë të mirë kur unë dhe ai punuam për përgatitjen e librit "Tregime alegorike dibrane" (Tiranë, 1983), botuar nga Akademia e Shkencave (Instituti i Kulturës Popullore), në kohën kur ky institut drejtohej nga Prof. Alfred Uçi. Libri pati shumë sukses dhe e rriti edhe më tej emrin e Hazizit, në një farë mase edhe timin, por kjo nuk kishte shumë rëndësi. Suksesi më i madh i Hazizit, i imi, i mbarë kulturës dibrane dhe shqiptare në përgjithësi, qëndronte në faktin se ja, më në fund, alegoria po pranohej dhe se ajo po botohej nga vetë Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Ky botim, ashtu si ndodhi në të vërtetë, do të hapte rrugë të reja për botime të tjera shumë më të rëndësishme për alegorinë. Por, për të mbërritur deri këtu është bërë një rrugë e gjatë dhe shumë e vështirë. Vetëm ata që kanë udhëtuar në zhegun e vapës ose në dëborë dhe furtunë, janë lodhur aq shumë sa nuk e kanë dashur më veten, mund ta përfytyrojnë rrugën e mundimshme drejt alegorisë. Kemi bërë të gjithë, kemi ecur të gjithë, por në krye të karvanit ishte ai, Haziz Ndreu, "me shami të grisur lidhur në kokë", siç thotë D. Agolli për Pelegrinin e tij. Unë tregova me sinqeritet se si e hapi rrugën alegoria pikërisht në truallin ku ajo ndodhet me shumicë, në Dibër, dhe se promotori që e vuri në lëvizje gjithë këtë punë, ishte Haziz Ndreu. Por nuk ishte puna vetëm te Dibra. Në përgjithësi ekzistonte një klimë mospranimi për alegorinë. Ajo shikohej gati si Kanuni dhe, në të vërtetë ka shumë lidhje me të, dhe të dyja bashkë, Kanuni dhe Alegoria- shikoheshin si mbeturina të së kaluarës, pra mjaft të rrezikshme për kulturën socialiste. Jo vetëm në atë kohë kur u botua libri i Hazizit, por edhe shumë vite më vonë, te studiuesit, madje tek akademikët, ekzistonte ky mentalitet. Kanuni i Lekë Dukagjinit- kjo vepër madhështore e kulturës sonë - është botuar me shumë vonesë, në kuadrin e botimit të korpusit të Trashëgimisë sonë Kulturore. Kjo ndodhi në vitin 1989, një vit para se të binte diktatura. Se çfarë koncepti kishte ajo klasë sunduese për Kanunin dhe për Alegorinë, kuptohet nga parathënia për botimin e "E drejta zakonore" ku ka fraza si kjo: "*Përmbysja e madhe në sistemin e marrëdhënieve shoqërore që u arrit pas çlirimit të vendit, krijoi një raport të ri midis realitetit dhe mbeturinave të së drejtës zakonore, të cilat vihen përballë këtij realiteti si faktor thellësisht negativ, që duhej asgjësuar për të spastruar rrugën e përparimit*"(E drejta Zakonore Shqiptare, vëll 1, Tiranë 1989, f. 10)

Në atë kohë unë isha mësues në Peshkopi. Alfred Uçi më kishte pasur student, ma dinte adresën se unë isha bashkëpunëtor i revistës "Kultura Popullore", ndër më elitaret e asaj kohe. Më thirri në Tiranë dhe më tha: "Haziz Ndreu ka sjellë një vëllim me alegori, jo vetëm këtu te ne, por edhe në institucione të tjera, si në Institutin e Historisë, në Institutin e Gjuhës dhe të Letërsisë, etj., por askush nuk e merr përsipër botimin e tij, të paktën në këtë formë që paraqitet. Ti si mendon? A mund të bëhet i botueshëm? Dhe, nëse po, në çfarë forme?" Hazizi me anë të njohjeve deri lart bënte presion për botimin e librit të tij. Këta botues nuk kishin të bënin me një autor dosido, qoftë edhe me një talent të spikatur, por me një person që kishte miq në qeveri e kudo. Mbase pa këtë presion nuk do të ishte kujtuar as Alfred Uçi për dorëshkrimin e Hazizit. Ndoshta ai, si estet, pavarësisht se estet marksist, kishte koncepte më të moderuara sesa të tjerët. Sidoqoftë, ai më thirri për këtë qëllim dhe u soll me shumë dashamirësi me mua. Unë kisha njohuri për librin e Hazizit, se e kisha lexuar dorëshkrimin. Hazizi, siç e thamë edhe më lart, nuk kishte bazë për të ndërmarrë studime tërësore. Edhe në këtë dorëshkrim, e kishte paraqitur alegorinë rrëmujshëm, sikur dy pleq kalonin nga oda në odë dhe tregonin alegori njëra mbas tjetrës. Tregimin e alegorisë e kishte kthyer si qëllim në vetvete, edhe pse burrat kurrë nuk janë mbledhur për të treguar alegori. Ajo ka hyrë në mënyrë të vetvetishme në bisedë, në pikën e vlimit të saj, kur krijohen rrethanat për t'u shprehur me alegori. Biseda mund të zhvillohej katër -pesë orë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pjesa alegorike mund të ishte shumë e vogël, por ishte kripa, lezeti, zgjuarsia, inteligjenca. Unë kisha përvojë në studimin e alegorisë. Kisha shumë vite që merresha me të dhe pothuaj ia kisha zbuluar të gjitha të fshehtat. Në revistën "Kultura Popullore", botova shkrimin e gjatë "Vështrim estetik rreth alegorisë dibrane". Shkrimi u prit shumë mirë. Ishte i pari studim për alegorinë që krijoi një opinion krejt ndryshe për këtë lloj arti. Profesori prandaj ma ngarkoi atë detyrë. Dhe unë I thashë: "Sonte po përgatisë pesë-gjashtë faqe libri si e mendoj unë alegorinë, jua jell nesër dhe ju gjykoni vetë pastaj". Dhe ashtu u bë. Faqet që përgatita u pëlqyen dhe mora miratimin për të përgatitur librin bashkë me Hazizin. Jemi mbyllur dy muaj në një zyrë të vogël të Shtëpisë së Kulturës Peshkopi për përgatitjen e librit. Punonin bashkë, diskutonim çdo fjalë. Unë dija të shtypja në makinë të shkrimit dhe kjo punë, natyrisht, më takonte mua. Ndarja e punëve, ishte, pra, mekanike. Si u bë libri, unë hartova edhe një parathënie për të. Unë e Hazizi nuk vepruam as me nxitim, as me sy të mbyllur. Vendosëm kriteret. Duhej që një alegori të botohej veçan në një faqe libri. Dhe për secilën prej tyre, lart, para se të fillonte alegoria, të jepeshin shumë shkurt disa shënime për rrethanat dhe kushtet që e mundësuan atë. Kështu, me shënime të shkurtra janë paraqitur edhe këngët legjendare dhe historike. Në këto këngë këto shënime quhen "argument". Është një traditë shkencore që nuk u zbatua për herë të parë nga unë dhe Hazizi. Mjafton të shikoni botimin shkencor "Eposi i Kreshnikëve dhe Legjendat", Plejad, 2005, Haki Stërmilli: "Fyelli i Dibrës", Tiranë 1944. Por, në kundërshtim me bindjen time dhe të Hazizit, ishim të detyruar të mbronim mendimin se një pjesë e mirë e alegorisë godiste "*regjimin reaksionar të Zogut kur populli vuante nga uria dhe shtypej nga klasat sunduese, nga bejlerët dhe agallarët, dhe përgjithësisht nga paria e vendit*". Alegoria e kishte të fortë tehun goditës. Nëse tehun e saj nuk do ta drejtonim në të kaluarën "*e hidhur të popullit tonë*", kundër kujt do ta drejtonim? Mbetej opsioni i diktaturës. Po a mund të bëhej kjo? Prandaj, me ndonjë shënim edhe do të godisnim Murat Kaloshin, Dine Hoxhën e ndonjë tjetër nga paria. Sot është kollaj t'u dalësh zot krerëve të parisë së Dibrës, por atëherë kjo nuk mund të bëhej. Megjithatë, Hazizi e unë i dhamë lexuesit një libër të mirë, me të cilin besoj do të jetë krenuar edhe inteligjenca shqiptare. Nëse e kemi fyer, i kërkojmë falje. Tani që gjithçka është përmbysur dhe është kthyer kokëposhtë, nuk është vështirë që këto shënime të bëhen deri në një fare mase "akuzuese" për Hazizin dhe për mua. Dikush mund të shqetësohet për modë se ia morëm në qafë parinë e Dibrës dhe se ajo paskësh qenë flori e shkuar floririt dhe se ne e shamë dhe e katranosëm, dikush mund të ketë bindjen se nuk duhet të ketë fare ashtu shënimesh. E vërteta është që paria e Dibrës edhe duhej kritikuar. Edhe më i larti dhe më zemërndrituri nga ajka e parisë së Dibrës, nënkryetari i Qeverisë së Vlorës, Vehbi Dibra, del e pret në kufi, ndonëse me zemër të vrerosur, pushtuesit jugosllav. Kishte të tjerë nga paria që i prinin ushtrisë jugosllave. "Batalionet serbe, të nesërmen e asaj dite…dua me thanë ditën e parë të qershorit 1915, po marshojshin drejt Peshkopisë t'udhëhequn prej Rahman Likës prej Luznie, Dine Hoxhës nga Muhuri, zv. Prefektit Hysein Bej Golja dhe komandantit të përgjithshëm Mustafa Bej Serdari, tepër të kënaqun e të gëzuem kishin dalë në Qenok me pritë ushtrinë mike Myfti Hafuz Raifi, sheh Hasani nga Tomini, Fetah Bjarami nga Peshkopia… për me përshëndet ushtrinë serbe dhe me i paraqitë sigurimet e besnikërisë së patundme. Në mes të kësaj turme të shitun dallohesh fytyra e habitun dhe e trishtueshme e Myftiut të Përgjithshëm z. Vehbiut". (Ismail Strazimiri: *"Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", Tiranë 2010, f. 75)* Në pasthëninen kushtuar librit të Strazimirit, akademiku Shaban Sinani, veç të tjerave, ka shkruar edhe këto radhë: "E dyta gjë që sjell në kulturën historike shqiptare libri i Ismail Strazimirit është dëshmia se parësia shqiptare, nëse mund të kuptojmë me këtë klasën qeverisëse me pushtet politik të mbështetur mbi tagrin etno-zakonor, që për fat të keq vijon edhe sot, përgjatë kohëve nuk dëshmohet gjithnjë njëlloj, ka anën e vet të errët e të ndritur: në një brez ka arritur të bëjë shumë për vendin dhe në një brez tjetër ka dështuar ose i ka bërë të zezën atdheut". (Shaban Sinani: *"Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", Tiranë 2010, f. 345)* Prandaj të mos kritikohemi shumë, aq më tepër të mos lëndohemi me fjalë të pamatura, për ndonjë "shënim ideologjik" unë dhe Haziz Ndreu. Pastaj unë e Hazizi kemi bërë pendesë të thellë në lidhje me parinë. Unë kam shkruar gjithë ato libra për të lartësuar vlerat e parisë: ("Elez Isufi", "Gjenerali me shajak", "Halil Alia", "Shumë gurë u hodhën përmbi mua", "Tempulli i Dashurisë", "Bujar Kaloshi" etj.) që I kalojnë një mijë faqe. Për Hazizin e kemi thënë që "*u bë me parinë e dikurshme*". Në një kohë kur të tjerët që vërtet janë shumë borxhlinj ndaj të kaluarës, nuk kanë shqiptuar asnjë fjalë ndjese, është mëkat të na ngarkosh mua dhe Hazizit faje *ideologjike*.

Por le të kthehemi tek ana me të vërtetë shkencore: ta zëmë që shënimet nuk kishin asgjë të kritikueshme. A duheshin vënë? Po, është e domosdoshme. Kjo është përgjigjja ime edhe sot e kësaj dite. Vendosja e tregimeve alegorike nga një për çdo faqe, pa asnjë shënim, nuk do të kishte fare kuptim. Alegoria është kontekstuale, ajo merr jetë dhe kuptim vetëm nga rrethanat. Nuk mund të lihet një alegori e vetmuar, se nuk ka pikë kuptimi. Pse një tregim alegorik nuk mund të qëndrojë më vete? Një tregim alegorik nuk qëndron dot më vete, sepse natyra e tij, funksioni i tij, nuk është pavarësia. Ai shkruhet me fjalë, por nuk është gjuhë, nuk kryen funksionin e gjuhës, mbasi me anë të fjalëve me të cilat ndërtohet ai, nuk shprehet ajo që mendohet.

(vijon në faqen 14)



SARINA 2002

Më shumë se një zgjidhje...

REGJISTRIMET KANË FILLUAR

Çmimi vetëm për mësimdhënie
për 1 vit akademik:

CIKLI 9-VJEÇAR: 100 000 lekë


CIKLI I MESËM: 120 000 lekë





Adresa:
Autostrada Tiranë - Durrës,
Km.1, Përballë Vodafonit.
Cel. **068 20 37 865**
shkollasarina@gmail.com
www.sarina2002.edu.al

SHKOLLA SARINA 2002



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**



cyan magenta yelloë black

kulturë







Katër këngë që frymëzojnë me dashuri dhe atdhedashuri

Periudha e pandemisë krijoji një atmosferë jo të zakonshme në shtëpitë tona, për të cilën pati shumë përpjekje për ta harruar apo për ta kaluar sa më lehtë. Njëra prej këtyre mënyrave ishte edhe krijimi i këngëve të reja, por edhe rikrijimi e riinterpretimi i këngëve të njohura, përmes mënyrave bashkëkohore të komunikimit, disa herë jo të realizuara artistikisht, por gjithmonë me një kënaqësi që buronte prej shpirtit të lirë e artistik të krijuesve.

Në fillim të majit ishin këngëtarët e muzikës popullore Hajredin Gjeta, Lirim Hoxha, Ylber Sopoti, Bledar Kaca, Dritan Jashari dhe Eduart Hoxha, që nën drejtimin e organistit Fatjon Laci risollën plot emocione këngën e Hajredin Pashës.

Disa ditë më pas, Arif Vladi - Mjeshtër i Madh, njëkohësisht edhe Drejtor i Qendrës Kulturore Peshkopi, realizoi në bashkëpunim me Artisten e Merituar Lirie Rasha - Mjeshtër i Madh dhe këngëtaret e njohura Vera Laçi e Flora Shabani, një këngë të re të titulluar "Dibra ime", një himn dashurie kushtuar vendlindjes.

Kënga u prezantua në emisionin "Ftesë në 5" në Top Channel, të autores e moderatores Bieta Sulo.

Teksti i këngës është shkruar nga Avni Ndreu, me muzikë të Xhelil Imerajt, i cili shoqërohet nga Isak Shehu në Trompë, Xhelil Imeraj në piano, Faik Vojka në saks, Agron Paci në kitarë bas, Shpend Markja në kitarë dhe Landi Tomçini në bateri. Orkestrimi i kësaj këngë u realizua nga kompozitori Edmond Zhulali - Mjeshtër i Madh. Video e kësaj këngë është realizuar nga Adnan Elezi dhe montazhi nga Eduart Muça.

Kompozitori Zhulali në një bashkëpunim tjetër bashkoi tre personalitete nga Dibra, regjisorin Bujar Kapexhiu, gazetarin sportiv Defrim Methasani dhe boksierin Ismail Keta me këngëtarët Altin Sulku, Muharem Borova, Lundrim Paçuku dhe Drita Jashari në një riinterpretim të këngës "Kjo është Dibra maja-maja", një hit të këngës dibrane, me tekst të Naim Plakut. Kënga pati edhe një jehonë mediatike, edhe për shkak që solli në këngë zërin e një regjisori e karikaturisti, gazetari sportiv dhe boksieri, duke surprizuar edhe shikuesit.

Arif Vladi solli edhe një këngë të re, jo vetëm si këngëtar, por edhe autor teksti, me muzikë të Mark Gjokës dhe orkestrim të Saimir Gjokës - Mjeshtër i Madh.

Kënga "Alo Doktor" pati një prezantim ndërkombëtar, pasi për herë të parë u transmetua ekskluzivisht në radion Zëri i Amerikës më 11 maj 2020.

Kur situata e pandemisë të ketë kaluar, këto këngë nuk do të kujtohen si himne për dashurinë dhe atdhedashurinë, por edhe si këngët që ushqyen njerëzit me dëshirën për te jetuar e fituar mbi Covid-19.

Dibra ime:
https://www.youtube.com/watch?v=o3E-JAimEwWU
Alo Doktor
https://www.zeriamerikes.com/a/5415055.html
Kënga e Hajredin Pashës:
https://www.youtube.com/watch?v=SmN-7AqRQfSE
Kjo është Dibra maja-maja:
https://www.youtube.com/watch?v=A-S37aEJZLTg

Fluturon shqipja mbi Korab

Nga **Halil RAMA**

Kompozitori Edmond Zhulali bashkon zërat dibranë: Kapexhiu, Methasani e Ismail Keta në këngën himn "Kjo është Dibra maja-maja" së bashku me zërat e këngëtarëve Altin Sulku, Muharem Borova dhe Lundrim Paçuku



Televizioni News 24 prezantoi para disa ditësh një kompozim në një mënyrë ndryshe të këngës "Fluturon Shqipja mbi Korab", të kompozitorit Edmond Zhulali – "Mjeshtër i Madh". Vetë Zhulali pohoi se ideja për risjelljen e këngës në këtë formë, ishte e gazetarit Dëfrim Methasani, ndërsa të gjithë personalitetet që këndojnë janë nga Dibra.

Ikona e gazetarisë sportive, D.Methasani që ka bashkuar zërin me interpretuesin virtuoz të kësaj kënge, Dritan Jashari në sa e sa promovime, si dhe kur ka moderuar takime edhe me praninë e Presidentit të Republikës, Z. Ilir Meta, pasi e kishte "bluar" për muaj të tërë në mendjen e tij, ia propozoi këtë variant Zhulalit, dhe ai nuk nguroi të hedhë në notat e pentagramit një rikompozim të tillë.

Bashkëpunimi qe i frytshëm. Kënga himn që ka ngritur peshë zemrat e artdashësve, jo vetëm në sallën e pallatit të Kongreseve në Tiranë, por edhe në dhjetëra takime të diasporës në hapësirën mbarëshqiptare në botë, tashmë përcillet fuqishëm edhe në yotube, e risjellë në një mënyrë ndryshe me artistë dhe personalitete të Dibrës, në këtë kohë pandemie.

Dhe ja, zërit të Defrimit, të demonstruar në sa e sa transmetime ndeshjesh, në dokumentarë e spektakle televizive, i bashkohet ai i një tjetër ikone të artit skenik.

Bujar Kapexhiu – "Nderi i Kombit", unik, i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë artdashësve e të shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të interpretimit e të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian, këtë radhë, në moshën 75 vjeçare, por me një vitalitet të rrallë, prezanton edhe zërin e tij melodioz në këtë këngë kushtrimi.

Pas tij, një tjetër zë i njohur, ai i kampionit të botës në kikboks, Ismail Keta, një rast i rrallë, ndoshta unikal në historinë e sportit. U rrit me lavdinë e kombit, tani kombi lartësohet me lavdinë e tij. Ai ka një histori interesante edukimi dhe rritjeje. Karshi fshatit Koçaj, vendlindja e tij, vendi i luftërave legjendare të Skënderbeut, do të ishte modeli mendor udhëheqës në koshiencën e kampionit të botës. Në galeritë e kromit, në shpat të malit do të shfaqej imazhi epiko-heroik i minatorëve, karvani i të cilëve ngjitej në kollonat e puseve për të zbritur në nëntokë me kilometra, në kërkim për të nxjerrë nga barku i malit kromin e florinjtë, duke të ngjarë si heronj legjendash. Ky mjedis që bashkon legjendën me të vërtetën do të farkëtojë tek Ismail Keta virtyte të mëdha. Gjithkush është ndjerë krenarë tek e ka parë atë t'i demonstrojë këto virtyte në arenën e ndeshjeve, por edhe në intervista brilante nëpër televizione të vendit e të botës dhe në takime me presidentë, kryeministra e kryebashkiakë të Mynihut, Tiranës, Dibrës e Bulqizës. Dhe ja, tani na shfaqet edhe si këngëtar, i thjeshtë gjer në madhështi, mbresëlënës për qindramijëra shikues e teleshikues, falë bukurisë fizike e shpirtërore por dhe aftësive komunikuese me publikun, njësoj si përballë rivalëve shumë të fortë nga vende të ndryshme të botës, kur e ka kanë bërë edhe Mynihun të flasë shqip.

Të tre të përzgjedhurit e kompozitorit Zhulali: Methasani, Kapexhiu e Ismail Keta, në akordancë të plotë me këngëtarët profesionistë Dritan Jashari, Altin Sulku, Lundrim Paçuku e Muharem Borova. Kësisoj, libohoviti Edmond Zhulali, të cilin e lidhin shumë gjëra me Dibrën, këtë rikompozim të këngës "Fluturon shqipja mbi Korab" (që siç pohon vetë është ndër më të dashurat e tij), e bëri me shumë pasion.

"Audio e çdo interpretuesi është bërë në shtëpi me celular dhe editimi i zërit ishte shumë i vështirë, por më dha shumë kënaqësi. Teksa shikoja Bujar Kapexhiun të këndonte me shumë pasion, më dha një ndjesi shumë të bukur. Edhe Ismail Keta kishte një pasion të jashtëzakonshëm, që tregon se nuk është thjesht një sportist i kampion bote, por edhe një patriot i madh", shprehet kompozitori Zhulali. Sipas tij, realizimi i klipit ishte pak i vështirë, pasi audiot janë regjistruar nga shtëpia e secilit artist me celular. Një punë për tu lavderuar është montimi në studio "Igli", e cila i ka dhënë shumë emocion, jetë dhe larmi këngës. Idesë sime dhe Tanit iu përgjigjen me dashamirësi të gjithë. Një grupi artistësh si Lundrim Paçuku, Altin Sulku dhe Remi Borova, iu bas

Teksti i këngës "Fluturon shqipja mbi Korab" është shkruar nga i paharruari Naim Plaku, të cilin kritika letrare, si poet të këngës, e radhit përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës. Kjo edhe për faktin se tekstet e Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat e botës, kur kanë përjetuar zërin e tyre melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N.Plakut: "O prite Azem Galicën", "Një gërshet u la me gjak", "Na knojnë pushkët nëpër kulla", "O i madhi Skënderbe", "Përcolla ylberin", "Mine mori Mine", "Tinguj krenarie", "Fluturon shqipja mbi korab", etj.

Refreni i kësaj të fundit: "Sillu shqipe nga kalaja/Kjo është Dibra maja-maja/Dibra pushkën e ka znat/Për Shqipërie për bajrak..." të ngjall emocione të forta e të bën për vete në çdo çast.

Është një këngë që të ngjall shumë dashuri dhe krenari, me të cilën nismëtar Methasani, si dhe kompozitori i shquar Zhulali synojnë të promovojnë Dibrën, historinë dhe vlerat e saj. Ata, si dhe Kapexhiu – "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i kombit", skenarist, regjisor, aktor e prezantues, dhe Ismail Keta, karriera e të cilit përmban ndershmëri e realizëm pa asnjë manipulim e përgënjeshtrim, me këtë këngë përcjellin mesazhin e dashurisë për atdheun.

"Fluturo shqipe mbi Korab", është një këngë që sjell diamante të vërteta nga folklori i zonës së Dibrës. Kjo këngë e interpretuar më parë me virtuozitet nga Dritan Jashari ka ngritur peshë zemrat e mijëra spektatorëve në koncertet recital të tij në Peshkopi, Tiranë, Dibër të Madhe, Selanik, Austri, Gjermani, Belgjikë, Itali etj.

Gjatë prezantimit të klipit të ri të kësaj kënge nëpërmjet një interviste me gazetaren Ola Bruka të Tv Neës 24, Edmond Zhulali i dërgoi dhe një mesazh të fortë gjithë politikës shqiptare, teksa i kërkoi të kthejë vëmendjen nga artistët, pasi janë pikërisht këta të fundit që bëjnë krenar vendin dhe popullin.

Rruga e Arbërit nr. 167

opinion

Fakti që Gjergj Kastriotit nuk i dihet dita e lindjes – madje as muaji i lindjes; madje-madje, as viti i lindjes – nuk ia ul aspak vlerat atij si Hero Kombëtar i shqiptarëve. Ai mbetet figura historike më e rëndësishme e kombit, simboli dhe frymëzimi i krijimit të tij.

Heroi i kujt ka lindur më 6 maj?


Nga **ARBEN KALLAMATA**

Akemi nevojë që vorbullës së gënjeshtrave që na vërtiten dita ditës t'i shtojmë edhe ditëlindjen e Skënderbeut? A ia vlen që shprehjes së përditshme të padijes dhe krenarisë për të qënin të paditur t'i shtojmë edhe një dëshmi tjetër? A nxjerrim ndonjë dobi duke i shtuar fakteve të shumta për mungesën e kulturës dhe etikës, për mosnjohjen e parimeve më të thjeshta morale të të drejtës dhe të vërtetës, edhe një mashtrim tjetër? A nuk mjafton që shtiremi sikur jemi, pa qënë aspak ekspertë në politikë, filozofi, letërsi, art, sport, mjekësi, inxhinieri, sociologji, gazetari, gjuhësi, sizmiologji, por duam të dalim edhe si specialistë në fushën e historisë duke shpikur apo përhapur gënjeshtra për data që nuk i ka përcaktuar dot asnjë shkencëtar deri më sot? Apo ndoshta imazhi që i kemi krijuar vetes si patriotë, nacionalistë, atdhetarë, shqiptaromëdhenj nuk ndihet shumë i sigurt pa i ngjeshur edhe disa mballoma rrenash që as vetë nuk i dijmë kush i ka sajuar?

Gjergj Kastriotit nuk i dihet dita e lindjes. Ky është fakt, është një e vërtetë. Të vërtetat nuk hidhen poshtë me gënjeshtra. Ato hidhen poshtë me fakte. E vërteta që Gjergj Kastriotit nuk i dihet dita e lindjes nuk mund të hidhet poshtë duke shpikur ditë lindje sipas dëshirave dhe interesave të grupimeve të caktuar dhe duke ftuar sa më shumë vetë që ta pranojnë gënjeshtrën. Të vërtetën që Gjergj Kastriotit nuk i dihet dita e lindjes mund ta hedhësh poshtë vetëm me një të vërtetë tjetër – duke gjetur një dokument që e vërteton atë. Përderisa nuk je në gjendje ta gjesh, atëherë më mirë hesht. Dita e saktë e lindjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeut nuk është gjetur ende. Të paktën deri sot nuk ka dalë në dritë asnjë dokument që ta vërtetojë atë. Përcaktimi i 6 Majit është një veprim arbitrar, propagandistik, keqdashës dhe i dëmshëm që shfrytëzon injorancën tonë për të zënë rrënjë. Ai është edhe një veprim i ulët, tinzar, krejtësisht anti-shqiptar.

Fakti që Gjergj Kastriotit nuk i dihet dita e lindjes – madje as muaji i lindjes; madje-madje, as viti i lindjes – nuk ia ul aspak vlerat atij si Hero Kombëtar i shqiptarëve. Ai mbetet figura historike më e rëndësishme e kombit, simboli dhe frymëzimi i krijimit të tij.

As përpjekjet për t'i caktuar arbitrarisht një datë lindjeje atij nuk ia ulin rëndësinë figurës së Gjergj Kastriotit. Ato na ulin vlerat dhe rëndësinë ne, sepse na paraqesin si një tufë injorantësh emocionalë të papërgjegjshëm, që jemi gati të gëlltisim çdo lloj karameleje që na shërbejnë. Duke i shpërndarë këto broçkulla ne s'bëjmë gjë tjetër veçse iu japin argumente për të vërtetuar tezat e tyre anti-shqiptarëve, ose anti-Kastriotëve.



A duhet të zgjedhim cili është heroi kombëtar?

Dhe, meqë ra fjala e sa për sqarim të gjithë patriotëve të flaktë, 6 Maji është zgjedhur pikërisht për t'ua hequr shqiptarëve heroin kombëtar dhe për ta kthyer atë në një figurë të ortodoksëve sllavë të Ballkanit. 6 Maji është caktuar arbitrarisht si ditëlindja e Gjergj Kastrioti Skëndërbeut pasi është data kur serbët, kroatët, maqedonët, bullgarët–përgjithësisht sllavët ortodoksë të Ballkanit festojnë Shën Gjergjin.

Po ta shohësh me kujdes kjo është për të vënë duart në kokë. Shën Gjergji i Krishtërimit është një figurë gjysmë-imagjinare, si shumë shenjtorë të tjerë, që mendohet se ka ekzistuar diku në shekullin e dytë, të tretë, të pestë ose të gjashtë. Hapni çdo enciklopedi, kontrolloni Wikipedian në Internet (dy minuta kohë) për të parë sa pasaktësi ka për shekullin kur ka jetuar ai. Shën Gjergji njihet si ushtar romak i krishterë që mposhti kuçedrën, ose dragonin (sipas Kishës në përgjithësi). Për detajet, Kishat ndahen sipas denominacioneve. Katolikët, protestantët dhe ortodoksët grekë ngulin këmbë që Shën Gjergji është vrarë në 23 Prill (dijnë datën, por nuk e kanë fare idenë as për vitin, as shekullin kur ka ndodhur). Ortodoksët rusë thonë se është fikur diku në Shtator. Ndërsa sllavët e Ballkanit ia festojnë ditën e vdekjes në 6 Maj.

Sa për sqarim të gjithë patriotëve të flaktë, 6 Maji është zgjedhur pikërisht për t'ua hequr shqiptarëve heroin kombëtar dhe për ta kthyer atë në një figurë të ortodoksëve sllavë të Ballkanit. 6 Maji është caktuar arbitrarisht si ditëlindja e Gjergj Kastrioti Skëndërbeut pasi është data kur serbët, kroatët, maqedonët, bullgarët–përgjithësisht sllavët ortodoksë të Ballkanit festojnë Shën Gjergjin.

Dita kur ai është vrarë festohet si dita e Shën Gjergjit. Pra, për hir të këtij Shën Gjergjit që paska vrarë kuçedrën (përrallë me bisht), që ka jetuar në shekullin e (oh, nuk dihet shekulli), por që është vrarë ose në 23 Prill, ose në 6 Maj, ose në Shtator, ne duhet t'i marrim pikërisht datën 6 Maj, atë datë kur ortodoksët sllavë të Ballkanit mendojnë se është vrarë heroi i tyre që vrau kuçedrën dhe t'ia veshim atë si ditëlindje Gjergj Kastriotit, heroit tonë Kombëtar. Pse? Sepse kështu na serviret nga kisha ortodokse e cila kërkon ta kthejë atë nga Heroin Kombëtar të shqiptarëve që hodhi themelet e identitetit kombëtar shqiptar, në hero të krishtërimit.

Ja këtu të çon padija e veshur me kostum patriotizmi. Prandaj përpara se ta postoni dhe ripostoni çdo 6 Maj atë përshëndetje patriotike gjithë pathos për ditëlindjen imagjinare të Gjergj Kastriotit, mendohuni pak në emër të kujt po gënjeni.

(Marrë nga flasshqip.ca)

Hazis Ndreu, mjeshtri i alegorisë

(vijon nga faqja 11)

Alegoria, në esencë, shpreh *pamundësinë* e gjuhës. Jorge Luis Borges shkruan: "*Me sa u deklarua e pamjaftueshme gjuha, ka vend për të tjerët; alegoria mundet me qenë një nga ato, si arkitektura a muzika. Ajo formohet prej fjalësh, por nuk është një gjuhë e gjuhës, një shenjë e shenjave të tjera të virtytit dhe të përndritjeve të fshehta që ajo fjalë shenjon*". *(Jorge Luis Borges: Inkuizicionet e tjera", f. 180, botimet Ideart, Tiranë 2005)*. Nuk ka si thuhet më bukur dhe më qartë. Por është vështirë për t'u kuptuar, prandaj as sot e kësaj dite, nga unë dhe nga askush tjetër, nuk ka ndonjë përkufizim për alegorinë. Ka perifrazime, shpjegime, por me asnjërin prej tyre nuk zbritet tek esenca. Borges e krahason alegorinë me arkitekturën dhe muzikën dhe thotë se nuk është gjuhë, por "një shenjë e shenjave të tjera të virtytit dhe përndritjeve të fshehta…" Pra, nuk është aq e thjeshtë të vendosë për alegorinë ndonjë që nuk është marrë me alegorinë. Nuk mund të vendoset aq lehtë edhe për ato shënimet.

Ta ilustrojmë me një fabul:

"*Kafshët e samarit një ditë u gdhinë në festë. Lodronin nëpër livadhe dhe hanin bar të butë. Vetëm një gomar plak nuk po merrte pjesë në këtë hare. Shkon një pulisht i vogël dhe i thotë:*

- *Po ti pse nuk po merr pjesë në festë?*
- *Çfarë feste është, se unë nuk di gjë?*
- *Ka vdekur samarxhiu dhe ne do të rrimë pa samar.*
- *Do të vijë një samarxhi tjetër, por me atë që paska vdekur qemë mësuar: ai na e futte një dorë kashtë në samar, kurse ky që do të vijë, do të na e lerë kurrizin për dërrasash. Prandaj mos bëni festë kot*".

Kjo është fabula. Por kjo nuk është alegori kështu e vetmuar. Po ta vësh këtë në një faqe libri të vetme, pa asnjë shënim, kjo lexohet dhe kuptohet si fabul. Fabula pa dyshim që ka vlerat e veta, por nuk është alegori. Alegoria është një vlerë e shtuar në një fabul. Vlera e fabulës, si e tillë zbehet shumë, kur ajo shndërrohet në alegori. Peshon vlera alegorike. Fabula e mësipërme shndërrohet në alegori kur i vë shënimin: *"U tregua në një mexhelis, kur po diskutohej për ardhjen në Dibër të Madhe të një mytesarifi të ri, tek i cili shumë syresh kishin varur shpresa se do ta përmirësonte punën dhe do të sillej më mirë me popullin*". Ky tregim alegorik, me këtë shënim, sjell mesazhin: mos kini shpresa te pushtetari i ri, se do të jetë më i keq se ai që iku. Kur një shënim i tillë duhet bërë për një alegori që buron nga një fabul, merre me mend sa është i domosdoshëm për një alegori që buron nga një tregim krejtësisht realist, që ngjan me një bisedë të zakonshme:

"Or Liman, kur po vija te shtëpia jote, pashë se njëri nga mullarët e barit të ishte anue e ishte në të rrëzue. Futja, një shtangë se të shkon gjithë ai bar kot,- tha nji nga katundarët sapo hyni te Limani në odën e burrave.

- Po, po do t'ja ve, por sune të rrijë ashtu, se nuk asht tue e gjetë gja", - u përgjigj i zoti i shtëpisë".

Si do ta merrni ju këtë bisedë? Sigurisht, si një informim të thjeshtë që një katundar I bën Limanit për animin e mullarit të barit, pra, do ta merrnin në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve.

Por kjo bisedë e zakonshme, po të ketë shënimin: "*U tregua në një valle burrash kur njeni nga dy miqtë ishte shtrirë në odë sa gjanë gjatë*", merr vlerë alegorike, se në Dibër, me anë të këtyre meseleve, kritikoheshin edhe qëndrimet e padenja të burrave në oda. Mund të jap shembuj pa fund që argumentojnë se alegoria nuk qëndron dot vetëm, por nuk dua ta mërzis lexuesin. Edhe këto dy shembuj e krijojnë bindjen për sa thamë.

Në vitin 1999 Haziz Ndreu botoi librin tjetër "Alegori dibrane", më i plotë, ku përfshiheshin edhe alegoritë nga "Tregime alegorike dibrane" (1983) që i kishim paraqitur bashkë, edhe alegori të reja. Këtë radhë Hazizi nuk kërkoi ndihmën time. Parathënien prej dy faqesh si dhe paraqitjen e alegorive ia ngarkoi Naim Plakut. Por, i ndjeri Naim, nuk e kishte përvojën dhe mundësinë për t'u marrë në mënyrë shkencore me alegorinë. Në Dibër nuk kishte studiues të folklorit. Mbledhës kishte, por edhe mbledhja nuk bëhej me ekzigjencë.

Problemi i dytë që Hazizi dhe unë kishim për të përballuar ishte **pamja shkrimore** që do t'u jepnin tregimeve alegorike. E nënvizuam se është një term domethënës, i përdorur për herë të parë nga unë. Në atë që kishte shkruar Hazizi dhe në mënyrën se si i kishte shkruar nuk mund të mbështeteshin. Siç e pamë, alegoria sipas Borgesit nuk është gjuhë. Çdo gjuhë në botë shpreh atë që është shkruar me germa nga alfabeti i saj në përdorim. Shpreh, pra, me anë të tekstit. Alegoria nuk shpreh atë që është shkruar. Ajo shpreh diçka tjetër që qëndron mbas tekstit. Megjithatë, alegoria jepet me anë të një teksti të caktuar, ky tekst duhet shkruar në bazë të rregullave të çdo gjuhe. Në rastin konkret, mbi kë binte barra kryesore për pamjen shkrimore? Hazizi e kishte bërë punën e vet, ai i kishte mbledhur alegoritë ashtu si kishte menduar se janë më mirë. Unë kisha shkollën, isha shkrimtar, kisha mësuar dialektologjinë në fakultet, por e njihja edhe në jetë: kisha marrë pjesë edhe në disa ekspedita dialektologjike me profesorët Dhimitër Shuteriqi e me profesor Bahri Becin dhe dija shumë mirë si mblidhej në popull fjala e tij. Mbi mua binte barra kryesore për t'i paraqitur gjuhësisht sa më mirë alegoritë, megjithëse ato i kishte mbledhur Hazizi. Kjo krijimtari popullore do të mbetej përjetë me gjuhën me të cilën do ta paraqitnin dy krijuesit që kanë punuar në harmoni mendimesh e ndjenjash. Për herë të parë alegoria po futej në kulturën e shkrimit. Ne ishim të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kishim. Tregimet që do të veçonim si më të bukurit, do t'i hidhja unë direkt në makinë të shkrimit. Hazizin e kisha pranë, tekstin origjinal e kishin mbi tavolinë. Përzgjidh dhe hidhi në makinë. Të dy jepnim mendimin qoftë edhe për një fjalë nëse duhej përdorur apo duhej zëvendësuar me një fjalë tjetër. Nëse ato krijime kanë vlera, nuk është vetëm merita ime, por, nëse kanë të meta, nuk është vetëm faji im. Është një punë e përbashkët. Ne diskutonim qoftë edhe për një fjalë. Për shembull, kemi diskutuar edhe për fjalën *depërtoj*. Ta futnim apo mos ta futnim në tekstin e tregimit se na dukej si sllave. Gjatë diskutimit arritëm në përfundimin se është fjalë e brumit të shqipes. Por meraku më ka dalë dhjetë vjet më vonë kur kam lexuar pikërisht për këtë fjali: "*Depërtoj. Kjo folje është krijuar nga parafjala e vjetër ndëpër (nëpër) dhe nyjës së përparme në numrin njejës ose shumës tek emrat e rasës gjinore "të", me parashtesën foljore-oj"* (*Petrit Imami: "Origjina e fjalëve në gjuhën shqipe"- fjalë të krijuara brenda shqipes, f. 187, 2011)*

Megjithëkëtë, ato tregime kurrë nuk i konsiderova të miat edhe pse i shkrova unë. Kur botova librin "Perlat e Dibrës"(1999), unë iu drejtova librit të Hazizit për të pasur sa më shumë alegori për ilustrim. Po kështu kam vepruar edhe kur bëra botimin e dytë, ku përfshihet krejt lënda e vëllimit të parë, plus dy kapituj të rinj. Për këtë mund t'u referoheni librave të mi: *"Perlat e Dibrës"(1999), f. 11, dhe "Perlat e Dibrës" (2008), f. 91, shënimeve përkatëse.*

Për atë kohë bëmë si bëmë dhe lexuesit morën në dorë "Tregime alegorike dibrane" (1983). Ndoshta Hazizi, megjithëse mua nuk më ka shprehur asgjë, ka ndonjë shenjë pendese për ndonjë mosarritje, kurse unë kam bindjen që nuk mund të bënim më shumë e më mirë. E meta e librit "Alegoria Dibrane" që Hazizi ka botuar më vonë, qëndron pikërisht te mosvënia e shënimeve për çdo alegori. Megjithëse kjo mënyrë paraqitje është zgjedhur nga Hazizi dhe ndihmësi i tij në këtë punë, Naim Plaku, ata janë "detyruar" që në një të tretën e alegorive në këtë libër të venë shënime. Shfletojeni këtë libër dhe do të bindeni se kjo është e vërtetë. E metë tjetër e këtij botimi qëndron edhe në faktin se çdo tregimi alegorik i është vënë një titull. Kjo nuk qëndron nga ana shkencore, se alegoria nuk mund të mbërthehet mbas një titulli, mbasi ajo përdoret për rrethana dhe kushte të tjera, për problem të tjera të pafundme, prandaj i bie që të ketë disa tituj një tregim alegorik.

Të gjitha sa thamë, herë në formë kritike, herë në formë vetëkritike, nuk ndryshojnë përfundimin: Haziz Ndreu ishte mjeshtër i madh alegorisë.

recensë

Mendime rreth librit etnologjik “Matja në gur e në dru”
të skulptorit dhe gjurmuesit, Artan Kurti

Libri “Matja në gur e në dru” një thesar i etnologjisë së brezave

Përse u emocionova shpirtërisht, kur autori ma dhuroi librin etnologjik “Matja në gur e në dru”?

Janë mbushur pesëdhjetë vite qëkurse i ati i autorit i librit, studiuesi i palodhur e gjurmëlënës, Dilaver Kurti i Matit, më aktivizoi, më nxiti, më dha krah e më vlerësoi në vallen e studimeve për kulturën popullore, për traditat e më gjerë. Ky bir i Matit e nip i Dibrës ishte studiues i përkushtuar në fushën e etnologjisë, muzeologjisë, të traditave atdhetare e më gjerë.

Pra, i biri, Artani, kishte realizuar këtë libër të rrallë, të çmuar, të ndritshëm për sot e brezat që do të vijnë. Me të drejtë i thonë: “Bëm baba të të ngjaj!” Emocion e krenari legjitime për mua e cilindo.

* * *

Artan Dilaver Kurti, intelektual matjan, veprimtar e organizator aktivitetesh të trashëgimisë etnokulturore, skulptor e master shkencor në fushën e etnologjisë e folklorit. Nga viti 2007, për dhjetë vite, drejtoi botimin e revistës historike-kulturore-letrare “Emathia”. Në vitet 2011-2019 drejtoi Qendrën Kulturore të Fëmijëve Mat, ku krahas veprimtarive të larmishme artistike-kulturore-sportive inicioi dhe veprimtari me lidhje përçimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të fëmijët matjanë. Gjurmues, organizator, botues dhe kurdoherë studiues i pasionuar. Pra, është shembulli i intelektualit të talentuar, të cilit i flasin puna, veprimtaritë dhe mbi të gjitha nderimi e vlerësimi për etnologjinë e brezave.

* * *

Në faqen e parë të studimit etnologjik “Matja në gur e në dru” është fiksuar një mesazh-testament fisnikërie e diturie, një mesazh jete që gjithnjë rrezaton mirësi, traditë, vlera të çmuara, mesazh dritëshpirti i autorit: *“Kujtimit të babait tim, Dilaver Kurti, i cili gjithë jetën ia kushtoi gjurmimit dhe studimit të trashëgimisë iliro-arbërore të krahinës së Matit, duke më edukuar edhe mua me dëshirën për të vazhduar rrugën e tij në fushën e trashëgimisë shpirtërore e materiale të popullit të kësaj krahine”* (fq. 3)

Qysh në fillim jepet me qartësi vlera e këtij libri, puna serioze e fisnike e Artan Kurtit, pasimi i traditës së shquar familjare. Për këtë Prof. Dr. Afërdita Onuzi shkruan: *“...Ndonëse Artani me këtë punim, por edhe më punë të tjera, ka krijuar personalitetin e tij, ai po ndjek me sukses edhe një traditë familjare në fushën e studimit të trashëgimisë kulturore të krahinës së Matit. Është fjala për atë traditë të mirë që krijoi studiuesi Dilaver Kurti, i ati i Artanit, si në fushën e arkeologjisë ashtu edhe të etnografisë”*. (fq. 5) Ia vlen të theksohen edhe personat e tjerë që e ndihmuan Artanin në finalizimin e këtij botimi: konsulentin Rakip Lasku, redaktoren gjuhësore Mimoza D. Kurti, botuesin e ILAR (*“Mirënjohje z. Ilir Lleshi për ndihmën e dhënë në botimin e këtij libri nga botimet ILAR”*), nipin i autorit, humani Marjus Gjoka, që mundësoi, siç thotë autori: *“...që puna ime disavjeçare të shohë dritën e botimit”*.

Libri “Matja në gur e në dru”, në 320 faqet e tij, pasqyron traditat e etnologjisë matjane, shpërfaqur me vërtetësi, argumente, realizëm dhe mjeshtëri. Ai dhuron një thesar të kulturës popullore, punë, mjeshtëri, figura e tradita të vyera, të cilat i rrezatojnë kohës dhe brezave.

Pas hyrjes së thjeshtë e mbresëlënëse të autorit, vijon shkrimi banesa popullore në krahinën e Matit. Autori krahas saktësisë së përshkrimeve, referencave, fjalëve e shprehjeve të urtësisë, ka realizuar dhe përfshirë me mjeshtëri ilustrime fotografike të kullave, të cilat i ngjajnë kështjellave, kulla të gurta të Oxhakut të Allamanit në fshatin Kurdarì, e Sahit Kryekurtit në fshatin Macukull, Ahmet Koçit në fshatin Gurrë të Vogël, kulla katërkatëshe e vëllazërisë Pasha në fshatin Gjòçaj, grupi i banesave karakteristike të vëllazërisë Hoxha në fshatin Shkallë të Xibrit e shumë të tjera të cituara në funksion të përdorimit. Autori Kurti shpjegon dhe argumenton emërtimin e banesës të tipit kullë, përshkruan e argumenton vlera historike e arkitekturën e kullave matjane, kulla të trevës së barutit e të qëndresës shumëshekullore.



Guri e druri janë dy simbole bashkudhëtare të jetës së brezave në gëzime e hidhërime, në pasimin e traditës, mençurisë e të mjeshtrisë nga brezi në brez. Vëzhgimi e studimi i përfituar për mjedisin jetësor në banesën popullore të krahinës së Matit, dyert e jashtme e të brendshme, shkallët e brendshme të banesës së vëllazërisë Barçi në fshatin Lis, vëllazërive Valteri në fshatin Vinjollë, Muceku në fshatin Macukull, Mata në fshatin Shëlli, Ruçi në fshatin Zenisht, shkallët e Liman Cekës në fshatin Shëlli etj, janë vërtet dëshmi e thesare të brezave, pasqyrë e shpirtit krijues dhe mençurisë popullore të brezave.

Në këtë libër shpjegohen me qartësi ndikimi i faktorëve gjeografikë dhe historikë në ndërtimin e banesës, roli i faktorëve ekonomikë dhe shoqërorë, oborret dhe mjediset përreth banesës, rrethimi i oborrit me avlli, mjedise ndihmëse. Pasqyrohet, midis të tjerave mjeshtëri Sabedin Kola dhe maketi i punishtes së barutit (fq. 46), por dhe dhjetra mjeshtëra e ustallarë matjanë e nga krahinat fqinje, që me punën e tyre lanë gjurmë të pashlyera të artit popullor dhe ndërtimtarisë. Në mjediset përreth banesës përshkruhen vendet e ruajtjes së prodhimeve bujqësore, llojet e kasharëve, arkitektura e jashtme e banesës dhe dekorimi i saj, e ilustruar me foto të kullës trekatëshe të Dyle Kryekurtit në fshatin Macukull të ndërtuar me gurë të bardhë të latuar. (fq. 53) Duke përshkruar punimet në pjesën e jashtme të banesës trajtohen zbukurimet me gurë të skalitur në portat e avllisë dhe të banesës, sheshenat, ndërtimi dhe dekorimi i tyre nga ana e jashtme. Të gjitha këto janë vërtet dëshmi të studimeve serioze të një pune pasionante e me dashuri për etnologjinë. Paraqitja e kullave karakteristike e Sulë Likursit në fshatin Gurrë e Madhe (Monument Kulture, fq. 67), kulla katërkatëshe (me katër poda) me çikmà e Elmaz Dezhgiut në fshatin Guri i Bardhë (Monument Kulture, fq. 68) e plot të tjera dëshmojnë zellin, korrektësinë dhe seriozitetin gjurmues të studiuesit Artan Dilaver Kurti. Autori studion me përkushtim edhe pjesët e arkitekturës së banesës popullore të krahinës së Matit, si dollapët e murit, dritaret e banesës, qoshet e mureve të saj të punuara me gur të latuar, ambientet higjieno-sanitare, varëse të ndryshme të fasadës së banesës, çatitë, oxhakët mbi çati, çezmat dhe puset. Ai përshkruan me detaje dekoracionet e përdorura në pjesët e jashtme të banesës e në portën e avllisë, ku janë trajtuar motive gjeometrike, floreale, kozmogonike e fetare, motivi i dorës, motive antropomorfe, motive zoomorfe, ku përfshihen motivi i shqiponjës, motivi i deshëve, i qenit, kalit, pëllumbit, zogut, gjelit, gjarpërit, motive që paraqesin lloje armësh, motivi i sahatit (orës), takëmet me simbolikë mikpritjen të trajtuara në gdhendjet e portave të banesave, mbishkrime fetare, pronësie, informuese historike, me simbolikë patriotike e politike, motive që paraqesin veglat e mjeshtërve ndërtues e plot të tjera. Këto përshkrime shoqëruar me ilustrime të shumta dëshmojnë se ky studues ka gërmuar, skeduar e analizuar përvojën e trashëgimisë së gdhendjeve dekorative në gur e në dru në banesat me shtrirje të gjithë skajet e trevës së Matit, nga Ulza në Macukull e deri në Gurë të Bardhë.

Guri e druri janë dy simbole bashkudhëtare të jetës së brezave në gëzime e hidhërime, në pasimin e traditës, mençurisë e të mjeshtrisë nga brezi në brez. Vëzhgimi e studimi i përfituar për mjedisin jetësor në banesën popullore të krahinës së Matit, dyert e jashtme e të brendshme, shkallët e brendshme të banesës së vëllazërisë Barçi në fshatin Lis, vëllazërive Valteri në fshatin Vinjollë, Muceku në fshatin Macukull, Mata në fshatin Shëlli, Ruçi në fshatin Zenisht, shkallët e Liman Cekës në fshatin Shëlli etj, janë vërtet dëshmi e thesare të brezave, pasqyrë e shpirtit krijues dhe mençurisë popullore të brezave.

Me interes të veçantë në këtë libër është çdo shkrim e foto, çdo diçiturë, por veçanërisht të le mbresa studimi “Oda e zjarrit” ose “Shtëpia e bukës” dhe pajisjet e përdorura, si enët prej druri dhe teknikat e punimit të tyre, ku shpërfaqen intuita, talenti krijues dhe gjurmët e traditave të shquara të mjeshtërave popullorë, puna dhe talenti, gjurmët dhe vlerat e çmuara të cilat u rrezatojnë kohërave, brezave e, pse jo, shekujve të tërë.

Përshkrimi i dekoracioneve të përdorura në ballet e oxhakëve, si motivi i shqiponjës e plot të tjerë, tregojnë se autori me shpirtin krijues e gërmues, me pasionin e një “gjeologu” të etnologjisë, ka gërmuar e pasqyruar vlera të çmuara e na ka dhuruar, vërtet, thesare kulture etnografie, jetë-pasqyrë e dëshmi për brezat sot e nesër.

Përshkrimi e argumentimi mbi tavanet me dekoracione artistike, të punuar me dru e të suvatuar, pasqyrimet e mjeshtërave popullorë, përshkrimi i sixhadeve, teknika e prodhimit dhe dekoracionet e tyre, llojet e qendisjeve etj, tregojnë pasionin prej studiuesi e artisti punëndritur e këmbëngulës, human e realist, intelektual i sedrës dhe realizimit mjeshtëror.

Treguesit e emrave, literatura e shfrytëzuar, albumi fotografik me ngjyra, ku jepen vërtet figura, vlera e kulla, gjurmë të etnologjisë, tregojnë se libri “Matja në gur e në dru” është një dritare e provave studimore-shkencore, një libër thesar i etnologjisë së brezave.

Unë, si studiues e adhurues i veprës së paharruarit Dilaver Kurti, si mirënjohës në përjetësi për ç’ka kanë bërë babë e bir, e përshëndes me dashamirësi e çiltërsi të nderuarën Prof. Dr. Afërdita Onuzi, për atë që ajo thotë në hyrje të librit “Matja në gur e në dru” unë i ritheksoj me krenari fjalët e saj: *“Jam e sigurtë që kushdo që do ta lëxojë këtë libër, do të thotë: “Falemnderit, Artan!”*. (fq.5) Edhe unë them: *“Faleminderit, Artan, intelektual e pasionant i studimit të etnologjisë! Bir i studiuesit, korife të Matit e të kombit, Dilaver Kurti.”*

Mevlud BUCI,
studiues e publicist

Botimi i kësaj gazete është punë vullnetare,
ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.
Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që
gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

**Një LIS, nga ata lisa që i kanë rrënjë thellë në tokë,
aq thellë sa nga lartësitë e malit pinë ujë në Drin...**

Iku Qerim Sula, një mal që mbolli e rriti lisa



Po, po, një MAL, jo vetëm i Dardhës ku lindi 69 vite të shkuara, por i gjithë Dibrës, i Luginës së Drinit të Zi dhe i Nëntë Maleve.

Një LIS, nga ata lisa që i kanë rrënjë thellë në tokë, aq thellë sa nga lartësitë e malit pinë ujë në Drin...

Kam bërë njëherë një reportazh, një udhëtim ulur në vendin e parë të "Skodës" së tij, të përpjetës nga Shënlleshe në Soricë e Qan... Asokohe shkruaja...

"Këtu kishte trojet e vjetra Eles Isufi, "Gjenerali me Shajak" e këtu e kishte kaluar fëmijërinë Hazis Ndreu i këngës dhe i valles popullore dibrane. Pak më tej, në Lashkizë kishte lindur Lirie Rasha e pak më poshtë Saje Poleshi e Xhediku i këngës "Cuca e Radomirës"...

Të përpjetës së Soricës, jo asaj që ngjitet nga Zall Dardha në këmbë por asaj që ngjitet nga Shënlleshe i isha ngjitur një herë në kabinën e skodës së Qerim Sulës. Nuk mund ta harroj atë çast nga jeta ime, atë ndërthurje të këngës me gulçimën e diezelit të kamionit si në një simfoni të pambaruar, atë madhështi të fjalëve të këngës ku flitej për luftërat popullore të Dibrës kundër pushtuesve, për trimërinë e gruas që në llogore "ngrehte pushkën e piqte bukën".

E kisha dëgjuar atë në skenën e shtëpisë së kulturës, e kisha parë në ekranin e vogël kur jehonën e saj e merrte Kalaja e Gjirokastrës për t'ia dhënë Malit të Gjerë, por kaq të madhe, kaq jetësore, kaq epike nuk e kisha parë e dëgjuar. Qerim Sula kishte në duar timonin e vërtetë të këngës, atë timon që pas çdo kthese ngjitej e pas çdo fjale rritej...

Kisha shumë kujtime nga ato male, shumë mall për ata njerëz që gjithnjë kanë tundur dhe tundin djepin e këngës dhe valles popullore dibrane."

Së fundi me të u takova në "Oda Dibrane" 2017...

U takova e bëmë një fotografi dhe bashkuam zërat me shpirtin dhe dashurinë që na kish ndarë prej shumë vjetësh...

Në arkivin tim gjeta një intervistë mbase nga të fundit e Qerim Sulës, një bisedë e bukur, pa emër intervistuesi as në fillim e as në fund...

I kërkoj ndjesë. Ia vlen ta lexosh.

Ka emrin dhe shpirtin e tij shkrirë në këngën e tij...

I qoftë dheu i ngrohtë...

Abdurahim Ashiku
Athinë, 31 maj 2020



QERIM SULA: pa folklor nuk ka komb

Këngëtari popullor Qerim Sula është një nga emrat e nderuar të Dibrës dhe të muzikës sonë popullore. U lind në Zallë – Dardhë të Dibrës në 12 prill 1951. Edhe pse mbaroi shkollën mekanike, ai ishte dashuruar dhe i përkushtuar për muzikën, ndaj që në moshë të re u aktivizua me grupet amatore të Zallë –Dardhës. Ndërsa në vitin 1967 me ansamblin "Dibra". Një vit më pas në 1968 bën prezantimin e parë në Festivalin e Parë folklorik të Gjirokastrës me këngën e Hazis Ndreut, ku u vlerësua me çmim të parë për interpretimin e tij. Ka marrë pjesë në të gjitha Festivalet Folklorike deri në vitin 2000. Është aktivizuar në mjaft trupa e ansamble si dhe ka qenë pjesëtar i Estradës Profesioniste të Peshkopisë. Ka kënduar në shumë skena të vendit por edhe jashtë shtetit si në Gjermani, Austri, Turqi, Belgjikë, etj. Në vitin 1981 ishte në Kosovë me ansamblin "Kukësi i ri". Në repertorin e tij ka një numër të madh këngësh epike, duke qenë nga këngëtarët më të suksesshëm të trevës së veriut, i vlerësuar me mjaft çmime e diploma të ndryshme, në aktivitet kombëtare. Prej disa vitesh është në pension dhe jeton në Tiranë, me pasionin dhe shqetësimin e madh për folklorin dhe muzikën e bukur popullore shqiptare.

Z. Qerim, kur e keni nisur karrierën tuaj si këngëtar? Ka qenë trashëgim nga familja apo dhunti e natyrës?

Qerim Sula: - Karrierën time si këngëtar e më vonë edhe si kompozitor e kam filluar që në moshë të re, në fshatin tim të lindjes, Zallë- Dardhë të Dibrës. Talenti im, në një farë mënyre, buron që nga familja ime, pasi familjarë të mi janë marrë me art dhe me kulturë. Kam kënduar fillimisht me grupet artistike amatore të zonës. Më vonë, në moshë të re, më çuan në estradën profesioniste të Peshkopisë. Ua di për nder gjithë atyre artistëve të mëdhenj e të apasionuar që ishin me emër e figura të njohura në Dibër. Veçoj një artist të madh që nuk jeton më, Haziz Ndreun, i cili më zbuloi mua si talent dhe më vonë më çoi në Peshkopi. Si artist, për herë të parë, kam dalë në skenë në vitin 1968, më këngën e Lam Dacit, një luftëtar dibran të cilit i këndohej kënga e kreshnikëve të maleve. Këtë këngë e bëri i ndjeri Haziz Ndreu. Kisha emocion se isha pjesë e grupit të Dibrës në Festivalin e parë të Gjirokastrës, por e realizova me sukses. Salla më priti shumë mirë, më uronin të gjithë dhe unë u hutova fare, se dija çfarë kisha bërë, isha vetëm 17 vjeç.

Unë jam ndër artistët e paktë të këngës epike dibrane dhe asaj shqiptare. Gjithë jetën time artistike ia kam kushtuar historisë së popullit të Dibrës dhe të popullit shqiptar.

Kam një jetë artistike 30-vjeçare, këngët që kam kënduar unë janë për heronjtë, luftërat, për qëndresën e popullit tonë gjatë shekujve. Me thënë të drejtën Dibra ka nxjerr artistë të mëdhenj, si Haziz Ndreu, i cili nuk jeton më, një artiste tjetër e madhe është Liri Rasha, regjisori Skënder Cala, Vera Laçi, Arif Vladi, Caje Poleshi me këngën "O Mirë se na erdhe", e cila u bë jehonë atë kohë, u bë hit i këngës popullore të Dibrës. Të gjithë këto artistë kanë dalë nga Zallë –Dardha, e cila është një vend që me të drejtë e kanë quajtur djepi i artit në Dibër, se aty është thesari i folklorit në Dibër. Zalle - Dardha gjithë Dibrës i ka dhënë kulturën dhe artin, e furnizonte me artistë, këngë e valle.

Qerim Sula: Sot arti ka më tepër liri, por është harruar ajo që buron nga populli, folklori, arti po bëhet biznes. Kënga burimore e veriut ka ngelur pak në harresë, por jo vetëm ajo e veriut po edhe e Shqipërisë. Sot nuk po punohet më me talentet e rinj, madje edhe folklori i popullit po manipulohet, keqpërdoret. Më ven keq që nuk shfrytëzohen aq sa duhet ato burime se populli është thesar i pashtershëm.

Të shumë janë artistët nga Zall Dardha dhe unë e kam për nder të jem një nga ata. Pra, para se të merrja pjesë në ansamblin "Dibra" unë kam marrë pjesë në Ansamblin "Kuvendi" të Zall - Dardhës, i dekoruar me urdhrin "Naim Frashëri".

Atë kohë ky ansambël ishte ndër ansamblet më të shquar, të cilin e drejtonte Xhelal Çerpja. Talentet në Zall - Dardhë nuk kanë munguar asnjëherë ku mund të kujtoj këtu dhe Arif Hysën.

Në këtë ansambël të kuvendit u aktivizonin edhe ato që nuk ishin nga zona si, Shaban Mziu, i cili ishte një rapsod shumë i mirë. Më pas shkova në ansamblin "Dibra" dhe atje u evidentova si këngëtar epik, atje vazhdova aktivitetin tim për 30 vjet, në estradën profesioniste të Peshkopisë.

Gjatë kohës sime si profesionist kam marrë pjesë në të gjitha Festivalet Folklorike Kombëtare dhe në mjaft aktivitete ndërkombëtare, në takimet midis rapsodëve që organizoheshin në atë kohë e shumë të tjera. Jam dekoruar me urdhrin "Naim Frashëri" të klasit të pare.

A jeni i kënaqur sot kur hidhni vështrimin pas në karrierën tuaj artistike?

Ishte e vështirë që në atë kohë t'i thoje vetes artist, se duhet të plotësoje shumë kërkesa. Por më e rënda ishte se kënga censurohej. Duhet të përmendje Enver Hoxhën për ndryshe nuk të nxirrte kush në skenë. Por artistët, të gjithë ne së bashku, bënim gjëra shumë të bukura, kompozitorët punonin shumë. Kompozitorë të shkëlqyer si Përparim Tomçini, Edmond Zhulali, ata ngelen për mua më të mirët, me të cilët kam pasur shumë sukses. Sot arti ka më tepër liri, por është harruar ajo që buron nga populli, folklori, arti po bëhet biznes. Kënga burimore e veriut ka ngelur pak në harresë, por jo vetëm ajo e veriut po edhe e Shqipërisë. Sot nuk po punohet më me talentet e rinj, madje edhe folklori i popullit po manipulohet, keqpërdoret. Më ven keq që nuk shfrytëzohen aq sa duhet ato burime se populli është thesar i pashtershëm.

Çfarë mendoni për festivalet e fundit folklorike, pasi ju keni marrë pjesë thuajse në të gjitha festivalet në vite?

Festivalet e fundit po mundohen të ruajnë ato vlera që ka populli, por nuk duhet të prishet folklori i popullit, sidomos gjatë përpunimit, siç ka ndodhur në shumë raste, se ai nuk ka vlerë më pastaj. Në të gjitha festivalet apo takimet kombëtare shikoj që nuk po i përpunojnë mirë këngët e vallet e popullit, rrallë herë ia arrijnë suksesit.

Qerim Sula: Sot nuk po punohet më me talentet e rinj, madje edhe folklori i popullit po manipulohet, keqpërdoret. Më ven keq që nuk shfrytëzohen aq sa duhet ato burime se populli është thesar i pashtershëm.

Qerim Sula: zëri i lavdisë shekullore dibrane

Nga **ARSIM KOLARI**

Dibra, e vendosur në pjesën e brendshme të truallit arbëror, nëpër shekuj luajti rolin vendimtar si qendër politiko-administrative, strategjike dhe ekonomike të trevave shqiptare. Jo rastësisht në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në dhjetor të vitit 1912, Dibra u bë objekt debati midis përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse, të cilat për fat të keq e ndanë atë më dysh. Përballjet e panumërta historike dhe përplasjet e egra me armiqtë shekullor, e mësuan popullsinë dibrane të përshtaste forma organizative-shoqërore që edhe në kushtet më të egra të pushtimit, të mbijetonte e papërkulur në lirinë e vet.

Me këtë motiv vijnë në konsideratë, veç tjerash, qindra vargjet e poetit Naim Plaku, si jehonë e qëndresës së lavdishme dibrane. Por, vargjet e poetit të papërsëritshëm, u kënduan në skenë me shumë pasion nga këngëtari Qerim Sula, zëri i të cilit bëri vend në gjithë zemrat shqiptare, që lirinë atdhetare e deshën më shumë se veten.

Qerim Sula, u lind në prill të vitit 1951 ne komunën e Zall Dardhës në Peshkopi, ku kreu shkollën fillore, për ta vazhduar të mesmen në shkollën mekanike të Peshkopisë. U aktivizua në grupet amatore të Zall Dardhës, ndërsa në vitin 1967 bën prezantimin e parë skenik në edicionin e parë të Festivalit Folklorik të Gjirokastrës me këngën e mjeshtrit Hazis Ndreu "Kënga e Lam Dacit", ku u vlerësua me çmimin e parë.

Historia e Dibrës u këndua nëpër oda nga artistët popullorë dibranë, veçanërisht me daljen në skenë të Hazis Ndreut, por pasuesi i këtij brezi të artë artistësh, qysh herët u bë Qerim Sula me zërin e tij kumbues. Pas shumë prezantimesh para publikut shqiptar, në vitin 1978 ai publikon projektin me të cilin sot identifikohet karriera e tij artistike "Na këndojnë pushkët nëpër kulla". Autori i tekstit, Naim Plaku dhe autori i muzikës Përparim Tomçini, ia besojnë pikërisht Qerim Sulës këtë projekt "të rrallë" muzikor, sepse ishte i vetmi që mund të jepte maksimumin gjatë prezantimit të kësaj kënge të suksesshme në gjithë epokat e artit muzikor popullor shqiptar. Realizimi i kësaj kënge është histori më vete dhe meriton më shumë hapësirë për t'u rrëfyer, por ajo për herë të parë u këndua në skenën e Festivalit të Gjirokastrës në vjeshtën e vitit 1978, ku Qerim Sula u vlerësua përsëri me çmim të parë.

Emocione të mëdha, artisti përjeton në vitin 1981 kur bashkë me ansamblin "Kukësi i ri" organizojnë turne disa ditor në Kosovë, ku gjatë prezantimeve të tij, publiku kosovar hidhej përpjetë me sy të përlotur nga mallëngjimi dhe jehona e këngëve patriotike.

Veç kësaj, Qerim Sula si fillim u aktivizua në "Estradën Profesioniste të Peshkopisë", pastaj në shumë trupa amatore, ndërsa deri në vitin 2000 mori pjesë në të gjitha edicionet e Festivalit Folklorik të Gjirokastrës, ku u nderua me çmimet më të rëndësishme të festivalit.

Përveç brenda vendit, ai debutoi nëpër skenat e mërgimtarëve të Gjermanisë, Austrisë, Belgjikës, Turqisë, etj.

Në sirtarin e tij artistik radhit 10 albume artistike, kryesisht me këngë epike, siç janë: "Kënga e Hajredin Pashës", "Kënga e Elez Isufit", "Djemtë e Dibrës marrin hak", "Mu në ballë shqipja e flamurit", "Për liri e për vatan", "Kënga e Dom Nikollë Kaçorrit", e shumë tjera, të punuara me kompozitorët e shquar dibranë, Përparim Tomçini, Imer Seferi, Xhelil Ymeri, Edmond Zhulali, etj., duke u bërë njëri nga këngëtarët më të vlerësuar të trevave veriore.

U vlerësua me çmime e mirënjohje të ndryshme nëpër aktivitete të shumta kombëtare, por në vitin 2013 nga Presidenti i republikës Bamir Topi, u dekorua me titullin "Mjeshtër i Madh".

Qerim Sula ndërroi jetë më 31 maj në Tiranë, dhe sipas amanetit, trupi i tij u preh në vendlindje, Zall Dardhë. Ndërsa zëri i tij do të këndojë në shekuj, duke mbushur zemrat shqiptare me dashurinë për atdheun.

LULZIM BASHA:

QERIM SULA, besnik muzikës së vërtetë të popullit



Me hidhërim mora vesh për ndarjen nga jeta të rapsodit të njohur Qerim Sula.

Breza të tërë artdashësish të muzikës popullore shqiptare u rritën me këngët epike të Qerim Sulës, kësaj ikone të këngës dibrane të shumënjohur në të çdo trevë ku flitet e këndohet shqip.

Duke marrë stafetën e një historie të shkëlqyer muzikore nga legjenda Hazis Ndreu, interpretimi i këngës epike nga Qerim Sula mbushte me krenari çdo shqiptar, edhe në një kohë të vështirë kur kënga epike nuk shihej me sy të mirë nga diktatura, sepse i bënte hije përpjekjes shpirtvogël për ta zëvendësuar trashëgiminë muzikore të vendit me këngët për kultin e diktatorit.

Këngët e Qerim Sulës ishin këngë të qëndresës, këngë të mbijetesës, prandaj edhe kumbonin kudo, si hymne që bartin krenarinë dhe vetëdijen se folklori e historia jonë do të triumfonte mbi përpjekjet e diktaturës për zvetënimin e "njeriut të ri", shqiptarit të kthyer në skllav.

Qerim Sula i këndoi jo vetëm trimërisë së dibranëve përballë okupatorëve, ai i këndoi jo vetëm namit të mirë të kësaj trimërie, por ai i ngriti himn mbijetesës së kombit tonë.

Në dy kohë, Qerim Sula dha modelin se si artisti nuk plaket, nuk del jashtë kohe, kur i mbetet besnik muzikës së vërtetë të popullit.

Ngushëllimet dhe lutjet e mija shkojnë sot tek familja Sula që humbi njeriun e saj të shtrenjtë.

Dibranët dhe mbarë shqiptaria ndahen sot nga kjo ikonë virtuoze e këngëve të qëndresës, por jo nga vepra artistike e Qerim Sulës që kumbon përjetë si trashëgimi brez pas brezash dhe si frymëzim i përditshëm për secilin prej nesh.

Nuk mund ta përcjell këtë ngushëllim përveçse me një prej hymneve të Dibrës e mbarë Shqipërisë që ngren peshë shpirtin e çdo shqiptari patriot, sot e sa të jetë jeta. I lehtë i qoftë dheu!



Populli të bukurën e ka vetë, atë mund ta marrësh ta përpunosh po nuk duhet të prishet e bastardohet. Unë bëj thirrje që të bëhen sa më shumë takime, të bëhen gjëra të bukura për folklorin se ai është arti që ngelet. Bota e ruan me fanatizëm folklorin e vet. Ashtu duhet të bëjmë edhe ne.

Unë kam punuar me shumë artistë, por veçoj Liri Rashën me të cilën kam qenë në Estradën profesioniste të Peshkopisë, me Arif Vladin një artist i kompletuar, kam punuar me Vera Laçin një këngëtare shumë e mirë, me Sherif Dervishin, me të madhin Haziz Ndreun, i cili ishte profesori ynë dhe të gjithë ne që dolëm në skenë, është puna dhe djersa e Ndreut.

Të gjurmojnë artin, ta gjurmojnë thesarin e popullit, të nxjerrin në pah të bukurën, të merren me këngën popullore se është e bukura e kombit, pa art e pa kulturë nuk ka komb.

Çfarë mendoni për «Odën dibrane»?

"Oda dibrane" është një dhuratë e artistëve dibranë. Për mua është një vlerë që bëhet çdo vit, në të cilën marrin pjesë artistë nga të gjithë ansamblet, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Aty tregohen të gjitha vlerat e folklorit të një kombi.

Është gjëja më e bukur që është arrirë në këto vite dhe kjo falë drejtorit të Shtëpisë së Kulturës në Peshkopi, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kryetarit të Bashkisë, të cilët e kanë mbajtur gjallë jetën artistike të Peshkopisë dhe vetë "Odën dibrane". Të gjithë biznesmenët kanë investuar për këtë që ajo të ketë vazhdueshmëri edhe në të ardhmen, pasi aty marrin pjesë të gjitha grupet, është një gjë e veçantë dhe një gjë shumë e bukur, pasi në këtë manifestim kulturor tregohen vlerat e Kosovës, e Jugut, e të gjithë Shqipërisë...

Cilat janë disa nga këngët tuaja më të mira ndër vite?

Kam kënduar shumë këngë, në repertorin tim kam mjaft krijime e bashkëpunime me kompozitorë të shquar, por do veçoj këngët "Zot t'i dalim këtij vatani", kënga e Festivalit të Gjirokastrës në 1983 "Na knojnë pushkët nëpër kulla", "Bini o ju trajma, bini", "Ballë për ballë Dibra Dushmani", "Më ka lind nana mos me vdek", "Jam shqiptar dhe s'shuhem kurrë" e shumë të tjera të cilat janë disa nga këngët më të mira.

- A keni nxjerrë albume në këto vite?

Po, kam nxjerr një album me këngët e mia më të mira, ndërsa tani po punoj me Edmond Zhulalin për të realizuar diçka tjetër të bukur. Mendoj që të nxjerr një album tjetër dhe shpresoj të dalë me sukses.

- Kush janë disa nga emrat e spikatur me të cilët ju keni kënduar gjatë karrierës suaj të gjatë artistike?

- Unë kam punuar me shumë artistë, por veçoj Liri Rashën me të cilën kam qenë në Estradën profesioniste të Peshkopisë, me Arif Vladin një artist i kompletuar, kam punuar me Vera Laçin një këngëtare shumë e mirë, me Sherif Dervishin, me të madhin Haziz Ndreun, i cili ishte profesori ynë dhe të gjithë ne që dolëm në skenë, është puna dhe djersa e Ndreut.

Cili do të ishte mesazhi apo shqetësimi juaj si artist?

Mesazhi im ka të bëjë me këngën popullore shqiptare, ndaj iu drejtohem kompozitorëve, artistëve, Ministrisë së Kulturës e strukturave të tjera shtetërore e private që ta ndjekin, ta përpunojnë, ta kultivojnë këngën popullore. Të gjurmojnë artin, ta gjurmojnë thesarin e popullit, të nxjerrin në pah të bukurën, të merren me këngën popullore se është e bukura e kombit, pa art e pa kulturë nuk ka komb.

Haki Kola: T'i themi ndal budallallëkut tonë në trajtimin dhe menaxhimin e pyjeve.

intervistë

Katastrofa ekologjike është *ulur këmbëkryq në malet tona*

"Nëse në shkallë vendi e fillojmë nismën për përmirësimin e shkurreve të degraduara, do të hapet një "autostradë" me punë e që do jetë shumë frytdhënëse për t'i ndryshuar pamjen vendit, me ekonomi të mbështetur tek e gjelbra e përjetshme që mund të zëvendësojë naftën e qymyrin e gurit".

Më poshtë po ju paraqesim një intervistë të tij dhënë dy vite më parë gazetarit Bashkim Koçi, përgatur për botim nga Abdurahim Ashiku, në shenjë nderi dhe respekti për Haki Kolën që iku pa e vënë në zbatim ëndrrën për një pylltari të kohës në të gjithë hapësirën e Shqipërisë dhe Kosovës.

Intervistoi: **BASHKIM KOÇI,** *dhjetor 2018*



–Inxhinier! Si është sipas jush gjendja, mund të jepni një informacion të shkurtër rreth situatës që përjetojnë pyjet në vendin tonë?

– Sot kemi një situatë që nuk duam as ta besojmë dhe as ta pranojmë. Por nuk duhet të ishim befasuar. Pylli është pasuri e ripërtëritëshme. Por kjo nuk do të thotë se është një depo natyrale e pafundme. Jetojmë një situatë që shteti ynë e ka ligjëruar "vdekjen" e aktiviteteve tregtare në pyje, çka nënkupton se vetë pylli që ne vazhdojmë të kemi në mendje, e ka humbur funksionin prodhues. Midis imagjinatës tonë se si e kemi natyrën, pyllin dhe realitetit, ekziston një hendek i madh. Kush ka sy e veshë, kush gjykon për mjedisin ku lind e jeton, lëviz e sheh nëpër Shqipërinë tonë të vogël, apo thjeshtë informohet sadopak nga media, e ka bindjen që mbulesa e gjelbër e tokës tonë është dobësuar e pakësuar së tepërmi qoftë nga prerja apo zjarret e deri tek kullotja, gërmimet e gërryerjet.

-Situata, sipas jush, është e rëndë?

– Sigurisht. Një shoqëri normale duhet të reagonte me urgjencë. Qeverisjes duhej t'i kujtohej se pakësimi i bimësisë në male e kodra, është rrezik për tokën tonë, djepin që na ka lindur e na siguron jetesën. Nëse i bëhet krahasim gjendjes dhe ecurisë së mbulesës pyjore, nuk është e vështirë të konkludohet që në 20 vitet e fundit, shkatërrimet kanë qenë më të mëdha se sa për disa shekuj, që kur disponohen materiale e dëshmi të shkruara e trashëguara. Realiteti është i hidhur po të mendosh që shoqëria jonë pretendon se është në progres e aq me tepër po realizon kritere për t'u bërë e pranueshme nga bashkësia Evropiane. Praktikisht duket sikur nuk dimë të shohim, mendojmë e tregojmë. Të trishton paaftësia jonë për të reaguar, kur është cënuar djepi i jetës dhe e ardhmja e saj, në një atdhe me male pa bimë, e dalëngadalë pa tokë. Jetojmë një kohë që e ka sfiduar tokën, duke e rrezikuar deri në ekstrem zhdukjen pa rikthim të saj në shumë pjesë të vendit, për shkak të budallallëkut tonë, si dhe mungesën e përgjegjësisë personale të çdo individi të shoqërisë karshi jetës për të sotmen e të nesërmen e shqiptarëve. Nëse shkatërrimi i pyjeve e bimësisë së maleve do të vinte për faktorë që janë jashtë kontrollit tonë, së paku secili nga ne do të ishte i qetë në ndërgjegjen e tij. Por është fakt se shkatërrimi vjen vetëm nga veprimi i gabuar e i verbër i pjesës sunduese dhe nga mosveprimi i pjesës së sunduar të shoqërisë tonë. E ky realitet monstruoz e vendos gjeneratën e inteligjencës aktuale të vendit tonë në një situatë të vështirë morale. Kur fermerët evropianë i mundën mbretëritë e i detyruan që pjesën e pyllit dhe kullotës, për të plotësuar nevojat e tyre, ta merrnin në pronësi, Alpet Evropiane ishin pothuaj të zhveshura nga drurët. Shqiptarët ishin nën okupimin otoman dhe nuk arritën të bënin të njëjtën gjë.

– Konkretisht, ç'dëshiron të thuash?

-Ajo që të befason është mos interesimi për të ndërtuar marrëdhënie legale me shtetin qe e formuam para më shumë se 100 vitesh. Sipas meje mbetet një enigmë, një nga çudirat shqiptare, që çka e kishin bërë të pushtuar, duke e fiksuar në kanun e duke i vënë kufij guri të përjetshëm, nuk arritën t'ja prezantonin shtetit të tyre e ta bindin që këto kufij që vinin nga thellësia e shekujve, duheshin legalizuar. U mbetet studiuesve të historisë që t'i japin përgjigje kësaj sjelljeje enigmatike, jo vetëm nga ana e Qeverive të pas epokës socialiste, por edhe e komuniteteve, sidomos e atyre malore. Katastrofa ekologjike është ulur këmbëkryq në malet e kodrat tone. Çfarë ka ndodhur, nuk mund të zhbëhet. Kapërcimet që bëhen shpesh nga ata që shoqëria jonë i paguan për ta parandaluar këtë gjendje, shpejt do i përgjigjeshin arsyetimit tim: nuk kemi të dhëna të mjaftueshme e duhet bërë vlerësim. Në fakt tani secili duhet të bindë veten se është koha për veprim. Unë jam shumë i bindur në vetvete, që i vetmi resurs kritik që i duhet popullit është ai vetë. Tek vetvetja e secilit, nëse e organizojmë mendimin tonë, nëse marrim një vendim për të gjetur në mënyrë urgjente zgjidhjen si komb. Dijet i kemi të mjaftueshme për ta gjetur atë. Dhe për më tepër, nëse shpëtojmë tokën tonë nga kjo katastrofe ekologjike, i kemi shërbyer mbijetesës sonë e gjeneratave që na vijnë pas.

–Mendoni se shteti, qeveritë që e kanë drejtuar këtë vend kanë kapitulluar në menaxhimin e kësaj pasurie të çmuar kombëtare?

-Realiteti që jetojmë është kokëfortë dhe flet, sado të përpiqemi të bëjmë avokatin për shtetin, në të dy sistemet. Megjithatë duhet pranuar një fakt: Asnjëherë shqiptarët nuk e kanë patur me shumicë as tokën bujqësore, as atë pyjore apo kullosore. Historikisht është luftuar për mbijetesë në një hapësirë pabesueshmërisht të ngushtë në male tepër të brishta e akoma në formim, në kushtet e një klime mesdhetare shumë në favor të biodiversitetit, por jo shumë në favor të bollëkut, përsa i përket prodhimtarisë. Pikërisht në situata kritike njerëzit mësojnë, ashtu siç mësuan edhe ne shqiptarët për të përdorur me kursim e rregulla pyllin, kullotën, malin e fushën, duke i kombinuar me njëra-tjetrën e përftuar nga sinergjia që krijon bashkëjetesa e bujqësisë, pyllit e kafshëve shtëpiake. I përvetësuam, dhe mësimet e rregullat i fiksuan në kanune, ndoshta modele që aktualisht kërkohen nga shumë shkencëtarë e universitete. Këto thesare me dije të shkruara, shoqëria jonë i prodhoi që në lashtësi (u shkrua në Kanunin e Lekë Dukagjinit), në kohën që u mundësuan që dijet shqiptare të bëhen legale. Shkolla e re moderne shqiptare duket sikur u ka ndenjur larg dhe ka hezituar t'i pranojë këto dije. Sipas shkencëtarëve të universitetit të Berkeley të Kalifornisë menaxhimi i burimeve natyrore nuk është një shpikje moderne. Ka departamente të veçanta që studiojnë e argumentojnë rëndësinë e dijeve nga popullsi vendore që u larguan kur evropianët i pushtuan territoret e tyre. Nga kërkimet rezulton se njerëzit vendës kudo në glob, ashtu si edhe malësorët tanë, kanë praktikuar rrënjët e kësaj disipline të aplikuar për mijëvjeçarë. Peizazhet e globit, që shoqëria njerëzore i trashëgon sot, janë një pasqyrim i proceseve historike, si natyrore ashtu edhe kulturore, mbajnë një gjurmë të pashlyeshme të një morie të teknikave të menaxhimit. Themelet e menaxhimit të bimëve dhe kafshëve të komuniteteve vendore përbëjnë një depo kolektive të njohurive rreth botës natyrore, depo që është e mbushur si një arkivë gjigande gjatë qindra vitesh nëpërmjet përvojës së drejtpërdrejtë dhe kontaktit me mjedisin. Kjo njohuri sot është rënë dakord të njihet me emrin "njohuri tradicionale ekologjike". Gjeneratat që tashmë i quajmë të parët tonë, jo vetëm arritën ti njohin e vlerësojnë, por qenë ndër të paktët në Evropë që na i lanë të shkruara.

–Nëse ke vullnet, gjithnjë do të kesh një rrugëdalje. A ka vullnet, sipas jush, për të kapërcyer gjendjen e krijuar në shfarosjen e pyjeve?

-Që të jem i sinqertë me juve kjo pyetje më duket e vështirë dhe unë nuk guxoj t'i jap vetes atributin e vënies në peshore të vullnetit. Pylli ynë natyror është deklaruar i përfunduar, i vdekur, apo në prag të përfundimit të materialit drusor me të cilën deri tani ka furnizuar shoqërinë tonë. Gjeneratës tonë i takoi që të ishte dëshmitare e mbylljes për shoqërinë shqiptare të stadit të shoqërisë grumbulluese. Pra që të shkosh në pyll dhe të marrësh atë që pylli ta ka përgatitur e ta jep të gatshme. Ne shkatërruam pyjet dhe është koha të reflektojmë pasi sistemi që po e përcjellim është i vetmi sistem që natyra e ka pajisur me një veçori, që i mungon si bujqësisë, ashtu edhe të gjithë sistemeve të tjera që kontribuojnë për njerëzimin. Sistemi i pyllit natyror e siguron ushqimin dhe energjinë e tij, brenda përbrenda vetes, duke u mundësuar dhurata të pafundme qenieve të tjera. Të gjitha sistemet e tjera varen nga energji të importuara, të cilat janë të parinovueshme, dhe ndërsa vihen në punë nga njerëzimi shkaktojnë ndotje të planetit e rrezik për jetën. Unë jam i sigurt që situata në të cilën janë aktualisht pyjet, i ka bërë të ndjeshëm jo vetëm banorët e zonave rurale, por çdo njeri që kontakton nga media apo e sheh me sytë e tij situatën. Kjo gërryerje e jetës së maleve, në të gjitha kuptimet, është thirrje e që na vë para dilemës: ta lemë të vazhdojë shkatërrimi, duke u pakësuar hapësirën e jetës gjeneratave të ardhshme, apo të gjithë së bashku t'i kërkojmë e t'i gjejmë shtigjet për të rikthyer jetën në malet tona. Të kthehemi edhe njëherë në esencën e problemit. Ka një sensibilizim që shprehet me një ligj që ka shpallur moratoriumin për aktivitetet e shfrytëzimit të pyllit për qëllime tregtare. Ka edhe një treg krejt të boshatisur, që për çdo vit duhet të mbushet me rreth dy milionë metër kub dru për ngrohje. Kjo fjali i ngjan një medalje me dy anë: tregtarët janë të ndaluar të marrin material nga pylli, e nga ana tjetër tregu ka një kërkesë të lartë për dru zjarri. Cila mund të jetë zgjidhja? Ka shumë vite që edhe në Shqipëri është prodhuar, nëpërmjet kultivimit, veçanërisht në zonat tona fushore, në formën e brezave mbrojtës si në fushën e Korçë-Devollit në formën e brezave mbrojtës nga përmbytjet apo edhe në fushat e pjesë perëndimore të Shqipërisë. Janë tetë lumenj që e përshkojnë dhe shpesh e përmbytin tokën bujqësore, me gjithë prodhimet në fushën perëndimore, por edhe në fushat e Korçës e Devollit. Bashkimi Evropian ka strategji e objektiva sfiduese për të shtuar prodhimin e biomasës dhe të zëvendësojë naftën e fosilet e tjera ndotëse të mjedisit me biomasë druri i cili, kur është në rritje, e thith të gjithë gazin karbonik që çlirohet kur ajo digjet e prodhon energji të quajtur "e rinovueshme".

-Muaji dhjetor është konsideruar si "muaji i pyjeve". Kujtohet kush për ta shpallur dhjetorin si periudhë për mbjelljen e fidanëve pyjorë?

-Këto ditë pritet që qeveria të shpallë zyrtarisht një fushatë të madhe për të mbjellë brenda këtij viti mbi 20 milionë fidanë pyjorë. Është një shifër goxha e mirë, por e keqja është se deri më tani nuk është prezantuar ndonjë plan veprimi. Dhe meqë jemi në kohën e duhur për mbjelljen e fidanëve pyjorë më duhet të tërheq vëmendjen për diçka të rëndësishme. Aktualisht ka shumë eksperienca evropiane që kultivohen drurë me rritje të shpejtë siç është plepi apo shelgu. Ata janë me cikle të shkurtra shfrytëzimi. Pra në një kohë relativisht të shkurtër japin prodhim të bollshëm të energjisë, duke realizuar edhe mbrojte të brigjeve të lumenjve nga përmbytjet, pastrimin e tokave që ndoten nga derdhja e ujërave të zeza në anë të qyteteve të mëdha si Tirana, Fieri etj. Por ka edhe rritje të kërkesave të biznesit, veçanërisht për lëndën e drurit të plepit për arka amballazhi për prodhimet bujqësore. Pra, sado i gjatë që duket "tuneli", një shkëndijë në fund të tij ndjehet se mund të jetë shpresëdhënës. Se sa do jetë inercia e shoqërisë tonë për të kaluar nga stadi i grumbullimit në atë të prodhimit, do jetë koha ajo që do ta tregojë.

–Bota u përket atyre që digjen, jo atyre që ngrohen! Jeni edhe ju në një mendje me këtë sentencë të thënë nga populli lidhur më përpjekjet që bëjnë teknikët dhe inxhinierët e pyjeve për t'i thënë "jo më" degradimit që po u bëhet pyjeve?

-Unë, në fakt, megjithëse jam koshient për atë që ka ndodhur, futem tek optimistët e pakorrigjueshëm, pasi vetë përvoja e jetës më ka dhënë privilegjin të njoh aftësitë e jashtëzakonshme të natyrës. Shqipëria e ka në prag të zhdukjes funksionin prodhues të pyjeve të lartë, që aktualisht zënë gati 1/3 e sipërfaqes së vendit. Por janë prezent në vendin tonë edhe pyjet e ulta dhe shkurret të cilat zënë rreth 2/3 e sipërfaqes pyjore. Por, duke qenë se përbëhen nga drurë e shkurre me dimensione të vogla, ne pylltarëve dhe dashamirësve të pyjeve të lartë (si ato që përshkruan Naim Frashëri) na duken siç i përshkruajnë shpesh kolegët tonë kosovarë si "kallamishte" dhe jo si pyll real, me të cilin jemi mësuar të krenohemi. Unë mendoj se pikërisht sipërfaqja e mbetur

Ike **Haki Kola,** ike mik i gjelbërimit dhe i luleve...


Elegji për një mik që as hasmi si zë pritë...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Ike Haki Kola, ike...
Nuk e besova shkronjën e nipit tënd, as edhe shkronjën nga Kanadaja që ma përcillte dhimbjen e tij për ta bashkuar me timen.
Nuk u besova...
Ishe i ri Haki Kola, i ri për tu ndarë nga jeta, nga njerëzit që të duan si dritën e diellit, nga gjelbërimi i pyjeve, lulet shumëngjyrëshe, nga pemëtaria që ti e deshe kaq shumë sa fidanët e tu mbushën kodrat dhe malet e Dibrës...
Ishe i ri Haki Kola.
Kurrë nuk kam menduar të vë në rresht shkronja me dhimbjen time për ty, kurrë.
Të kundërtën mendoja...
Ti të shkruaje për mua...
Nekrologjinë të ma bëje...
Ti njeriu me zemër të madhe sa lugina e Drinit dhe Nëntë Malet e Dibrës nuk e nxë.
Oh sa më dhemb ikja jote miku im!
Oh sa të doja që në këtë kohë të çmendur të natyrës të isha aty.
Me typër tu bindur se me të vërtetëi ke mbyllë sytë... Për tu bindur që lotët e njerëzve të tu të dashur, vëllezërve, motrave, fëmijëve, nipërve e mbesave, bashkëshortes tënde të dashur,janë të vërtetë, rrjedhin faqeve për tu mbledhur në një rrjedhë gurre mali.
Atëherë, dhe vetëm atëherë, do ta besoja se ti shpirtërisht nuk je banorë e kësaj bote.
Vetëm atëherë...
Do ditë më parë, kur po shkruaja për një mik të madh tëndin dhe timin, Miçurinin e Dibrës, Xhavit Hysën, të kërkova në adresën tënde për një fjalë nga ato të artat e gojës dhe penës tënde, fjalë që vetëm ti din ta gjesh e ta vesh në shpirtin e njerëzve.
Nuk mu përgjigje...
E si të përgjigjeshe kur ti luftoje me jetën, me sëmundjen që as shkencëtarët gjermanë nuk e nxorën dot nga trupi jot?
Kisha një thënie-përkushtim tënden diku në xhepat e kompjuterit.
E mora dhe e futa midis radhëve...
"Mrekullia e Xhavitit qëndron në faktin se asnjëherë nuk është shtirur si aktor që bën të jashtëzakonshmen. Së bashku me bashkëpunëtorët ai dha një model që tashmë Shqipërisë i mungon, të merret prodhim i qëndrueshëm nga kulturat drusore. Gjenerata e Xhavitit, me iniciator Xhavitin dhe kontribute juve personalisht, krijoi një model që sot bota po e kërkon. Ai funksionoi për disa dhjetëvjeçarë dhe në vitet '90 u shkatërrua në mënyrën më barbare..."
Edhe mrekullia jote Haki Kola qëndron në faktin se asnjëherë nuk je shtirur si aktor që bën të jashtëzakonshmen...
Edhe ti Haki Kola je një model që tashmë Shqipërisë i mungon...
Edhe ti Haki Kola me punën tënde në Shqipëri, Kosovë e më gjerë, krijove një model që bota e kërkon...
Ai funksionon, ani se tash disa dhjetëvjeçarë u shkatërrua në mënyrën më barbare...
Më dhëmbi shumë ikja jote mik, shumë...
Në Dibër ka një fjalë...
Dhimbjen ia vunë drurit,
e thau.
Dhimbjen ia vunë gurit,
e çau.
Dhimbjen ia vunë njeriut,
e mbajti...
Unë po e mbaj miku im,
e rëndë për shpatullat e mija...
Je në kujtesën time,
je në shpirtin tim,
sa të rroj,
sa jetë të kem...
Lamtumirë HAKI KOLA,
Dibrani me germa kapitale...
Një ndër BURRAT e mëdhenj të saj...

Athinë, 8 maj 2020

JETËSHKRIM



Prof. Haki Kola u nda nga kjo botë më 7 maj 2020, në moshën 67 vjeçare. Ai kishte disa vite që luftonte me një sëmundje të rëndë, të cilën fatkeqësisht e humbi.

Prof. Haki Kola u lindu më 12 Tetor 1953, në Dibër. Shkollën 8-vjeçare dhe gjimnazin i kreu në qytetin e Peshkopisë. Është diplomuar në Fakultetin e Pyjeve në vitin 1977. Ka punuar në Stacionin Bujqësor të Peshkopisë, ku kryesisht kontributi në studimet për sistemimin e tokave të pjerrëta të zëna me pemë frutore.

Në vitin 1994 është angazhuar për një projekt pilot për pyjet komunale nga ish- Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, i cili më vonë u pranua si komponent i projektit Shqiptar të Pyjeve të financuar nga Banka Botërore. duke ushtruar detyrën e Drejtorit të Njësisë së menaxhimit të projektit Shqiptar të Pyjeve. Në periudhën 1998-2004, Prof. Haki Kola ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Njësisë së menaxhimit të projektit Shqiptar të Pyjeve, projekt i cili në vitin 2005 fitoi Medaljen e Artë, për rezultate të larta në angazhimin e komuniteteve në menaxhimin e pyjeve afër qendrave të banuara.

Në vitin 2006 është angazhuar për 6 muaj si këshilltar në zbatim të një projekti pyjesh të BE në Kosovë. Në periudhën 2009 -2012 ka punuar si udhëheqës i ekipit zbatues të projektit të SNV për Menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve private dhe atyre të decentralizuar në Kosovë. Nga viti 2012 ka ushtruar detyrën e drejtorit të CNVP Kosovë. Nga viti 2017 e në vazhdim është anëtar i stafit të CNVP Shqipëri me qendër në Tiranë ku punon si këshilltar për agropylltarinë dhe pyjet komunale. Ai ka drejtuar Federatën Kombëtare të pyjeve e Kullotave komunale të Shqipërisë në periudhën 2006-2009. Prof. Haki Kola ka disa botime në revista shkencore ndërkombëtare. Ka organizuar një simpozium të IUFRO në Shqipëri, ku kanë marrë pjesë studiues nga Europa Lindore, Azia e Japonia. Që nga viti 2017 e në vazhdim është anëtar i Bordit për projektet e vogla për lehtësimet globale mjedisore (GEF Albania). Ing. Haki Kola mban titullin Profesor në fushën e shkencave pyjore.

Për punën e tij në vite është vlerësuar nga kolegë dhe institucione. Për kontributin e tij në zhvillimin e pyjeve në rajonin e Belshit, Bashkia e ka dekoruar me titullin "Qytetar Nderi".

Më poshtë po ju paraqesim një intervistë të tij dhënë dy vite më parë gazetarit Bashkim Koçi, përgatur për botim nga Abdurahim Ashiku, në shenjë nderi dhe respekti për Haki Kolën që iku pa e vënë në zbatim ëndrrën për një pylltari të kohës në të gjithë hapësirën e Shqipërisë dhe Kosovës.



me mbulesë shkurre apo pyll të ulët, është pylli që është përdorur nga të parët tanë që kur ky vend ka filluar të banohet nga qeniet njerëzore. Janë formacione më të pastudiuara e të nënvleftësuara nga shkenca e re pyjore shqiptare, megjithëse mbulojnë kodra, shpate e lugina me potencial ekologjik prodhues më të lartë se sa ne jemi të informuar deri më tani. Meqenëse e nisa me më të voglin vëlla të Rilindësve tanë të mëdhenj, tani mundem besoj të kaloj tek një këshillë që i madhi Sami Frashëri e jep në librin "Shqipëria çka qënë, ç'është e ç'do të bëhet", botuar ne vitin 1899, kur Shqipëria ishte akoma nën sundimin otoman.***"Pas diturisë,*** kështillon Samiu***, kujdes' e shqipëtarëvet e m'e madhe nevoj' e tyre do të jetë përpunërat' të përgjithçime, të cilatë do të sjellinë begati e pasje të madhe në Shqipëri. Udhëtë, udhët' e hekurta, limanetë, të hapurit' e lumenjet e kënetave, metaletë, pyjetë etj, janë më të nevojshimet' e më të vyerat' e punëravet, që dotë bënjë Shqipëria, me të pasurë duart' e këmbëtë xgjidhurë"*** Dhe më pas kollosi i Rilindjes shqiptare vijon me rekomandime mbi praktikat më të mira për menaxhimin e mbulesës pyjore: ***"Çdo pyll do të ndahetë me disa ngastra edhe, gjersa të vinjë radha të pritetë ngastr' e funditë, gastra q'u pre të parenë herë, do të jet' e arrirur për sërish; e kështu gjithnjë do të pritete lëndë nga pyjet edhe kurrë pyjetë do të mos mbarohenë, po do të përsëriten' e të jenë kurdo të lulëzuarë.:***

Nuk ka nevojë për komente rekomandimi shkencor i dhënë nga shqiptari largpamës e kolos i dijeve, Sami Frashëri.

– Sipas opinionit të njerëzve pyjet kanë pësuar dëmtime ndoshta të pariparueshme. Cili është mendimi juaj si një nga specialistët më me zë në fushën e pylltarisë?

– Unë jam i mendimit, por edhe shpresëplotë, që mund të përmbyset gjendja e krijuar. Shembull, i cili shihet me sy e preket me dorë, është ai i ri ngritjes së pyjeve në zonën e Dumresë. Nga ç'ishte dhe ku është. Vërtetë është e pabesueshme. Për të treguar këtë realitet është përgatitur edhe një film dokumentar të titullur "Nga shkretëtira në park", përgatitur nga gazetari i mirënjohur Fuat Memeli. Me pak fjalë rikthimi i pyllit të Dumresë, e cila të mahnit nëse e krahason me gjendjen ku ishte katandisur disa vite më parë, është një fakt që të ngjall shpresën për ringjalljen e pyjeve, tashmë të shkatërruara. Ajo që po vijojmë të bëjmë në Dumre është që, në bashkëpunim me Bashkinë e Belshit e Fakultetin e Shkencave Pyjore, të eksperimentojmë atë që na këshilloi Sami Frashëri 119 vite më parë, që pylli të ndahet në pjesë, dhe kur të kemi prerë pjesën e fundit të jetë rritur dhe të jetë gati për prerje pjesa e parë. Krahas ringjalljes së pyjeve të ulta, që ishte rezultat i financimeve nga donatorët, por edhe i mbështetjes së jashtëzakonshme të komuniteteve, unë kam besim qe e njëjta gjë është e mundur edhe për formacionet me shkurre, ku me trajtim sistematik e marrëveshje me banorët vendas, prodhimi vjetor brenda një dhjetëvjeçari mund të shumëfishohet, duke u dhënë jetë kodrave e sipërfaqeve në zonat e ulta. Dua të them këtu dy fakte që dikujt do t'i duken të pabesueshme: Nga inventari kombëtar i pyjeve, në vitin 2004 volumi drusor i një pylli në një hektar me shkurre, si mesatare ka rezultuar në 0.46 m3/hektar. Ilia Mitrushi në librin "Drurët e shkurret e Shqipërisë" dëshmon se një hektar me shkurre të maresë e ka potencialin të prodhojë deri në 150 metër kub dru për hektar, duke e prerë me metodën e rekomanduar nga Sami Frashëri në çdo 15 vite. Secili mund të llogarisë se sa potencial të papërdorur kemi tek shkurret. Ky është potencial që vendi ynë duhet të fillojë ta shfrytëzojë sa më shpejt të jetë e mundur, duke filluar vitet e para në formë eksperimentale, nën përkujdesjen e Fakultetit të Shkencave Pyjore. Kam shume besim që për të filluar këtë projekt do gjejmë përkrahje nga Bashkia Tiranë, e me rezultatet që do të demonstrohen do tërhiqet vëmendja e të merret përkrahje financiare nga projektet IPARD të BE-së. Kjo mund të kthehet edhe si një shkollë shqiptare se si transformohen ekosistemet e degraduara në pyje me prodhimtari të lartë në cikle të shkurtra kohore.

-Kam bindjen se ka goxha specialist apo mbarështues të pyjeve, por duke parë që zërin e tyre nuk e dëgjon kush, ata ndjehen të lodhur, të zhgënjyer për çka kërkojnë. Mendimi juaj?

-Unë i besoj idesë që, nëse në shkallë vendi e fillojmë nismën për përmirësimin e shkurreve të degraduara, për të gjithë kolegët, përfshirë edhe studentët e pedagogët, do të hapet një "autostradë" me punë e që do jetë shumë frytdhënëse për t'i ndryshuar pamjen vendit, me ekonomi të mbështetur tek e gjelbra e përjetshme që mund të zëvendësojë naftën e qymyrin e gurit.

– Demokracia nuk vjen vetëm kur voton i lirë. Demokracia e vërtetë vjen kur njerëzit marrin pjesë në menaxhimin e pasurive të tyre të përbashkëta, siç janë pyjet. Mund të sillni argument për këtë çka po them?

-Pyetja që ju keni formuluar koincidon me fjalën që i ndjeri ish ambasadori amerikan Limpreht, i tha në ish komunën e Bubqit një ish- ministri të Bujqësisë. Unë do të shtoja që jo vetëm pyjet, por menaxhimi i të gjitha burimeve natyrore që i ka dhuruar natyra vendit tonë duhet të kenë pjesëmarrjen e komuniteteve, çka u përpoqa të ilustroj me rastin e pyllit të rilindur jo vetëm në Dumre, por edhe në Ulëz, Bulqizë, Zerqan, Peshkopi e kudo ku komuniteteve u është deleguar një e drejtë e tillë.

Analizë kritike e jetës dhe veprës së Skenderbeut

Epoka e Gjergj Kastriotit,
bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare



Nga Dr ENVER HALILI
Melburn, Australi

(vijon nga numri i kaluar)

3.1.2 Themelimin e Kuvendit si institucion fundamental shtetëror

Themelmin e *'Instituticionit të Kuvendit'* i cili është bazament juridik mbi të cilën ngrihet shteti është i një sukses tjetër i jashtëzakonshme e veprës së Kastriotit. Mënyra se si Skënderbeu iu qas thirrjes dhe organizimit të Kuvendit të Lezhës tregon se ai ishte jo vetëm një strateg i shkëlqyer ushtarak por edhe një arkitekt edhe ndërtues i përkryer i shtetit parlamentar. Bisedat paraprake me princat arbëror, shtruarja e çështjes së ndërtimit të shtetit dhe analizimi i rrethanave të brendshme e të jashtme tregojnë për një vizion largpamës i cili rezultoi me krijimin e Mbretërisë Arbërore. Atmosfera e tolerancës dhe e mirëkuptimit në mes të princave po ashtu ishte një faktor shumë i rëndësishëm e cila i siguroi sukses të plotë vendimeve të Kuvendit historik të Lezhës (Kristaj, 2018).

Krijimi i "besë-lidhjes kombëtare" në Kuvendin e Lezhës do bëhet model për patriotët shqiptarë të periudhave të mëvonshme për thirrjen e Kuvendeve Kombëtare në të cilat do marrin vendime për organizimin kulturor, politik dhe ushtarak me qëllim që të mbrohet atdheu. Të gjitha kuvendet kombëtare të mbështetura në parimet kombëtare të shtruara në Kuvendin Lezhës dhanë suksese të jashtëzakonshme për popullin tonë pavarësisht vështirësive dhe rreziqeve në të cilat organizoheshin.

Duke ndjekur rrugën e Kastriotit, patriotët e Rilindjes Kombëtare më 10 Qershor 1878 organizuan një Kuvend në Prizren dhe më 1899 një tjetër Kuvend në Pejë për të vendosur për fatin e Shqipërisë. Ashtu si Gjergj Kastrioti në Kuvendin e Lezhës, po ashtu edhe Abdyl Frashëri në Kuvendin e Prizrenit do të ligjërojë para krerëve të krahinave shqiptare duke elaboruar ndryshimin e rrethanave në Ballkan dhe Europë pasi që Perandoria Osmane tani më ishte kalbur dhe një rrezik i madh i kanosej atdheut tonë. Duke ndjekur qëndrimet politike të Komitetit të Stambollit (Rizvanolli, 2005), A. Frashëri shpalosi platformën e luftës për çlirimin e atdheut dhe krijimit të shtetit shqiptar i cili do të mbulonte të gjitha trojet shqiptare të ndara në katër njësi administrative të njohura si Vilajetii Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës.

Kuvendarët shqiptarë në Prizren ia bënë me dije forcave të errëta Europiane të mbledhura në Berlin (13 qershor-korrik 1878) se Shqipëria është vendi i Gjergj Kastriotit dhe ata duhet t'i marrin në konsideratë kërkesat e tyre. Sami Frashëri potenconte se shqiptarët kanë lidhë 'besë' dhe do luftojnë deri sa të çlirojnë atdheun e tyre (Frashëri, 1878). Në Kuvendin e Prizrenit patriotët shqiptarë arritën të krijojnë shtetin me ushtrinë kombëtare dhe shumë departamente shtetërore të cilat operuan deri në vitin 1881. Vendimet e Kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit krijuan një bazë të fortë mbi të cilin do të themelohet dhe ngrihet Shteti Shqiptar në Kuvendin e Vlorës, më 1912.

Në shekullin e njëzet do të mbahen shumë kuvende por vetëm ato kuvende kombëtare të mbështetura në mësimet e Kastriotit dhe Rilindjes Kombëtare do të jenë të suksesshme dhe do të vejnë vulë të pashlyeshme në historinë tonë siç është Kongresi i Alfabetit më 1908 në Manastir, Kuvendi Vlorës më 1912, Kongresi i Lushnjës më 1920, e tjera. Pastaj do të mbahen edhe Kuvende të tjera pas Luftës së II Botërore në frymën e kombëtare por Kuvendet të cilat do të mbesin në kujtesën e historisë kombëtare siç janë Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës në vitin 1974, më 2 Korrik dhe 7 shtator të vitit 1990 dhe më 17 Shkurt të vitit 2008. Fatkeqësisht, gjatë kësaj periudhe pati edhe Kuvende në të cilat nuk arritën qëllimet kombëtare siç është rasti me dështimin e Kuvendit të Mukjes dhe disa kuvendeve të tjera.

Populli shqiptar nën udhëqjen e mendjeve të ndritura të Rilindjes të bazuar në mësimet e Kastriotit që nga Qershori historik i Prizrenit nuk do të pushojnë kurrë. Rilindësit tanë të mëdhenj do të luftojnë të bashkuar në të gjitha frontet për arritjen e qëllimit final. Më në fund me 28 Nëntor 1912 sikurse Kastrioti e A. Frashëri, mendjendrituri Ismail Qemali do të thirrë Kuvendin Historik në Vlorë, të shpallë Pavarësinë e Shqipërisë dhe do të formojë shtetin kombëtar. Rrugëve të Vlorës heroike për herë të parë do të marshojë Garda e Parë Kombëtare me plisa të bardhë nën komandën e kryekomandantit Isa Boletini. Garda Kombëtare ishte institucioni i parë ushtarak i shtetit të ri shqiptar, i cili me pushkë në dorë do të mbrojë pavarësinë e shpallur dhe lirinë e vendit. Edhe pse Kuvendi i Vlorës shpalli pavarësinë e Shqipërisë, rruga drejt finalizimit të shtetësisë qe e gjatë, me shumë mundime dhe plot rreziqe.

Në vitet më kritike për popullin dhe shtetin shqiptar, atëherë kur vendet vendim-marrëse të Evropës nën presionin e Rusisë po bëheshin gati ta miratonin planin e djallit për shthurjen e shtetit shqiptar dhe ndarjen e tokave tona në mes grabitqarëve greko-sllave, patriotët shqiptarë të inspiruar nga mësimet e Kuvendit të Lezhës dhe Kuvendit të Prizrenit do të organizojnë Kongresin e Lushnjës, më 1920.Vendimet e Kongresit çuan deri te finalizimi i shtetësisë së Shqipërisë (politike) e cila perfundimisht do të sanksionohet në Konferencën e Parisit dhe Londrës. "Kongresi i Lushnjës dhe përpjekjet e gjakta të Vlorës kurorëzuan veprën patriotike duke proklamuar botërisht dhe me bujë vullnetin e kombit.... Pas atyre ngjarjeve Konferenca e Paqës më nuk guxoi të vërë në bisedim cënimin e këtyre të drejtave" (Frashëri, 1920). Kuvendi i Lezhës do t'u japë zemër patriotëve shqiptarë gjatë të gjitha periudhave të mëvonshme. Në katrahurën e viteve të luftës së Dytë Botërore patriotët shqiptarë të udhëhequr nga Xhafer Deva, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Asllan Boletini, Musa Shehu, e të tjerë organizuan përsëri një Kuvend në Prizren në shtator të vitin 1943 (Hoti, 2005). Qëllimi kryesor i Lidhjes së II të Prizrenit ishte mbrojtja dhe çlirimi i të gjitha trojeve shqiptare nga pushtuesit fqinjë dhe bashkimin e tyre në një shtet të përbashkët.

Në vitet e mëvonshme përsëri do të organizohen edhe shumë mbledhje e kuvendime nga patriotët shqiptarë për të çliruar trojet e pushtuara shqiptare nga okupatori serb. Vendime të rëndësishme u morën nga Kuvendi i Kosovës më 1974 të cilat erdhën si rezultat i këndelljes së faktorit shqiptar pas tundjes së fortë që bënë Demonstratat e vitit 1968 nën udhëheqjen e heronjve të Kosovës Metush Krasniqit e Adem Demaçit. Në vitin 1974 Kosova arriti një avancim substancial të statusit kushtetues duke u bërë element konstituiv në Federatën Jugosllave. Ndryshimet pozitive juridike dhe ligjore sollën një zhvillim epokal të paparë ndonjëherë në historinë tonë.

Në periudhën më kritike për popullin shqiptar të pushtuar nga serbo-sllavët, atëherë kur krijesa artificiale jugosllave po shpërbëhej dhe Serbia gjakatare po bëhej gati për shthurjen e shtetësisë së Kosovës patriotët shqiptarë të inspiruar nga mësimet e Kuvendit të Lezhës, Kuvendit të Prizrenit, Kuvendit të Vlorës, e të tjerë do të organizojnë mbledhje historike të Kuvendit të Kosovës më "2 Korrik 1990" në Prishtinë dhe më "7 Shtator 1990" në Kaçanik.

Vendimet e Kuvendit të Kosovës të marra më 2 Korrik 1990 (ku Kosova shpalli pavarësinë nga Federata Jugosllave) dhe më 7 Shtator të vitit 1990 (ku u aprovua Deklarata Kushtetuese e Shtetit të Pavarur të Kosovës) u kurorëzuan me çlirimin e Kosovës në Qershor të vitit 1999 dhe shpalljen e Pavarësisë më 17 Shkurt 2008. .Pa dyshim, rol vendimtar në arritjen e suksesit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës e paten aktivitetet politiko-diplomatike të udhëhequra nga Dr. Ibrahim Rugova dhe pushka e luftëtarëve të UÇK-së, e koordinuar me operacionet ushtarake të NATO-s, të organizuar nga Shtetet Perëndimore dhe vendet tjera demokratike anë e kënd globit, të udhëhequra nga SHBA-ja.

Bazuar në këto diskutime shihet qartë se të gjitha kuvendet shqiptare të cilat u organizuan mbi bazën e Doktrinës Kombëtare të parashtruar nga Gjergj Kastrioti dhe të ripërtrirë nga Rilindja Kombëtare dhanë rezultate dhe quan përpara çështjen shqiptare. Por fatkeqësisht gjatë historisë sonë pati raste kur u organizuan kuvende të cilat iu shmangën bazamentit kombëtar dhe ato çdo herë dështuan. Shembulli me eklatant është dështimi i Kuvendit të Mukjes i vitin 1943. Kuvendi i Mukjes ishte inicuar dhe udhëhequr nga Mid'that Frashëri ku morën pjesë grupet me orientim të ndryshëm politik duke përfshirë Ballin Kombëtar, Legalitetin dhe Fronti Nacional Çlirimtar (FNÇ). Kuvendi i Mukjes ishte rezultat i bashkëpunimit të forcave progresive patriotike shqiptare të udhëhequra nga M. Frashëri dhe krahu demokratik brenda FNÇ (A. Kupi, Y. Dishnica, M. Peza, e të tjerë). Kuvendi vendosi krijimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë me vështrim të posaçëm çlirimin e Kosovës dhe Çamërisë.

Por lidershipi komunist i hutuar nga platforma ideologjike e cila nuk kishte preokupim çështjen kombëtare dhe nën presionin e mentoreve sllave si Milladin Popoviqi, Dushan Mugosha e kriminel të tjerë shkelën vendimet e shenjta të Kuvendit të Mukjes dhe sollën realizimin e interesave të shovinistëve fqinje (Shatri, 2005). Komunistët shqiptar luajtën rolin e Kolit të Trojës duke i hapur derën elementit serbo-sllave të përzihet në vendimmarrje të çështjes shqiptare. Komunistët shqiptarë zbatuan 'doktrinën bolshevike të luftës permanente civile' (Courtois et al. 2004) duke e terrorizuar dhe likuiduar pjesën më vitale të popullit, familjet patriotike dhe shkollarët shqiptarë. Shkelja e vendimeve të Kuvendit të Mukjes mundësoj implementimin e pushtetit komunist në Tiranë, varrosi çështjen e Çamërisë dhe Kosovës dhe shkaktoi plagë katastrofale për kombin tonë të cilat edhe sot e kësaj ditë kullojnë gjak. Kuvendi i Mukjes do të jetë kujtesë e një katrahure të dhimbshme gjysmëshekullore brenda dhe jashtë kufirit shtetëror shqiptar.

Duke u mbështetur në këto argumente historike, lirisht mund të potencohet se Skënderbeun e Kuvendin historik të Lezhës vuri themelet e shtetësisë shqiptare të cilat u nguliten thellë në mendjen e popullit tonë. Prandaj, parlamentarët dhe shtet-ndërtuesit shqiptarë në Tiranë, Prishtinë, Shkup dhe viset tjera e kanë obligim historik të shfrytëzojnë mandatet e tyre parlamentare për të ndërtuar shtete dhe qeveri funksionale të cilat u shërbejnë interesave të popullit ashtu siç vepruan Princat Arbëror nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Parlamentarët shqiptar e kanë obligim kombëtar t'i shfrytëzojnë mandatet e tyre në Kuvend për të ndërtuar shtetin shqiptar të bazuar në Doktrinën Kombëtare të Kastriotit. Një shtet kombëtar do të sigurojë një zhvillim ekonomik dhe do të mundësojë një zhvillim të përgjithshëm arsimor, shëndetësor dhe kulturor shqiptar. Shtet-ndërtuesit shqiptar duhet të punojnë "ditë e natë" që ta rikthejnë prestigjin e vendit tonë në Europë e më gjerë ashtu siç ishte dikur emri i mirë i shtetit të Kastriotit sepse Shqipëria e ka vendin në Perëndim dhe jo në Linje, siç kështillonte Naimi ynë i Madh. Prandaj, mund të konkludohet lirisht se Gjergj Kastrioti dhe Vepra Epokale e tij vendosi "**Themelet e Shtetësisë Shqiptare!**

3.1.3 Krijimi i Shtetit Shqiptar

Vepra e Gjergj Kastriotit do të shndërrohet në një lokomotive të fortë për patriotët shqiptarë dhe shteti arbëror do të shërbejë si një model për shtetformuesit dhe shtetndërtuesit shqiptar gjatë historisë sonë. Udhëheqësit shqiptar ndër breza si Ali Pashë Tepelena, Balshajt e Shkodrës, Abdyl Frashëri, Haxhi Zeka, Ismail Qemal Vlora, Mreti Zogu I, Dr. Ibrahim Rugova, e shumë të tjerë, duke ndjekur shembullin e Kastriotit u vunë në ballë të lëvizjeve patriotike me qëllim të çlirimit të vendit dhe krijimit të shtetit kombëtar.

Epoka e Rilindjes Kombëtare është periudha me ndritshme e historisë së re të popullit tonë. Rilindja Kombëtare arriti të rindërtojë bazën e pathyeshme mbi të cilën do të përtërihet vetëdija kombëtare dhe shtetërore shqiptare sipas Doktrinës te Kastrioti. Sikur dikur ftesës së Gjergj Kastriotit, po ashtu edhe thirrjes së Abdyl Frashërit më 10 Qershor 1878 iu përgjigjën krerët shqiptarë nga të gjitha krahinat që të kuvendojnë në Prizren. Delegatët prej të gjitha anëve u mblodhën në Kuvendin e Prizrenit, diskutuan kokë më kokë dhe vunë themelet e Shtetit Shqiptar. Qëllimi i shtetit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte të çlirohej vendi nga zgjedha shekullore osmane dhe të mbronte tërësinë tokësore shqiptare nga grabitqarët fqinje. Lidhja Shqiptare e Prizrenit pati një shtrirje territoriale mbarëshqiptare dhe u bë boshti kurrizor i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ajo themeloi një front te përgjithshëm kombëtar, pavarësisht përkatësisë fetare, dhe dallimeve shoqërore, apo krahinore.

Që nga viti 1878 populli shqiptar do të veprojë pa ndërprerë në të gjitha frontet, atë arsimor, politike, diplomatike dhe ushtarake me qëllim që të realizohet porosia e Kastriotit. Më në fund patriotët shqiptar me Ismail Qemalin në krye me sakrifica të mëdha arritën që më 28 Nëntor të vitit 1912 të shpallin Shqipërinë "shtet në vete e të mosvarme". Pas 469 viteve luftë e përpjekjeve titanike sidomos që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878, në Vlorë u arrit të shpallet shteti shqiptar i pavarur i cili u ngrit mbi themelet e veprës së Kastriotit. Patriotët shqiptar duke u bazuar në shembullin dhe mësimet e Skënderbeut vazhdimisht luftuan dhe punuan që Shqipëria të zë një vend të merituar në mesin e shteteve të Evropës Perëndimore.

Patriotët shqiptarë në shekullin 19 dhe të 20, në rrugën e tyre të shenjtë për ndërtimin e shtetit kombëtar duhej të luftonin jo vetëm kundër pushtuesve osmanë, por edhe kundër fqinjëve grabitqare. Për shkak të orekseve pushtuese të serbëve dhe grekëve si dhe pazareve të osmanllijve me Rusinë, dhe dredhive të disa shteteve europiane kjo fitore arriti të krijojë një Shqipëri të sakatosur. Kështu që jashtë kufijve të shtetit shqiptar mbetën shumica e territorit dhe popullit tonë.

Fatkeqësisht edhe pse Shqipëria u shpall shtet i pavarur më 1912, rruga e ndërtimit të një shteti kombëtar qe e gjatë, u dashtë të derdhet shumë gjak dhe të bëhen sakrifica te jashtëzakonshme që shteti shqiptar të mbijetoj. U dashtë të bëhen shumë punë dhe përpjekje diplomatike që të binden kancelaritë europiane, që Shqipëria të pranohet si shtet anëtar në Lidhjen e Kombeve. Vetëm kur patriotët shqiptarë u mblodhën në Kongresin e Lushnjës më 1920, Europa arriti të bindet për këmbëngultësinë e shqiptarëve dhe më në fund hapi derën për Shqipërinë. Pas një odisejade tetëvjeçare më në fund u mbyll procesin e sendërtimit të shtetit shqiptar.

Pas vitit 1920 pati shumë luhatje (të gabuar dhe të panevojshme) deri sa më në fund shteti shqiptar arriti të konsolidohet dhe stabilizohet. Gjatë një periudhe 15-vjeçare të qeverisjes së Mbretit Zog u arritën suksese të jashtëzakonshme në shumë fusha si në arsim, edukim, kulturë, shëndetësi, ligjislacion, ekonomi, shtetndërtim e lëmi të tjera. Një ndikim të rëndësishëm pati sidomos Normalja e Elbasanit në përgatitjen e mësueseve për shkollimin dhe emancipimin e popullit tonë. Ministria e Arsimit gjithashtu luajti një rol historik duke u ndarë bursa studenteve shqiptar që ata të shkollohen në qendrat e ndryshme universitare të Europës dhe SHBA-së.

Shkollarët shqiptarë si Ernest Koliqi, Eqrem Çabej, Vasil Andoni, Ahmet Gashi, Ymer Berisha, e shumë të tjerë ishin të parët të cilët u kthyen në atdhe për të ndihmuar në arsimimin e popullit gjatë Luftës së II Botërore. Arsimtarët e asaj periudhe rol të jashtëzakonshemë luajtën sidomos në shkollimin dhe arsimimin e popullsisë në Kosovë e viset tjera shqiptare. Ata mësuan, edukuan dhe këshilluan popullin shqiptar që mos të humbasin kohë por të përgatiten për një luftë të fortë me ish pushtuesit serb. Fatkeqësisht stuhia e çmendur e nazifashistëve u hapi rrugë dhe lehtësoi realizimin e planeve sllavo-mëdha. Në emër të një lufte 'kundër boshtit' Perandoria Sovjetike arriti ta aneksojë një sipërfaqe të konsiderueshme të Europës dhe pushtoi tërë trojet shqiptare. Në vitin 1945 Europa Lindore dhe trojet shqiptare ranë nën thundrën mesjetare sllavo-komuniste. Sovjetët arritën ta instalojnë në Tiranë një pushtet të egër komunist i cili ia nxiu qiellin Shqipërisë për gjysmë shekulli. Plagët nga ajo diktaturë e çmendur kullojnë gjak edhe sot e kësaj ditë.

Pavarësisht rrethanave shumë të vështira të gjysmës së dytë të shekullit njëzet, lavdia e "28 Nëntorit" shtohej çdo herë. "28 Nëntorit" arriti të mbjellë thellë në mendjen, dijen dhe ndërdijen e popullit tonë konceptin e shtetit kombëtar. Edhe pse dhuna dhe presioni i pushtuesve gjatë historisë ishte shumë i vrazhdë, shqiptarët jashtë kufijve shtetëror çdo vit me krenari e festonin Ditëlindjen e Shtetit Shqiptar. Kështu, "Nëntori i viti 1968" në trojet shqiptare të pushtuara nga sllavët u shndërrua një lokomotivë të fortë për faktorin shqiptar. Duke i falënderuar vrullit të "Nëntori të vitit 1968" në vitin 1974, Kosova arriti një avancimin të rëndësishmen të shtetësisë në Federatën Jugosllave.

Rezultatet e asaj periudhe avancuan vetëdijen shtetërore shqiptare në një shkallë më të lartë e cila do t'u bëjë ballë sulmeve brutale serbe për më shumë se dy dekada deri sa arriti të realizojë qëllimin final. Rrallë mund të gjesh në histori ndonjë rast aq të suksesshëm të shtet-ndërtimit siç është rasti me shqiptarët këndej Drinit i cili për një periudhe kohore 20 vjeçare, do të krijoj një bazë të pathyeshme intelektuale, administrative dhe ekonomike. Kjo forcë kombëtare me sukses do të udhëheqë Kosovën drejt çlirimit dhe krijimit të shtetësisë në fund të shekullit të kaluar. Sukseset e asaj periudhe do të finalizohen me çlirimin e Kosovës në vitit 1999, Pavarësinë e saj më 2008 si dhe sanksionimin e kombit shqiptar si faktor vendimmarrës në Maqedoni, Luginën e Moravës, Mal të Zi e më gjerë.

Por pavarësisht se u arritën suksese të rëndësishme në krijimin e shteteve shqiptare përsëri mbetën edhe shumë punë për shtet-ndërtuesit shqiptarë që të ndërtojnë shtete efektive të cilat do t'u shërbejë interesave të popullit. Duke falënderuar vetëdijen kombëtare udhëheqësit shqiptarë arritën të çlirojnë vendi (Shqipërinë e Kosovën e sotme) dhe krijojnë shtete kombëtare. Por, mosarritja e eliminimit të divergjencave absurde në mes grupeve politike hapi rrugën për ndërhyrjen e të huajve në punët tona teë brendshme, e cila jo vetëm se shkaktoi stërzgjatje e kompletimit të pavarësisë së Kosovës, por gjithashtu krijoi terren për lulëzimin e joeffikasitetit, korrupsionit dhe krimit në shoqërinë tonë.

Por, për shkak të nivelit të ulët të vetëdijes shtetërore liderët tanë dështuan në procesin e ndërtimit të shtetit funksional. Mungesa e vetëdijes shtetërore nxori në shesh kompleksitetin e ndërtimit të shtetit. Dështimi ndërtimit të shtetit funksional e demokratik në Tiranë dhe Prishtinë (por edhe në viset tjera shqiptare) dëshmoj se për të ndërtuar shtet efektive demokratik nuk është i mjaftueshëm vetëm vullneti por në rend të parë është e nevojshme aftësia profesionale e shtet-ndërtuesve si në nivelin vertikal po ashtu dhe në atë horizontal. Shtet-ndërtuesit në Tiranë, Prishtinë, Shkup e viset tjera duhet të ndjekin shembullin e Kastriotit, patriotëve të Rilindjes Kombëtare dhe dëshmorëve të luftës çlirimtare dhe të krijojnë shtete funksionale e demokratik edhe të zbatojnë një strategji të përbashkët ekonomike kombëtare. Një shtet demokratik e funksional e meriton çdo popull por atë shtet më së shumti e meriton populli ynë sepse për të kanë kontribuar gjenerata të tëra ndër shekuj. Një shtet ligjor e demokratik i ngritur mbi bazën e strategjisë kombëtare do të arrijë të përmbyllë odisejaden mbi njëzet vjeçare të shtetësisë së Kosovës e cila gradualisht do të shkojë drejtë shkrirjes në një shteti unik kombëtar. →

Ky studim dokumenton se vepra e Kastriotit duke trasuar rrugët e lirisë dhe krijimin e shtetit shqiptar është përjetësuar në të gjitha periudhat historike të popullit shqiptar.

Duke u mbështetur në argumentet praktike ky hulumtim e vërteton hipotezën se Epoka e Gjergj Kastriotit është hallka kryesore e cila ndërlidh etapat e reja historike të popullit tonë me periudhën e mesjetës e cila gjithashtu ka rrënjët thellë në epokën iliro-pellazge. Mbi të gjitha Epoka e Gjergj Kastriotit është bazamenti mbi të cilën u krijua dhe u ngrit vetëdija shtetërore dhe kombëtare shqiptare. Andaj mund të konkludohet lirisht se Gjergj Kastrioti është "BABA I KOMBIT SHQIPTAR".

Një shtet demokratik i organizuar mbi principet e pluralizmit politik dhe ekonomisë së tregut të lirë do të mundësoi krijimin e një bazë materiale e cila do të mundësoi përparimin e mirëqenies njerëzore. Në një vend ku vepron konkurrenca e lirë në të gjitha poret e shoqërisë, vlerat e mirëfillta materiale dhe jo materiale do të kultivohen dhe më tutje zhvillohen dhe jovlera dhe joefikasiteti nuk do të kenë mundësi të zhvillohen. Tregu i lirë me dorën e vetë të bekuar në mënyrë të padukshme do t'i integroje potencialet ekonomike në formë racionale me qëllim që të maksimalizohen të ardhurat e investitorëve (Halili, 2013). Ajo ekonomi e cila arrin t'i maksimalizojë të ardhurat e investitorëve padyshim do të jetë konkurruese në treg dhe do të arrijë të absorbojë shuma të konsiderueshme të fondeve për financimin e projekteve të saj. Pa dyshim një rol të konsiderueshëm në zhvillimin ekonomik luajnë investitorët e jashtëm të cilët kërkojnë një infrastrukturë efektive ligjore dhe administrative. Operacionalizimi i kapitalit kombëtar dhe internacional mundëson krijimin e një ekonomie konkurruese në treg dhe popullit i siguron një të ardhme të mirë. Në të kundërtën, në atë vend ku është prezent konkurrenca jolojale aty krijohet mundësia e degjenerimit të shtetit dhe strukturave të tij në nivelin horizontal dhe vertikal. Në aso raste, antivlera ia zënë frymën vlerës dhe kuantiteti i mallrave dhe shërbimeve dominojnë në treg. Në rrethana të tilla tregu i lirë nuk mund të funksionojë dhe projektet zhvillimore nuk kanë mundësi të gjejnë fonde për shkak se investitorët hezitojnë ta alokojne kapitalin në një vend të tillë. Mos funksionimi i konkurrencës së lirë hap rrugë për lulëzimin e nepotizmit, familjarizimit, korrupsionit dhe krimit të cilat rrënojnë në rend të parë ekonominë por edhe segmentet tjera shtetërore. Mund të pohohet lirisht se sot joefikasiteti dhe korrupsioni janë kancer shkatërrues i ekonomisë së shteteve tona dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.

Vetëm konkurrenca e lirë mundëson jo vetëm mallrat dhe shërbimet me kualitet të lartë të dominojnë në treg por edhe kualiteti i lartë i fuqisë punëtore sidomos të forcës krijuese intelektuale të zhvillohet në një vend. Konkurrenca e lirë hape mundësinë për zhvillimin dhe kultivimin e vlerës dhe pamundëson depërtimin e antivlerës. Pa dyshim rolin kryesor në zhvillimin e ekonomisë së lirë dhe shoqërisë në përgjithësi e ka kapitali intelektual (Halili, 2013). Kapitali intelektual vendor është lokomotivë e ekonomisë dhe shtetit kombëtar. Kapitali intelektual mund t'i operacionalizojë me sukses të pesë llojet tjera të kapital, siç janë kapitali financiar, kapitali prodhues (manifaktural), kapitali human (fuqia punestore), kapitali social dhe kapitali natyror (Gleeson-White, 2014). Kombi ynë (brendi vendit dhe në diasporë) disponon me të gjitha llojet e kapitalit të potencuara më lartë. Unë këtij grupi të kapitaleve u kisha shtuar edhe pozitën e vendit ndaj tregut. Pozita udhëkryqe (lindje-perëndim dhe jug-veri) si dhe dalja në det i jep vendit tonë një përparësi të shkëlqyeshme ndaj tregut rajonal dhe më gjerë.

Kombi ynë disponon gati se më të gjitha llojet e kapitaleve e sidomos me kapitalin intelektual, financiar, natyror dhe pozitën e favorshme ndaj tregut të cilat janë faktorët kryesorë për një ekonomi të zhvilluar. Andaj është një absurditet ekstrem që populli ynë "të flejë mbi arin dhe të mos ketë ushqim të mjaftueshëm', dhe 'të flejë mbi gjithë ato burime energjetike (të ujit, erës dhe thëngjillit) dhe të mos ketë dritë"! Të gjitha këto resurse te kapitali e sidomos të kapitalit intelektual dhe financiar (me burim nga diaspora) premtojnë një zhvillim ekonomik dhe konkurrencë të fortë të produkteve dhe shërbimeve tona në treg. Andaj, për vendit tonë me gjithë këto begati sot o kurrë është e domosdoshme "një qeveri.. qe t'u hapte udhën e,... të vështrohet mire, ..., mund të vejë shumë mbarë e t'ushqejë katër herë më tepër njerëz se sa ushqen sot" (Frashëri, 1899, fq. 42).

Një qeveri e cila do të hapte udhe mundëson të krijohet një force kualitative intelektuale kombëtare dhe funksionalizimin e cila do të bëhet promotor i zhvillimit të ekonomisë së vendit. Një ekonomi e zhvilluar do të ndërtojë një bazë të fortë materiale dhe sendërton një zhvillim të gjithëmbarshëm shoqërore. Baza materiale në fakt është determinanta kryesore e vetëdijes njerëzore qoftë asaj individuale apo kolektive të një vendi apo kombi. Domethënë, nëse ne si komb arrijmë ta krijojmë një ekonomi efektive dhe të zhvilluar ajo do të na ndihmojë të ndërtojmë një bazë të qëndrueshme materiale dhe do të ngrejë në një nivel më të lartë vetëdijen kombëtare të popullit tonë.

Një bazë e fortë materiale mund të arrihet vetëm atëhere kur një vend (komb) ndërton një strukture ekonomi të ekuilibruar në harmoni me shfrytëzimin racional të resurseve të saja njerëzore dhe natyrore në raport me kërkesat aktuale në tregu. Kështu projekteve të cilat shfrytëzojnë burimet vendore në harmoni me parametrat e tjerë ekonomik duhet t'u jepet përparësi, sidomos kur kemi parasysh një perspektive afatgjate potenconte profesori patriot Ismet Gusia në veprën e tij monumentale (1982). Një shtet efektiv ligjor e demokratik u hap rrugë zbatimit të proceseve efektive dhe do të mundësojë të krijohet dhe zhvillohet një ekonomi me një strukturë të qëndrueshme afatgjatë e cila do të jetë në gjendje ta bartë barrën e gjithë superstrukturës kombëtare. Një ekonomi e zhvilluar në principet e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe njerëzore në harmoni me interesat kombëtare do të ulë nivelin e papunësisë, mundësoi zhvillimin dhe përparimin e arsimit, shkencës, shëndetësisë, artit, kulturës së vendit tonë. Zhvillimi i përgjithshëm i vendit mundëson që të ngrihet niveli i mirëqenies individuale dhe shoqërore dhe populli do të ketë një jetë të lumtur dhe një të ardhme të sigurtë.

Kur ekonomia shqiptare do të zhvillohet dhe bëhet konkurrente në tregun rajonal e më gjerë atëherë do të arrihet pavarësia e vërtetë politike, juridike dhe ushtarake e kombit tonë. Derisa nuk arrihet një zhvillim i fortë ekonomik dhe një bazë e lartë materiale asnjëherë nuk do të ketë pavarësi të vërtetë të popullit tonë, sepse dihet mirëfilli se 'pa pavarësi ekonomike- nuk ka pavarësi politike' të një vendi. Duhet edhe një herë të potencohet se, për të arritur pavarësinë e plotë duhet të implementohet konkurrenca e lirë në nivel kombëtar dhe në të gjitha sferat e jetës dhe sidomos në ekonomi. Tregu i lirë kombëtar do të nxjerrë produkte dhe shërbime kualitative të cilat do të jenë konkurruese në tregjet tjera. Për të depërtuar në treg rajonal dhe më gjerë nevojitet një produktivitet më i madh, më cilësor, dhe duhet aftësi më të larta afariste, e për të gjitha këto duhet specialiste cilësor (Gusia, 1982). Vetëm atëherë kur ekonomia jonë arrin të plasoje mallra dhe shërbime dhe të jetë konkurruese në tregun e jashtëm atëherë do të arrihet një zhvillim i fortë ekonomik dhe procesi i pavarësisë do të sendërtohet. Për politikanët dhe shtet-ndërtuesit shqiptarë (lokalë dhe qendrorë) sot është obligim kryesor të këndellen dhe t'i ftojnë ekspertet e të gjitha lëmive (të vendit dhe nga diaspora) dhe të fillojnë nga e mbara procesin e zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo është detyrë parësore sidomos në ditët e sotme jo vetëm për Tiranën e Prishtinën, por për të gjitha qendrat dhe rajonet tona të cilat po lëngojnë nga largimi i të rinjve të cilët nuk shohin të ardhmen në vendin tonë si pasojë e mos implementimit të politikave efektive ekonomike.

Një ndër detyrat parësore të liderëve tanë është ngritja e vetëdijes shtet-ndërtuese dhe vënia në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të gjitha resurset ekonomike, sidomos atyre nga diaspora. Diaspora jonë fizikisht jeton jashtë vendit por shpirtërisht gjithmonë është në qendër të veprimtarive kombëtare. Diaspora shqiptare disponon me kapital vital financiar, teknologjik, social, humanitar dhe intelektual të cilët janë faktorë parësor të zhvillimit ekonomik dhe joekonomik të vendit në ditët tona. Në të vërtetë kapitali diasporës ishte faktori kryesor i cili mundësoi rezistencën kundër pushtuesve dhe ishte financuesi kryesor i luftës çlirimtare, zhvillimit të arsimit, edukimit dhe kulturës kombëtare gjatë gjithë historisë së re. Migracioni dramatik, i cili nuk po merr fund që nga fundi i viteve të 80-ta të shekullit të kaluar dhe sidomos sot ka marrë formën e një 'mortaje' të trishtueshme. Kjo 'mortaje e bardhë' në këto dy dekadat e fundit është pasojë e mos zbatimit të një politike efektive kombëtare nga qeveritaret tanë. Rinia sidomos shkollaret e rinj- kjo pjesë vitale e kombit nuk pranon të jetë 'rob i skamjes dhe mjerimit' në vendin e vet siç do të thoshte Sami Frashëri. Dukuria e shpërnguljes së rinise kërkon të merret masa urgjente nga qeveritaret tanë që të implementohen programe e projekte efektive të cilat do t'i krijojnë rinisë sonë mundësinë e punësimit dhe zhvillimin e biznesit të lirë. Hapja e vendeve të reja të punës në vendin tonë i çel rrugë rinisë drejt të ardhmes dhe mundëson të ndalet ky trend negativ dhe popullit e sidomos rinisë t'i kthehet dinjiteti shqiptar.

Sot lidershipi shqiptar e ka shumë më lehtë të veprojë se sa më parë; ata vetëm duhet të ndërtojnë institucione efektive shtetërore të cilat do të operacionalizojnë të gjitha resurset disponuese në mënyrë racionale në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Vetëm një politike kombëtarisht e koordinuar sipas parimeve të Doktrinës së Kastriotit do të operacionalizojë forcën e punës, forcën intelektuale, kapital financiare dhe atë natyrore në funksion të mirëqenies së kombit. Një ekonomi e fortë do kthejë dinjitetin e popullit, do të faktorizojë elementin shqiptar në rajon dhe të rrisë prestigjin tonë në arenën europiane dhe ndërkombetare. Atëherë, shqiptarët definitivisht do të zënë vend të merituar në strukturat politike dhe ushtarake Ballkanike dhe Perëndimore ashtu siç kërkonte dikur Kastrioti ynë i madh.Gjaku i derdhur në Arbëri që nga Epoka e Kastriotit arriti ta mbjellë përjetësisht ndjenjën e krenarisë kombëtare dhe të kultivojë vetëdijen shtetërore të prijësve shqiptarë në periudhat e ndryshme kohore. Ashtu si Skënderbeu që kërkonte nga superfuqia osmane vetëm fitoren dhe lirinë e Arbërisë, po ashtu edhe patriotët shqiptarë të Lëvizjes së NDSH, Lëvizjeve të mëvonshme të udhëhequra nga M. Krasniqi, A. Demaçi, J. Gervalla e K. Zeka, Dr. Rugova e shumë të tjerë pavarësisht epërsisë ushtarake të Serbisë qëndronin të pa lëkundur në qëndrimet e tyre në luftë për çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare. Për shembull, Dr. I. Rugova, nuk kërkonte*"asgjë më pak se pavarësinë e Kosovës"* dhe vazhdimisht potenconte se *'pavarësia është kompromis"* (Robelli, 2015).

Po ashtu edhe liderët dhe diplomatët e sotëm shqiptarë duhet të jenë të vendosur në qëndrimet e tyre të drejta dhe të mbrojnë me dinjitet dhe krenari interesat sublime dhe të drejtën natyrale të kombit tonë. Liderët tanë duhet ta dinë se "breznitë veprat i gjykojnë..., se jeta ma e mirë filloi prej nesh, me ne, ..." (Mekuli, 1973, fq. 130). Ata nuk duhet të përulen para presionit të askujt por duhet të çojnë në vend porosinë e dëshmorëve të rënë ndër shekuj dhe ta materializojnë gjakun e derdhur rrëke për këtë tokë të lashtë që nga Epoka e Kastriotit. Qeveritarët shqiptarë 'o sot- o kurrë' duhet të këndellen dhe të punojnë sipas mësimeve të Doktrinës së Kastriotit për ndërtimin e një shteti funksional. Ata duhet të ndjekin shembullin e Kongresit të Lushjes (1920) dhe ti koordinojnë veprimet e tyre duke vënë interesat e tyre individuale e partiake në shërbim të atdheut. Një mendje racionale dhe një vetëdije e lartë kombëtare shtet-ndërtuese eliminon divergjencat e pakuptimta dhe mundëson harmonizimin e të gjitha veprimeve të qeveritarëve tanë drejtë përmbylljes së procesit mbi njëzetëvjeçar të pavarësimit të Kosovës me anëtarësimin e saj në OKB.

Prandaj mund të konstatohet se Epoka e lavdishme e Skërnderbeut çdo herë do të shërbejë si udhërrefyes për shtet-ndërtuesit shqiptarë në të gjitha etapat kohore. Skënderbeu mbetet gjithherë epiqendra e kryenaltësisë kombëtare shqiptare, dhe personaliteti kryesor që bashkoi dhe vazhdon të bashkojë të gjithë shqiptarët (Repishti, 2004). Doktrina e Skënderbeut është udhërrefyesi më i mirë për forcimin e unitetit të kombit në rrugën për çlirimin e vendit dhe ndërtimin e shtetit kombëtar. Prandaj, mund të pohohet lirisht se doktrina e Kastriotit është bazament i vetëdijes shtetërore dhe Gjergj Kastrioti është "**Emblemë e Shtetit Shqiptar"!**

3.2 VEPRA E KASTRIOTIT INSPIRUESE PËR KRIJUESIT

Pas 17 Janarit të vitit 1468 për popullin tonë do vijnë shekujt të rëndë por siç thotë profesor Jorgaqi (2018) shëmbëlltyra e heroit e bartur brez pas brezi nga fjala shqipe asnjëherë nuk do te humbi shkëlqimin e vet. Vepra e Gjergj Kastriotit çdo herë do të shkëlqejë dhe do të bëhet burim i pashtershëm për krijuesit e të gjitha fushave si shkrimtarët, poetët, këngëtarët, piktorët, skulptorët, historianët, filozofët, psikologët, politikologët, gazetarët dhe analistët në periudhat e ndryshme historike. Krijuesit shqiptarë e të gjitha periudhave historike në Epokën e Kastriotit çdo herë do gjejnë inspirim të pashtershme për të krijuar kryeveprat e tyre.

Shkrimtaret e mesjetës si M. Barleti, F. Bardhi, Gj. Muzaka, Dh. Frangu, M. Baçikemi, Anonimi Tivarit, e të tjerë na japin shkrime me vlerë të çmueshme për Epokën e lavdishme të Kastriotit. Pa dyshim Barleti, një intelektual patriot me 1508 (ose 1510) publikoi veprën monumentale e cila do të jetë bazë e të gjithë studiuesve shqiptarë dhe europianë të cilët do shkruajnë me epitete të larta për Epokën e heroin tonë. Kjo vepër do të botohet shumë herë dhe do të përkthehet pothuajse në të gjitha gjuhët e Europës. Lexuesit edhe sot e kësaj dite i lexojnë dhe studiojnë me zell këto kryevepra të letërsisë klasike shqiptare.

Epoka e lavdishme e Skënderbeut do të bëhet një forcë inspiruese edhe për shumë krijues të vendeve tjera Evropiane e më gjerë. Autorët e huaj si Jost Amman (1578), Franciscus Blancus (1636); Antonio Vivaldi (1718), William Havard (1733), George Lillo, (1735), Thomas Whincop, (1747), François Francoer (1763), Zannovich, (1779), Çarls Bajroni (1819), e shumë e shumë të tjerë krijuan vepra të shkëlqyera në të cilat pasqyrohej lufta heroike dhe figura e madhore e heroit tonë të lavdishëm. Shkrimtaret e Rilindjes Kombëtare si Naim e Sami Frashëri, De Rada, G. Dara, J. Vreto, A.Z. Çajupi, P. Vasa, e tjerë do t'i kushtojnë vargjet dhe veprat më të mira Gjergj Katriotit. Duke ndjekur shembullin e shkrimtarëve të mesjetës dhe të Rilindjes Kombëtare pendat më të shkëlqyera të fillim viteve të shekullit njëzet si F. Noli, F. Konica, A. Plasari, A. Gegaj, Gj. Fishta, A. Asllani, H. Stërmillit, do shkruajnë vargje, vepra dhe analiza të shkëlqyeshme për Epokën e ndritur të Gjergj Kastriotit. Veprat e tyre do të shërbejnë si udhërrëfyes për edukimin e brezave të rinj. Për shkrimtarët e kohës së re si Gj. Zhej, I. Kadare, S. Drini, S. Godo, etj, Kastrioti do të jetë një figurë e veçantë e cila do t'i motivojë ata të shkruajnë vepra të përkryera. Për shkak të vlerës së lartë artistike dhe shkencore të këtyre veprave lexuesit do të shprehin një interesimit të jashtëzakonshëm dhe kështu ato do të ribotohen disa herë. Këto vepra gjithashtu do të përkthehen edhe në shumë gjuhë të tjera dhe do lexohen me endje nga lexuesit e huaj. Për shembull penda e talentuar e Kadaresë do t'ia kushtoj heroit tonë kombëtar një ndër kryeveprat e tij. Vepra "Kështjella" e Kadarese është një poemë epike me tone madhështore, epope magjike e luftës për liri, rrëfimit dhe afreskut historik" (Jorgaqi, 2018).

Epoka e lavdishme e Gjergj Kastriotit do të zejë kapitullin më të rëndësishëm në historiografinë shqiptare. Historianët e të gjitha periudhave pavarësisht vështirësive do t'i rreken hulumtimit të arkivave dhe studimit të literaturës në periudhat e ndryshme kohore në Europë e më gjerë për të ndriçuar veprën e heroit tonë. Vend të posaçëm do të zënë studimet dhe hulumtimet e historianeve si A. Ermenji, T. Zavallani, A. Buda, A.Hadri, K. Frashëri, J. Kastrati, A. Plasari, P. Xhufi, F. Hadrit, M. Zeqo, V. Kule, e të tjerë. Është shumë interesant dhe i rëndësishëm veçanërisht qasja pasionuese e studiuesit të madh arvanitas A. Kola dhe atij arbëresh Dh. Kamarda për luftën e Skënderbeut. Në veprën e tij monumentale kushtuar arvanitaseve krijuesi patriot A. Kola (1983) e vlerëson shumë lartë rolin dhe rëndësinë e veprës së Gjergj Kastriotit në krijimin e vetëdijes dhe krenarisë kombëtare.

Gjithashtu, krijuesit e tjerë si piktorët dhe skulptorët shqiptarë dhe europian kaluan muaj e vite të tëra në laboratorët e tyre në mënyrë që të portretizojnë në një formë sa më sublime figurën e Kastriotit. Busti i Kastriotit i punuar nga Odhise Paskalit, Janaq Paço, Andrea Mano e të tjerë rrinë krenar në sheshet e shumë qyteteve shqiptare e më gjerë. Portretet madhështore të piktorëve tanë për heronjtë qëndrojnë me dinjitet dhe lëshojnë rreze drite në zyrat e institucioneve shtetërore dhe kulturore të vendit tonë. Figura e Kastriotit është çdo herë një inspirim i veçantë për krijuesit e rinj shqiptarë të cilën që në vitet e hershme u munduan t'i kushtojnë atij krijimet më të bukura.Krijuesit muzikorë, këngëtarët, operistët, dhe sidomos rapsodët e të gjitha periudhave kohore këngët më të bukura ia kushtuan heroit tonë të madh. Rapsodët tanë me krenari të veçantë nën tingujt e lahutës dhe çiftelisë përshkruajnë fitoret e lavdishme të Gjergj Kastriotit. Këngët homerike kushtuar Kastriotit gjatë shekujve me endje këndohen e dëgjohen edhe sot nga gjeneratat e reja. Kënga "Fryne murlani me stuhi...," është kënga kreshnike e cila me dekada këndohej me krenari nga nxënësit e shkollave në Kosovë. Andaj vepra e Gjergj Kastriotit është burim i pashtershëm i krijuesve shqiptare.

Në bazë të këtyre diskutimeve dhe argumenteve të cilat janë produkt të kësaj analize kritike mund të nxirret konstatimi se Gjergj Kastriotit është një figurë komplekse dhe shumëdimensionale e përmasave globale. Kompleksiteti dhe madhështia e veprës së Kastriotit bëri që fytyra e tij të mbetet e freskët në kujtesën e shqiptarëve dhe njerëzve liridashës në përgjithësi deri në ditët tona. Personaliteti i Kastriotit u reflektua me sukses dhe ka pasur një ndikim signifikant te të gjithë patriotët tanë të cilët gjeten frymëzuesin, ideatorin, strategun dhe udhërrefyesin e aspiratave për çlirim të vendit. Ngritja e flamurit në Krujë, organizimi i Lidhjes së Lezhës, çlirimi i vendit dhe ndërtimi i Mbretërisë së Arbërisë do të jenë jo vetëm motivim por edhe udhërrëfyes për të gjitha brezat se si duhet të fitohet liria, si të mbrohet atdheu dhe si duhet të ndërtohet shteti. Po ashtu krijimi i aleancave të Skënderbeut me Huniadin dhe mbretin e Napolit, Venedikut, Raguzen, e the do të jenë paraprirëse të Aleancave Perëndimore të kohës sonë. Gjergj Kastrioti u bë simbol i unitetit për çlirimin dhe ndërtimin e shtetit kombëtar në të gjitha periudhat kohore. Andaj mund të konstatohet se lavdia e Epokës së Kastriotit vuri bazat mbi të cilën u krijua dhe ndërtua vetëdija jonë kombëtare **-** Gjergji Kastrioti është "**BABA I KOMBIT SHQIPTAR!**"

4. PËRFUNDIM

Ky hulumtim i qaset studimit të jetës dhe veprës së Gjergj Kastriotit- Skënderbeut nga një pikëpamje tjetër. Qëllimi parësor i këtij studimi është që t'i plotësojë disa zbrazësi të literaturës shkencore rreth Epokës së Lavdishme të Skënderbeut. Ky hulumtim analizoi në mënyrë kritike një gamë të gjerë të publikimeve të llojllojshme të shkruara gjatë periudhave të ndryshme kohore. Kjo analizë synon të arrijë tri qëllime kryesore**:** ***së pari,*** bazuar në literaturën e publikuar ky studim ka për qëllim të dokumentojë se arbërit si pasardhës të iliro-pellazgeve kishin një rol kyç dhe ndikim sinjifikant në periudhën e mesjetës në Gadishullin Ilirik të cilët krijuan një bazë të forte mbi të cilën u ngrit mbretëria e Gj. Kastriotit. ***Së dyti,*** qëllimi i studimit është që duke analizuar literaturën e shkruar të shndrisë sukseset e jashtëzakonshme të veprës së Gjergj Kastriotit kundër një superfuqie botërore të kohës në fushë-betejë dhe rolin e tij në bashkimin e princave arbërore cila u kurorëzua me krijimin e Mbretërisë së Epirit. ***Së fundi,*** qëllimi i këtij studimi është të paraqesë reflektimin e Epokës së Gjergj Kastriotit në të gjitha periudhat e mëvonshme të historisë shqiptare në raport me organizimin e lëvizjeve çlirimtare dhe krijimin e ndërtimin e shtetit kombëtar.

Bazuar në metodën analitike hulumtuese, ky studim dokumenton se vepra e Kastriotit duke trasuar rrugët e lirisë dhe krijimin e shtetit shqiptar është përjetësuar në të gjitha periudhat historike të popullit shqiptar. Duke u mbështetur në argumentet praktike ky hulumtim e vërteton hipotezën se Epoka e Gjergj Kastriotit është hallka kryesore e cila ndërlidh etapat e reja historike të popullit tonë me periudhën e mesjetës e cila gjithashtu ka rrënjët thellë në epokën iliro-pellazge. Mbi të gjitha Epoka e Gjergj Kastriotit është bazamenti mbi të cilën u krijua dhe u ngrit vetëdija shtetërore dhe kombëtare shqiptare. Andaj mund të konkludohet lirisht se Gjergj Kastrioti është "BABA I KOMBIT SHQIPTAR".

Një qëllim tjetër po ashtu shumë i rëndësishëm, i këtij hulumtimi është që t'i stimulojë studiuesit e fushave të ndryshme të kohës sonë që ta studiojnë dhe analizojnë Epokën e Kastriotit nga perspektivat e ndryshme me qëllim që të arrihet të pasqyrohet figura e Kastriotit në mënyrë sa më të kompletuar. Duke analizuar këtë Etape historike sa të lavdishme, aq të rëndësishme, komplekse dhe interesante krijuesit arrijnë të shohin se të shkruash për figurën markante të Gjergj Kastriotit- Skënderbeut është sikur se të hedhësh 'një pikë ujë në oqean'!

** Referencat e këtij shkrimi do t'i gjeni në versionin online të gazetës "Rruga e Arbërit".*

Kushtuar 30-vjetorit të lindjes së portierit dhe futbollistit Geri Shatku



- **Geri shikohet nga shumë ekipe dhe realizon prova me skuadrat si Parma Calcio dhe Torino Calcio. Kjo e fundit, pas provës së dytë është e vendosur në vitin 2008 që të marrë Gerin në organikën e skuadrës së shpresave.**
- **Geri Shatku, është vlerësuar e dekoruar nga Bashkia e Rajonit të Torinos, Itali dhe çdo vit, më 3 qershor, në kujtim të tij, zhvillohet kampionati futbollistik i të rinjve sportist evropian, me titullin "Trofeu futbollistik Geri Shatku", e më pas ekipit fitues i akordohet kupa me simbolin e Gerit.**
- **Në qendër të qytetit të Torinos, në shkollën ku ka studiuar Geri, "Quintino Sella" është mbjellë "pema e gjallnisë Geri Shatku", e cila personifikon ekzistencën e Gerit dhe sot.**

Geri Shatku - një portë dhe shumë zemra bosh...

JETËSHKRIM DHE ARSIMIMI

Geri Shatku ishte një futbollist dhe një student i talentuari, i lindur në Tiranë më 3 qershor 1990, nga prindërit Rukie dhe Burhan Shatku, djali i dytë i kësaj familje me prejardhje nga Dibra e Madhe, e i lidhur ngushtë me gjyshen e tij Myzjen Shatku. Vullneti dhe talenti i tij e ndihmuan të arrijë pika shumë të larta në futbollin Italian. Geri ishte i mirënjohur për sjelljen e tij të përkryer, për modestinë dhe pasionin e jashtëzakonshëm për futbollin.

Filloj shkollën fillore te "Shkolla e Kuqe" dhe e vazhdoi në Itali në qytetin e Recanati, pranë tezes Dallëndyshe Daci. Kthehet nga Italia në vitin 1998 dhe frekuenton shkollën "E Kuqe" ndodhur në rr. "Qemal Stafa", Tirane deri në vitin 2000, kur shpërngulet përfundimisht me familjen e tij në Itali, përsëri në qytetin Recanati. Në Recanti mbaron shkollën tetëvjeçare të "M.L Patrizi" në vitin 2004.

Fillon arsimin e Mesëm në Loreto te Shkolla "Albert Einstein", ku përfundon vitin e parë dhe pjesën e parë të vitit të dytë me rezultate të shkëlqyera dhe zhvillon një raport dashamirës me shoqërinë e tij.

Në vitin 2006 shpërngulet me familjen në Torino për të pasur më shumë mundësi karriere në fushën e futbollit. Në Torino vazhdon shkollën e Mesme "Quintino Sella" me rezultate shumë pozitive. Në të njëjtën periudhë aktiviteti futbollistik bëhet shumë i ngjeshur dhe është në sy të skuadrave të mirënjohura në Itali si Atalanta, Milan, Torino, Inter dhe Parma. Komunikonte rrjedhshëm gjuhën italiane dhe kishte njohuri shumë të mira të anglishtes dhe frëngjishtes.

VEPRIMTARIA E FUTBOLLIT

Geri filloi të luaj futboll pas klasës së katërt dhe e ndjente që kishte një talent për të mbrojtur portën. Aktivizohet me skuadrën e U.S.D Recanatese, Itali dhe pasioni i tij për futbollin rritej çdo vit. Bëhet titullar i palëvizshëm i skudrës Recanatese dhe ambiciet e tij rriten sa më tepër.

Merr pjesë në Trofeun San Vito (me pesë lojtarë) gjatë verës 2003 dhe shpallet Portieri i Turneut dhe skuadra e tij fiton vendin e parë.

Në vitin 2006 shkëputet me familjen në Torino për të realizuar ëndrrën e tij të madhe: të luaj për skuadrën e tij të zemrës F.C Juventus. Fillon të luaj me A.S.D Atletico Torino ku dallohet për profesionalizmin dhe përkushtimin për futbollin. Fiton vendin e titullarit dhe bëhet një protégé` i Trajnerit Ugo Notaio.

Në verën e vitit 2006 kalon në skuadrën "Berretti" te U.S Ivrea Calcio, ku fiton vendin e portierit titullar. Emri i tij rritet dhe fillon të shikohet nga menaxherët e talenteve të skuadrave të ndryshme si A.C Milan, Torino Calcio, Juventus dhe Parma Calcio.

Në verën e vitit 2007, gjatë fazës përgatitore me skuadrën e parë afër Aostes takohet me menaxherin dhe agjentin e FIFA, Tommaso Guelpa. Ky i fundit habitet me talentin e Gerit dhe flet me Presidentin e Ivreas, i cili në fillim mendon se menaxheri po fliste për portierin e parë të skuadrës. Guelpa e kishte fjalën për Gerin dhe nuk i besohet që një djalosh që sapo kishte mbushur moshën 17 vjeçare të kishte një talent të tillë. Guelpa takohet me Gerin pas stërvitjes dhe i propozon që të bëhet menaxheri i tij. Geri vendos të flasë me ish trajnerin e tij, Ugo Notaio, dhe krijohet një takim midis palëve, duke përfshirë edhe familjen e Gerit. Mbas këtij takimi Tommaso Guelpa bëhet menaxheri zyrtar i Gerit dhe e vendos në kontakte me skuadrat e fuqishme të Serisë A.



GERI SHATKU
(03.06.1990- 02.04.2008)

NJË EMOCION I MADH I NDËRPRERË NË MES...

Performancat e Gerit me U.S Ivrea janë të habitshme dhe përmirësimet në teknikë janë tejet të dukshme. Pasioni i tij për futbollin rritet sa më shumë dhe stërvitjet bëhen edhe me të shpeshta, sepse thirret edhe në ato të skuadrës së parë, e cila bën pjesë në Kampionatin Profesionist të Serisë C2. Katër herë në javë Geri udhëton me tren çdo herë për 100 kilometra për të shkuar në stërvitje.

Geri shikohet nga shumë ekipe dhe realizon prova me skuadrat si Parma Calcio dhe Torino Calcio. Kjo e fundit, pas provës së dytë është e vendosur në vitin 2008 që të marrë Gerin në organikën e skuadrës së shpresave.

Ai ndjehet shumë krenar për arritjet e tij, por nuk i shprehte ndonjëherë një gjë të tillë, sepse ishte një djalë modest. Një herë i tha vëllait që ndodhej në New York, Sidit, që prova me Torino calcio kishte dalë shumë mirë dhe kishte bindje se ato do ta merrnin në skuadrën e tyre.

Fatkeqësisht e papritura ndodhi. Ëndërrat e tij të bukura dhe pafund u ndërprenë në pjesën më të bukur të jetës. Zoti vendosi që vendi i tij do ishte midis engjëjve në qiellin e pafund.

Gazetat do të shkruanin se: "Një ngjarje e rëndë tronditi këtë pasdite futbollin e Ivrea-s, e cila luan në ligën e dytë italiane të futbollit. Ka qenë një atak meningjiti i rrufeshëm shkaku i vdekjes së Geri Shatkut, portier me origjinë shqiptare në formacionin e të rinjve "Berretti". Ende nuk është i sigurt shkaku i vdekjes, por ai po hetohet. Shatku, i datëlindjes 1990, ka luajtur rregullisht, të shtunën e kaluar madje edhe në stërvitjen e djeshme. Dje ai ishte paraqitur në kampin stërvitor. Por, në mbrëmje, ai kishte pasur temperaturë, e cila e detyroi të shtrohej në spital. Sot në mëngjes ai i mungoi stërvitjeve. Shatku ishte banor i Torinos, edhe pse luante për Ivrean. Mjekët ndërkohë, kanë nisur vizitat me të gjithë kolegët e tij të skuadrës, në rast parandalimi të mundshëm të ndonjë epidemie ngjitëse."

Geri la mbresa të mëdha te shoqëria e tij dhe një boshllëk të paparë në zemrat e familjes dhe të afërmve të tij. Skuadra e futbollit e U.S Recanatese, A.S.D Atletico Torino dhe e U.S Ivrea e kanë kujtuar figurën dhe personalitetin e Gerit në shumë veprimtari. Në Prill 2010 A.S.D Atletico Torino organizon një Turne për Skuadrat e Shpresave (Coppa Primavera) dhe Trofeu për Fair Play është titulluar në emër të Geri Shatkut. Ky Trofe u fitua nga skuadra e FC Kabenhavn.

VLERËSIMET DHE RESPEKTET PËR GERIN

Shkolla Quintino Sella në Torino organizoi për një vjetorin e Gerit një ceremoni ku u vendos një pemë "Magnolia" në oborrin e shkollës në emër të Geri Shatku. Në këtë ceremoni morën pjesë familjarët e tij, shumë miq të Gerit dhe studentë, përfaqësues nga Provinca e Torinos, nga Komuna e Torinos dhe organet më të larta të shkollës.

Shoqëria i ka dedikuar shume poezi dhe shkrime Gerit dhe fotografia e tij ndodhet në korridorin e shkollës Quintino Sella dhe në Klubin A.S.D Atletico Torino;

Geri Shatku, është vlerësuar e dekoruar nga Bashkia e Rajonit të Torinos, Itali dhe çdo vit, më 3 qershor, në kujtim të tij, zhvillohet kampionati futbollistik i të rinjve sportist evropian, me titullin "Trofeu futbollistik Geri Shatku", e më pas ekipit fitues i akordohet kupa me simbolin e Gerit.

Në qendër të qytetit të Torinos, në shkollën ku ka studiuar Geri, "Quintino Sella" është mbjellë "pema e gjallnisë Geri Shatku", e cila personifikon ekzistencën e Gerit dhe sot.

Radio Televizioni Shqiptar RTSH, çdo vit më 2 prill transmeton dokumentarin biografik përgatitur nga gazetari i njohur Dëfrim Methasani i cili titullohet: "Një portë, dhe shumë zemra bosh...!"

Ekipi i futbollit të të rriturve, Ivrea Real, trajneri i tij G. Uggo, stafi dhe shokët e tij e kujtojnë Geri Shatkun si një sportist me mjaft energji në portën e futbollit, por dhe si një djalë me mjaft talent, energji, teknike e taktikë, i cili falë fatit të tij të hidhur, sot do të mbronte portën e kombëtares së të rinjve dhe të rriturve në Shqipëri.

Në shkollën "E Kuqe" në Tiranë, në një pjesë të muzeut historik të kësaj shkolle, është ekspozuar portreti dhe fanella e tij, si dhe trofetë e Geri Shatkut, si një kujtim shpirtëror për të.

Njësia Bashkiake ka propozuar vendosjen e një rruge në njësinë nr.8 Tiranë emrin e Geri Shatkut, me iniciativën e komunitetit dibran në Tiranë dhe banorëve të lagjes.

Shoqata Kombëtare e Miqësisë dhe Bashkëpunimit, Shqipëri-Itali e ka vlerësuar Geri Shatkun me titullin: "Nderi i Shoqatës" më 3 qershor 2020.

Edhe Presidenti i Republikës, me rastin e jubileut të 30 vjetorit të Geri Shatkut do ta nderoj kujtimin dhe kontributin e tij si sportist dhe njeri me vlera shoqërore, me një dekoratë mirënjohje, me rastin e organizimit të këtij përvjetori kushtuar Geri Shatkut.

Përgatiti:
DEFRIM METHASANI

HOMAZH ME RASTIN E 33 VJETORIT TË NDARJES NGA JETA TË SPORTISTIT TË SHQUAR LUAN SHATKU

Luan Shatku, modeli i basketbollistit shqiptar

BIOGRAFIA E BASKETBOLLISTIT LUAN SHATKU DHE PENGESAT SPORTIVE GJATË SISTEMIT MONIST

Luan Shatku, lindur në Tiranë më 21.09.1937, nga prindër me prejardhje nga Dibra e Madhe. Basketbollist dhe intelektual i shquar, pedagog dhe arsimtar i dalluar. Që në fëmijëri, u shqua për shtatin e tij të lartë që i ngjante gjyshit të tij, Izet Shatkut (Dibra) jo vetëm nga bukuria por dhe zgjuarsia që e karakterizonte. Ky shtat dhe përgatitja e tij tekniko-fizike do ta kurorëzonte atë në majat e elitës së basketbollit shqiptar ndër vite. Pas vitit 1947, ai dhe familja e tij do të dëboheshin në qytetin e Shkodrës si shkak se gjyshi i tij, Izet Shatku (Dibra), e dy xhaxhallarët e tij, Faik Shatku dhe Komandanti Shefki Shatku do të quheshin si "Ministra në qeveritë e Mbretërisë Shqiptare". Ndërsa babai i tij Qemali, do të etiketohej si eksponent i Ballit Kombëtar. Për këtë qëllim këto pasoja do ti vuante e gjithë familja Shatku, ndër vitet e komunizimit, si dhe vetë sportisti i ri Luan Shatku, i cili nuk do të lejohej të luante pas disa viteve ne takimet sportive jashtë shtetit, përveçse në një kompeticion sportiv



Luan Shatku

ndërkombëtar të 1961 në Bullgari. Do të preferonte të mbante në fanellën e tij numrin 6. Në Shkodër ai përfundoj gjimnazin me rezultate të shkëlqyera.

Pavarësisht nga prapavija politike, shkodranët e donin dhe e vlerësonin talentin e Luanit si dhe përgatitjen e tij në ngritje. Në vitin 1953 u shfaq për herë të parë si lojtar basketbolli me ekipin e "Vllaznisë", u dallua për fizikun e tij të përshtatshëm nga trajneri i skuadrës së parë për meshkuj Esat Harxhi. Ishte ky trajner që e tërhoqi Luanin në ekipin e të rriturve të Shkodrës. Kështu u hap perspektiva që Luani të ishte ndër lojtarët më të dalluar të "Vllaznisë". Trofeu i parë për kupën e Republikës u fitua në vitin 1957 dhe më pas në vitin 1959 në finalen e Spartakiadës së Parë Kombëtare, kur Luani së bashku me lojtarët, Skënder Osmani, Esat Harxhi, Zyhdi Coba, Niazi Lleshi, Renato Radoja, Ali Quku, Filip Guraziu, Adem Fishta etj. ishin pjesë kompakte e ekipit të Vllaznisë.

RAPORTET E TIJ ME SPORTIN, FUSHËN E BASKETBOLLIT DHE KOLEGËT

Në vitin 1961 për herë të parë merr pjesë në Ballkaniadën e parë të Basketbollit për meshkuj në Sofje të Bullgarisë, ku do të spikaste për lojën organizative të tij dhe sinergjitë ndaj lojtarëve të përfaqësueses shqiptare. Së bashku me themeluesit të basketbollit shqiptar si trajnerët: Naim Pilku, Feti Borova, Astrit Greva, u bënë përpjekje të vazhdueshme që Luani të vinte në mesin e viteve 60' dhe të luante në ekipet kryeqytetase si lojtar qendër, çka i mungonte atëherë ekipeve me emër. Duke qenë se në vitin 1963 ai u thirr për të kryer shërbimin ushtarak në kryeqytet u përfshi në skuadrën e përfaqësuesve të ekipit të "Partizanit", i cili drejtohej nga trajneri i mirënjohur, Astrit Greva. Në ekipin e Partizanit, të cilit do ti rikthehej titulli kampion në basketboll në vitin 1964, ku Luan



homazh

Kujtim Hoxha, ikja e parakohshme e mësuesit

Nuk e kishim menduar kurrë se një ditë, do të na duhej të shkruanim këto radhë të hidhura për Kujtimin, nipin, vëllain, shokun dhe mikun tonë të shtrenjtë e shumë të vyer, një nga njerëzit më të dashur që patëm në jetë, që iku papritur dhe shumë parakohe në amshim...

Kujtim Hoxha ka lindur në fshatin Grevë të Peshkopisë me 28. 01. 1959. Ishte djali i dytë i Gjuran dhe Fatmira Hoxha (Bunguri).

Shkollën fillore dhe atë 8 vjeçare i mbaroi në fshatin e lindjes, me rezultate shumë të mira, në vitet 1966-1974. Në vitet 1974-1978 kryen shkollën e Mesme "8 Nëntori" në Gjimnazin e Peshkopisë, gjithashtu me rezultate mjaft të mira. Në vitet 1978-1979 kreu stazhin në minierën e kromit "T. Manço" Bulqizë. Megjithë rezultatet e mira të gjimnazit, nuk iu dha e drejta e studimit menjëherë, me pretekstin absurd të kohës se vëllai para tij ishte në shkollë të lartë.

Në moshën e adoleshencës dhe të rinisë së hershme, Kujtimi ishte një ushtrues i përditshëm i veglave gjimnastikore të shkollës, i vrapit dhe atletikës; në çdo pasdite, në të njëjtën orë, atë do ta gjeje tek paralelet e shkollës së fshatit, ku, nën shoqërinë e vërsnikëve, bënte ushtrime gjithfarëshe. Gjatë dimrit larja me borë dhe ujë të ftohtë tek çezma para shtëpisë në Grevë, ishin kthyer në shprehi normale të përditshmërisë së tij. Ushtrimet e përditshme dhe të programuara mundësuan formimin e një fiziku prej atleti, të lakmueshëm nga të gjithë vërsnikët dhe më të rriturit. Pasioni i tij për ushtrimet fizike shpejt u diktua nga profesori i edukimit fizik në gjimnaz, ku Kujtimi shquhej mbi të tjerët për kryerjen e ushtrimeve me shkallë të lartë vështirësie. Megjithatë, ai pëlqente shkencat ekzakte, ishte shumë i mirë veçanërisht në matematikë, fizikë dhe kimi, dhe ëndërronte të bëhej mjek ose inxhinier i kimisë.

Pas mbarimit të stazhit në minierën e Bulqizës, megjithë rezultatet shumë të mira të gjimnazit, edhe pse nuk ju dha e drejta e studimit për në shkollë të lartë, ai nuk u dekurajua. I qetë dhe me karakter të fortë spartan, ai shquhej



KUJTIM HOXHA
(28.01.1959-11.04.2020)

për vullnet të hekurt. Studimet e larta 4 vjeçare i kreu në Universitetin "L. Gurakuqi" në Shkodër, fakulteti Biologji-Kimi (pa shkëputje nga puna), të cilat i përfundoi me rezultate të mira dhe në kohë rekord në vitet 1982-1984.

Në vitet 1984-1990 punon si mësues i Biologjisë dhe Kimisë në shkollën 8 vjeçare të Zogjajt, në vitet 1990-1992, në shkollën 8 vjeçare "H. Palikuqi" Maqellarë dhe në vitet 1992-1993 në shkollën 8 vjeçare "H. Shehu" Grevë.

Ne vitet 1993-2006 emigron në Gjermani, ku për 13 vjet, merret me punë të ndryshme. I pasionuar pas luleve dhe kopshtarisë, për një kohë të gjatë, punoi si bahçevan. Në vitet 2010-2015 punon si supervizor në Drejtorinë e Përgjithshme të Matjeve e Kalibrimeve (Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit), ku u shqua për punë korrekte dhe të ndershme. Në vitin 2015, në fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit Shtetëror të Tiranës, mbron provimin e gjuhës gjermane, të cilën e zotëronte shkëlqyeshëm. Ishte i vetmi supervizor dhe i vetmi punonjës i Agjensisë që përveç fakultetit njihte, tashmë edhe me diplomë universitare një gjuhë të huaj të vështirë, siç është gjermanishtja. Për ironi të fatit, pak kohë pas kësaj mbrojtjeje të suksesshme, drejtuesit e sapo emëruar të Agjensisë, me shkollë gjysmake ose me diploma të blera, e larguan nga puna pa asnjë motivacion. E donin vendin e punës së Kujtimit për të shpërblyer militantët e pashkollë të partisë! Edhe pse Kujtimi e fitoi gjyqin për largim të paligjshëm nga puna, ata nuk e rikthyen në vendin e punës.



Me nxënësit e klasës V-të Maqellarë, 1992.

Pas kësaj, në fundin e vitit 2015 shkon përsëri në Gjermani (Gelsenkirschen), ku kishte familjen dhe 3 fëmijët e tij, ku qëndron deri në 22 janar 2020. Pas 5 vitesh, vjen në Tiranë më 23 janar 2020, përkohësisht, për tu kthyer përsëri. Por vendosja e regjimit të ngujimit për shkak të "Covid 19", ia pamundësoj kthimin në Gjermani, tek fëmijët e tij. Në fazën e dytë të qëndrimit në Gjermani (2015-2020), ka kryer punë të ndryshme dhe në kohën e lirë ka ndihmuar me qindra emigrantë shqiptarë me përkthimin e dokumenteve të tyre etj, punë që e bënte pa asnjë shpërblim.

Pasionin për ushtrimet fizike dhe vrapimet në natyrë Kujtimi e ruajti deri në ditën e fundit të jetës. Ai çdo ditë ushtrohej me rreth një orë vrap dhe ushtrime fizike, ishte fizikisht mjaft i fortë dhe askujt nuk i shkonte mendja se një ditë do të na ikte papritur...

Ndërroi jetë papritur në shtëpinë e tij në Tiranë, në pasditen e të shtunës së 11 prillit 2020, nga një arrest kardiak i pakthyeshëm. Shkoi në amshim shumë herët, duke hidhëruar të gjithë familjarët e tij, vëllezërit, motrat dhe gjithë të afërmit, shokët e shumtë, e në mënyrë të veçantë, fëmijët, që për shkak të regjimit të karantinës, nuk patën mundësi as t'i jepnin lamtumirën e fundit.

Kujtimi la pas tre fëmijë, Xhesikën (1992) që ka mbaruar Universitetin në SHBA, Anën (1997), që vazhdon universitetin në Gjermani dhe Silvin (2000), në vitin e fundit të gjimnazit (Gjermani).

Ngujimi i detyruar nga "Covid 19" krijoj një situatë absurde, ku dhimbjen për njeriun e dashur duhej ta ndaje vetëm me një grusht njerëzish të rrethit të ngushtë familjar. Megjithatë, në këtë shkrim përkujtimor për Kujtimin, duam të falënderojmë me mirënjohje të thellë të gjithë miqtë e shumtë të tij, që edhe pse nuk patën mundësi ta përcjellin në banesën e fundit, na janë gjendur pranë dhe kanë shprehur dhimbjen e tyre në forma të tjera të mundshme.

Kujtimi do të kujtohet gjithmonë për dashurinë për njerëzit, thjeshtësinë, zgjuarsinë, ndershmërinë, karakterin e fortë dhe shpirtgjerësinë e tij. I paharruar do të mbetet për të gjithë ne përjetësisht, KUJTIM HOXHA. I lutemi Allahut xh.sh. që inshallah do t'ia shpërblej mirësitë dhe sakrificat e tij në këtë jetë, me xhenet në jetën e pasosur.

Adem Bunguri, Nehat Daci, Premtim Kryemadhi, Gjuran Fida, Ali Deshati, Agron Fida, Arben Fida, Rami Hoxha, Naim Hoxha, Besa Hoxha (Çaushi), Lindita Hoxha (Elmazi).

HOMAZH

Fisnik Hyka, një njeri plot energji pozitive



Më 1 prill 2020, u nda nga jeta në moshën 72 vjeçare, Fisnik Izet Hyka.

Ai u lind në mars 1948 në Sopot të Dibrës. Shkollën 8-vjeçare e mbaroi në vendlindje, ndërsa në vitin 1966 mbaroi shkollën ushtarake "Skënderbej". Në vitin 1968 mbaroi me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, dhe menjëherë më pas, gjatë viteve 1968-1986 punoi si oficer në Gjirokastër, në funksione të ndryshme, deri Komandant Brigade.

Gjatë kësaj periudhe mbaroi edhe Akademinë Ushtarake dhe Kursin e lartë të filozofisë. Në vitin 1986 transferohet në Peshkopi me detyrën komandant brigade.

Në vitin 1991 emërohet Komandat Divizioni në Peshkopi, ndërsa një vit më vonë zgjidhet Deputet i Selishtës në Kuvendin Popullor.

Në vitin 1999 i rikthehet në Gardën e Republikës, ku punoi deri në vitin 2005. Në këtë kohë del në reformë.

Fisnik Izet Hyka gjatë gjithë karrierës së tij ushtarake e civile ka qenë dhe ka treguar një përkushtim qytetar, mbarte e përcillte veti të larta njerëzore, çiltërsi, duke qenë një mik i mirë të për gjithë, një koleg i hapur dhe i mirëkuptueshëm, një punonjës shteti i devotshëm, një familjar i mirë dhe një njeri që përcillte gjithmonë pozitivitet.

Ikja e tij ishte një humbje për familjen, por edhe një humbje për miqtë dhe kolegët, të cilët te Fisniku shinin një fisnik të vërtetë.

I paharruar do të mbetet për të gjithë ne përjetësisht!

Vexhi Gjoni, Shaban Cani, Andon Andoni, Karaman Qato, Musa Ricku, Avni Elezi

→

Shatku, do të dallohej në veçanti si qendra kryesore e lojës, ishte kapësi më i mirë i topave në tabelë duke lënë gjurme tek kjo skuadër. Në vitin 1965 përfaqëson ekipin kombëtar në Ballkaniadën e Basketbollit në Tiranë, ndërsa po në këtë vit do të luante me ekipin e "Partizanit" në krah të mikut dhe kolegut të tij të basketbollit, tepër i ri atëherë, të mirënjohurit Agim Fagu.

I madhi i basketbollit Shqiptar, Agim Fagu, do të citonte në një kumtesë për mikun e tij Luan Shatku se: "Ndodh shpesh që disa të vërteta t'i dëgjosh nga të tjerë. Për mua është fat që këtë të vërtetë ta kem njohur vetë, kështu që kam të drejtë t'jua tregoj të tjerëve. Kundërshtarët i druheshin Luanit, ndërsa shokët e ekipit i gëzoheshin fatit që ai ishte i tyre; unë hamendesha se sa i ashpër dhe i rëndë duhet të ishte ai në jetë. Pas 2-3 vjetësh fati na bashkoi me mirëdashje. "

Pas një periudhe të suksesshme me ekipin e "Partizanit", ai kthehet në qytetin e Shkodrës, e shërben si lojtar qendre me po aq rendiment si tek ekipi i "Partizanit". Merr pjesë në kompeticionet ndërkombëtare në vitet 1965-1966-1968. Fatkeqësisht, pas vitit 1969 Luani nuk pati vazhdimësi në ekipin kombëtar, jo se nuk e meritonte, as për arsye se ishte i paaftë, por për arsye



Luan Shatku, nr. 6, i treti nga e majta

Luan Shatku u nda nga jeta në moshë të re, duke lënë pas një emër shume të njohur dhe të vlerësuar në historinë e komunitetit të basketbollit shqiptar, si dhe në të gjithë rininë e Institutit të Lartë ku ai shërbeu si pedagog.

të klimës politike, e cila sa vinte dhe ashpërsohej më tej. Krahas basketbollit Luani ka qenë dhe një student shumë i mirë. Pas përfundimit të Institutit të Lartë në Shkodër ai emërohet pedagog matematike në këtë Institut (sot Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi").

Luan Shatku dinte të koordinonte marrëdhëniet shoqërore mes kolegëve, miqve, kundërshtarëve të lojës, gjyqtarëve dhe sportdashësve, e për këtë arsye ai gëzonte një respekt të veçantë nga ana e komunitetit të basketbollit. Në rrethanat e kohës por dhe të zhgënjimeve, duke qenë se iu mohua e drejta që të përfaqësonte ekipin kombëtar në aktivitetet ndërkombëtare, Luan Shatku u shkëput nga sporti i basketbollit, por duke lënë si pasardhës të tij një tjetër sportist të talentuar të birin, Altin Shatku, i cili luajti basketboll me ekipin e Vllaznisë dhe më pas me Tiranën, si dhe pas viteve 1990 jashtë Shqipërisë, në Greqi, në Suedi, Gjermani dhe Australi. Në fund të vitit 1999, nga Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve në prani të Kreut të Shtetit me një ceremoni soleme u nderuan dhe u lauruan një grup i madh sportistësh, trajnerësh, specialistësh-nga më të shquarit e sportit-me medalionin "Nder i Sportit Shqiptar".

Midis tyre janë mjaft sportistë dibranë dhe bij dibranësh, madje emra sugjestionues, të nderuar e të respektuar në mbarë vendin dhe më gjere si: Irfan Tershana, Belul Hatibi, Ismet Bellova, si dhe mjeshtrat e mëdhenj: Naim Pilku, Feti Borova, Astrit Greva dhe Luan Shatku. Luan Shatku u nda nga jeta në moshë të re, duke lënë pas një emër shume të njohur dhe të vlerësuar në historinë e komunitetit të basketbollit shqiptar, si dhe në të gjithë rininë e Institutit të Lartë ku ai shërbeu si pedagog.

Luan Shatku do të largohej nga jete në moshën 50 vjeçare, me 15 korrik të vitit 1987. Ai është konsideruar nga kolegët, miqtë dhe specialistët e sportit si TITAN i basketbollit shqiptar.

Përgatiti:
DËFRIM METHASANI

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!

JU JAPIM VLERE
EDHE MONEDHAVE
TUAJA!

NGA DATA 5 - 12 QERSHOR

Përëri me Super Oferta

1+1

Ferra King
95
50 LEKE

BIG Kraxx
1+1
50 LEKE

ATLAS Pasion për ëmbëlsi
ASSOS MIELL GRURI TIP 00
Për të ëmbla përdorime
80
50 LEKE

ARANI
100
50 LEKE

KAFE TURKE
Mon Chéri aroma
75
50 LEKE

Gjiri Parisi
90
50 LEKE

Big Market www.bigmarket.al

Cmimet mund të ndryshojnë në rast gabimesh ortografike. | Artikujt mund të jenë me sasi te limituar. | Fotot kane thjeshtë vlerë treguese.

Lidhu direkt me ne!
Skano Kodin!

cyan magenta yelloë black